



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 124951

Më: 13 shtator 2024

Në bazë të nenit 52 paragrafit 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 59 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet me **24 shtator 2024 (e martë)** në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **orën 10:00**. Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 16 korrik 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA);
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtares të Komisionit Vlerësues;
6. Raporti financiar janar – qershor 2024;
7. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024;
8. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 dhe informatë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025;
9. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023;
10. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), për periudhën janar-gusht 2024;
11. Raporti i Performancës Komunale për Komunën e Prizrenit, për vitin 2023.



Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN

Komitet za Politiku i Finansije

Br. 001/060 – 124951

Dana: 13 septembar 2024

Na osnovu člana 52 stav 1, Zakona o Lokalnoj Samoupravi i člana 59 stav 1 Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15.10.2008. sazivam sastanak Komiteta za Politiku i Finansije koja će se održati **24 septembar 2024 (utorak)** u sali za sastanke KPF-a, u „Beloj kući“, sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da učestvujete u radu ovog sastanka kao član Komiteta za Politiku i Finansije, pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ovog sastanka predlažem sljedeći:

D N E V N I R E D

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika od 16 jula 2024;
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Razmatranje i usvajanje lokalnog akcionog plana za rodnu ravnopravnost (2024-2026);
4. Razmatranje i usvajanje prijedloga-odluke za formiranje Komisije za izbor (ODO);
5. Razmatranje i usvajanje prijedloga-odluke za zamjenu člana Komisije za ocjenjivanje;
6. Finansijski izvještaj januar - jun 2024. godine;
7. Izveštaj Saveta za kulturno nasleđe Istorijskog centra Prizrena za period avgust 2023-jun 2024;
8. Informacija o završetku školske 2023/2024 godine i informacija o početku nove školske 2024/2025 godine;
9. Diskusija o izveštaju Nacionalne kancelarije za reviziju (NKR) za godišnje finansijske izveštaje opštine Prizren za 2023. godinu i akcioni plan za sprovođenje preporuka za 2023. godinu;
10. Informacija o izveštaju o radu Jedinice za internu reviziju (JIR), za period januar-avgust 2024. godine;
11. Izveštaj o performansi opštine za opštinu Prizren, za 2023. godinu.



Predsedavajuća KPF
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

PRİZREN BELEDİYE MECLİSİ

Siyasi ve Maliye Komitesi

No. 001/060 – 124951

Tarih: 13 Eylül 2024



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Öz Yönetim Kanun'un 52. Maddesi, 1. Fıkrası, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 59. Maddesi gereğince **24 Eylül 2024** tarihinde (**Salı günü**) saat **10:00** da "Beyaz Evde" SMK toplantı salonunda Siyasi ve Maliye Komitesinin düzenlenecek olan toplantıya katılmanız için çağrıda bulunuyorum.

Böylelikle toplantının belirlendiği tarihte, saatte ve yerde Belediye Meclis üyeleri sıfatında katılmanız için davetlisiniz.

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir:

GÜNDEM

1. 16 Temmuz 2024 tarihli tutanağın görüşülmesi ve onaylanması;
1. Gündemin görüşülmesi ve onaylanması;
2. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların dile getirilmesi;
3. (2024-2026) cinsiyet eşitliği yerel eylem planının görüşülmesi ve onaylanması;
4. (BEM) Seçim Komisyonunun oluşturulması için öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
5. Değerlendirme Komisyonunun oluşturulması için öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
6. 2024 Ocak – Haziran finansal rapor;
7. 2023 Ağustos – 2024 Haziran dönemine ilişkin Prizren Tarihi Merkezin Kültürel Miras Kurulunun raporu;
8. 2023/2024 okul yılının tamamlanması ile ilgili bilgi ve 2024/2025 yeni okul dönemin başlaması hakkında bilgi;
9. 2023 yılı Prizren Belediyesinin yıllık mali tablosu ve 2023 yılı önerilerin uygulanması ile ilgili eylem planına ilişkin Ulusal Denetim Ofisi (BEM) raporu hakkında tartışma;
10. 2024 Ocak – Ağustos dönemine ilişkin İç Denetleme Birimin çalışma raporu hakkında bilgi;
11. 2023 yılı Prizren Belediyesinin Belediye Performans raporu.



SMK Başkanı
Antigona Bytyqi

(Handwritten signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 86709

Më: 16 korrik 2024

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 16 korrik 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:15 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj dhe Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj dhe Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi, Nënkyetar i Komunës, Luljeta Veselaj Gutaj nga DASH, Ramadan Tarashaj nga DTZHE, Çelë Lamaj dhe Muhamet Bajrami nga DSHP, Gjafer Ponik nga DEF, Gursel Skenderi nga Sektori i pronës, Mybexhele Zhuri nga NJBGJDNJ, Veron Tara nga KTKQHP, Fadil Berisha dhe Besar Grezhda nga Hidroregioni, si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Përsëndetje i nderuar Nënkyetar, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, të nderuar drejtor, të nderuar zyrtar të drejtorive, përfaqësues të mediave, përsëndetje për të gjithë ju të pranishëm. Për sot, siç jeni të njoftuar për sot kemi thirr mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi tetë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, kështu që mund të fillojmë me punimet e kësaj mbledhjeje. Për rend dite kemi këto pika:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 26 qershor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Prizrenit 2024-2029;
6. Informatë rreth gjendjes së furnizimit me ujë, menaxhimit të mbeturinave dhe energjisë elektrike;
7. Raporti financiar janar - qershor 2024;
8. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor;
9. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024.

Antigona Bytyqi: Në fillim e thash që jemi tetë anëtarë, por tash po e shoh që jemi shtatë anëtarë se nuk e pashë që për momentin mungon Ademi. Atëherë pa humbur kohë po fillojmë me pikë e parë.

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 26 qershor 2024;

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka me shtuar rreth procesverbalit? Po Dafina Urdhëro.

Dafina Alishani: Kryesuese ishin disa gabime aty. Prej diskutimit të shadërvanit kish kyç procesverbali të pjesa e rekomandimit të Florentit për bujqësi, pastaj prap kthehem në shadërvan, në renditje ka gabime.

Blerim Rakaj: Qysh u kanë inçizimi u bë, por mundemi me e verifiku edhe njëherë.

Dafina Alishani: S'mundemi me pasë inçizimin tuj fol për shadërvan e me dal për bujqësi! Ka gabim teknik edhe po ju lus me rregullu.

Blerim Rakaj: I referohemi inçizimit edhe njëherë edhe e rishikojmë, nëse ka diçka e përmirësojmë.

Dafina Alishani: Nuk ka mundësi në mes të shadërvanit me dal në...

Egzona Hoxhaj: Po qashtu kemi fol.

Bajram Kastrati: Qashtu jena deklaru.

Antigona Bytyqi: Atëherë kërkohet që edhe njëherë të ndëgjohej inçizimi edhe në qoftëse ka nevojë për përmirësim e bëjmë. Dikush tjetër? Në qoftë se s'ka, atëherë po e hedhim në votim. Prezent jemi shtatë anëtarë. Kush është për që të miratohet procesverbali?

Karanfil Haxhillari: Me vërejtje apo?

Antigona Bytyqi: Po me vërejtje për rishikim. Unanimisht ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika e dytë,

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i ditës.

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka me shtu rreth rendit të ditës? Po urdhëro znj. Mybexhele.

Mybexhele Zhuri: Faleminderit Kryesuese. Kisha dashtë që pika e Draft-planit komunal për barazi gjinore të hyjë në rend dite sepse është gati prej muajit maj. Për shkak të ngarkesave me pikat tjera është shtyrë shqyrtimi i këtij plani.

Antigona Bytyqi: Plani komunal i veprimit për Barazi Gjinore apo?

Mybexhele Zhuri: Po.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Dikush tjetër? Po urdhëro Bajram.

Bajram Kastrati: A e kalon afatin, që për me hy në rend dite është puna se kemi shumë pika të rendit të ditës?

Mybexhele Zhuri: Po veç viti po kalon, pasi që më shumë se gjysmën ne e kemi paraparë me aktivitete, kështu që po duhet. Edhe është nevojë për shkak të performancës komunale, është një prej kritereve.

Antigona Bytyqi: është fakt që ka qenë e përgatitur prej muajit maj, por për shkak të disa intervenimeve të vogla që kanë pas me i bë drejtoritë edhe një ditë para se me thirrë seancën nuk ka qenë gati për një intervenim të vogël, kështu që se kemi qitë.

Karanfil Haxhillari: Po bre, por është një plan që edhe ndonjë material nuk kemi, neve seancën e kemi pasnesër. Në qoftëse vijnë këto dokumente që me të vërtetë e kanë një rëndësi shumë të veçantë për qytetarët e Komunës së Prizrenit edhe neve si kuvendar na nevojitet një kohë që të përgatitemi që të japim vërejtjet tona, që të japim ndonjë, apo vetëm doni me na pru me na servu edhe votu.

Mybexhele Zhuri: Jo aspak, këtë plan pune e kam dërguar me kohë edhe te Kryesuesja, ky plan e ka kaluar edhe dëgjimin publik, ashtu që këto procedura i kam ndjekur të gjitha. Nuk n'varet prej meje futja në rend dite, unë nga ana ime i kam kryer procedurat.

Antigona Bytyqi: Po veç a ka pasur drejtoria me bë një intervenim, unë s'kam pasur qysh me futë në rend dite pa atë përmirësim.

Mybexhele Zhuri: Jo, Kryesuese më vjen keq, ky intervenim ka të bëjë me planin për dhunë në familje sepse me vetë planin për barazi gjinore është parapame, një prej pikave është, një prej objektivave është edhe hartimi i planit dhe aktiviteteve rreth dhunës në familje. Plani ka filluar më vonë për dhunë me u hartu edhe ende nuk është as Draft i gatshëm si të them. Ashtu që ky plan ka përparësi para atij edhe ka ndërhy dikush që ndoshta se ka kuptu mirë natyrën.

Antigona Bytyqi: Unë kam pasur kërkesë që mos me e futë në rend dite sepse nuk është gati.

Mybexhele Zhuri: Atë nuk e kam ditë unë, por unë kam pritur që do të jem në këtë asamble, ashtu që.

Antigona Bytyqi: Mirë mirë, ju e dhatë propozimin të shohim pastaj vendosim ne këtu bashkërisht.

Dafina Alishani: çka po thu o Levent, fol pak më shumë.

Levent Bus: Mendimi im është le të hyn në rendin e ditës.

Dafina Alishani: Po bre le të hyn por nëse kuvendi ka me votu, ish dashtë na me pasë një dokument. Edhe dëgjimet publike i keni ba por na si kuvendar nuk e kemi marrë asnjë ftesë! E mbaj mend atë ditë ju kam taku, s'ka pas hiç prezencë. Nëse bëni dëgjime publike veç sa me e bë, mos bëni hiç.

Mybexhele Zhuri: Unë nuk jam ajo që i thërras, unë vetëm i njoftoj organet kompetente.

Dafina Alishani: Në rregull, por ish dashtë me u marrë me mbarvajtjen edhe kur po adresohet ky plan. Kuvendaret nuk e di a kanë pasur qasje, përveç ndoshta Komisionit për Barazi Gjinore nëse kanë pasur qasje aty, ne kuvendaret nuk kena pasur. Nuk e di qysh po doni me ba plan pa bashkëpunu me kuvendaret!

Mybexhele Zhuri: Jo, kuvendaret kanë qenë edhe pjesë e planit.

Dafina Alishani: Jo s'kanë qenë pjesë e planit, unë për vete s'kam pranuar as ftesë, as dokument, as asgjë!

Antigona Bytyqi: Kështu, është bë propozimi, tash e vendosim, edhe materialin besoj e përcjellim.

Dafina Alishani: Nuk jemi na kundër kësaj, por jemi kundër që vijnë gjërat kur këtu prap ka me pasur nevojë për kuvend. Çka kena me votu? Një plan të cilin e ka bë dikush që as nuk na ka përfshi! Nëse s'ka afate ligjore, ka shumë pika, e lëmë për seancën e radhës.

Antigona Bytyqi: Propozime tjera a kemi? Atëherë kështu, u bë një propozim që Plani Komunal për barazi gjinore të hyjë në rend dite, po e hedhi në votim, kush pajtohet për me e fut sot në rend dite, materiali do të ju dërgohet sot gjatë ditës së bashku me rekomandimet në qoftëse keni pajtueshmëri. Atëherë po e hedhi në votim propozimin e ri që u bë tash. Kush është për që të hyj në rend dite? Gjashtë jemi për, zero kundër dhe dy abstenim. Atëherë bashkë me propozimin e ri po e hedhim në tërësi rendin e ditës në votim. Po urdhëro karanfil.

Karanfil Haxhillari: Meqenëse e kemi pasur edhe raportin e auditimit të auditorit gjeneral të përgjithshëm, ish kanë e mirë që para se me shku në pushim që ta kemi si kuvend hapësirën dhe mundësinë për diskutim mbi raportin e auditimit të përgjithshëm për komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi: Me sa e di në shtator e kemi në plan të punës edhe me sa më kujtohet zakonisht në shtator kjo është.

Bajram Kastrati: Nxehtë është.

Kujtim Gashi: Ama raporti është i ftohtë.

Karanfil Haxhillari: Me kanë i ftohtë nuk e kisha kërku.

Kujtim Gashi: Qysh të doni, raporti është gati.

Karanfil Haxhillari: Unë po besoj që raporti është publikuar ka disa kohë.

Bajram Kastrati: Fili është në pyetje se kemi disa informata këtu e që janë shumë të rëndësishme, edhe gjendja e furnizimit me ujë, edhe mbeturinat edhe po ztërzgjetet seanca. Prandaj nuk kisha thënë, për këtë abstenova edhe te pika tjetër.

Karanfil Haxhillari: Para se me qit në votim, nëse me të vërtetë është në planin e punës së kuvendit, atëherë le të mbetet në shtator.

Antigona Bytyqi: Atëherë a ka nevojë me qitë në votim?

Karanfil Haxhillari: Jo jo, mos ta ndryshojmë planifikimin.

Dafina Alishani: Atëherë a bënë kështu po ja bëjmë, këto informatat që ju po i konsideroni shumë me rëndësi me i qit në fillim sepse kur po i kemi në fund s'po ka kurrfarë efekti.

Antigona Bytyqi: Jo bre këto janë sipas Rregullores.

Dafina Alishani: Sipas rregullores po, por unë e di që ti pikën e tetë gjysmën e kuvendit nuk ki me pasë në sallë.

Antigona Bytyqi: Ato që kanë interesim besoj që kanë me qenë aty.

Florent Ukaj: A mundemi me bë një ndërrim që pikën e tetë me e qitë më përpara, le të jetë prej informatave e para.

Antigona Bytyqi: Si pikë e gjashtë a?

Florent Ukaj: Po. Nëse mendoni që është një prej pikave më të rëndësishme atëherë propozoj që pika e tetë të bartet si pikë e gjashtë.

Antigona Bytyqi: Atëherë propozimin që e dha Karanfilin e lamë për shtator. Tash u dha një propozim që pika e tetë të kaloj si pikë e gjashtë, pastaj pika e gjashtë del shtatë e kështu me radhë. Kush është për që pika e tetë të kaloj si pikë e gjashtë? Unanimisht, ju faleminderit. Tash po e hedhim rendin e ditës në tërësi në votim me ndryshimet që i bëmë, kush është për që të miratohet ky rend i ditës? Unanimisht, ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;

Antigona Bytyqi: Gursel fjala për juve.

Gursel Skenderi: Faleminderit Kryesuese. Në aspektin juridik komunat kanë të drejtë të japin pronën komunale në shfrytëzim organizatave të shoqërisë civile me qëllim të përmbushjes së interesit të përgjithshëm. Dhënia e pronës komunale organizatave të shoqërisë civile bëhet përmes procedurës së konkurimit, kurse të drejtë në konkurim sipas ligjit kanë vetëm ato organizata joqeveritare të cilat veprojnë në territorin e komunës së Prizrenit. Afati i dhënies sipas ligjit këtyre

organizatave është afatshkurtër, d.m.th. kanë të drejtë afatshkurtër, jo afatgjatë. Kjo është, ju faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Gursel. Urdhëro Nënkyetar.

Kujtim Gashi: Gursel e tha në aspektin juridik, unë po them në aspektin politik. Besoj që për rëndësinë e kësaj kuzhine nuk ka nevojë shumë me folë.

Karanfil Haxhillari: Tash a kuzhinë apo shoqëria civile e marrin?

Kujtim Gashi: Tash ta spjegoj. Prizreni e ka një kuzhinë popullore që është private, po menoj private që i shërben personat që kanë nevojë në ushqim ditorë. Por, idea është me të një kuzhinë popullore e cila në aspektin e menaxhimit është e miksume bashkë me ndonjë operator ose organizatë e cila shprehë interesim me menaxhu këtë kuzhinë popullore. Edhe investimet besoj që në bazë të këtyre besoj do të jenë prej jashtë. Kështu që komuna krejt çka oforn në këtë çështje është tokë, hapësirën për afat të caktum të cilin e keni në propozim-vendim. Besoj që është propozim i rëndësishëm edhe i nevojshëm për qytetin e Prizrenit edhe besoj që ka nevojë për mbështetjen e këtij komiteti por edhe të kuvendit në seancën e ditës së enjte.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Nënkyetar. A ka ndokush tjetër me shtu diçka reth kësaj pike?

Karanfil Haxhillari: Në bazë të kësaj që po shkruhet, edhe është në rregull kjo që po shkruhet shumë ligjore, ahumë e natyrshme, qysh duhet të jetë. Por realiteti është komplet tjetër, pra këtu në vend se shoqërisë civile, thuajeni burrë jetimave të ballkanit edhe në rregull jemi. Po kërkoni konkurrencë a po kuptoni por prap do të jetë vetëm, mos gabofsha veq mos ja kanë nisë punimet aty. Në fakt qëndrimi jonë si Lëvizje Vetëvendosje po më vjen mirë sepse themelimi i një kuzhine popullore është në aspektin social i domosdoshëm, shumë i mirë edhe na përket edhe neve si të majtë që jemi, domethënë e mbështesim këtë iniciativë. Por, proceduralisht me të vërtetë është kjo pak, po më vjen tallje me qytetarët apo Gursel keni me ja dhënë jetimave të ballkanit?

Gursel Skenderi: Na nuk marrim pjesë, është pika e rendit të ditës komisioni vlerësues që i përgatit edhe i zhvillon procedurat, neve veq na sjell fituesin edhe i përpilojme kontratat në bazë të tyre.

Kujtim Gashi: Karanfil banu pjesë e këtij komisioni edhe jepja qatij që e meriton.

Karanfil Haxhillari: çka në qoftëse është veq një ofertues?

Gursel Skenderi: Ligji e rrekon, mundet edhe një ofertues, por ai ofertues nëse i përmbush kushtet, kriteret mundesh me ja dhënë, ligji është ashtu. Domethënë ese i përmbush kriteret edhe me një ofertues.

Karanfil Haxhillari: Vetëm të jemi, pasi po thirreni në transparencë, po thoni komuna ma transparente, në këtë rast qekjo nuk është hiç transparencë.

Kujtim Gashi: Pse?

Karanfil Haxhillari: Me ja dhënë 20 ari në zemër të qytetit në Bazhdarhane po e dini ku është, te Çerdhja Yllka, nuk jam kundër por 20 ari për një kuzhinë a nuk po ju doken që janë shumë? Prap unë po them, nuk jemi kundër këtyre iniciativave sepse si qëllim, si ide e kuzhinës është ok, por proceduralisht në letra krejt diçka tjetër është, në praktik do të jetë krejt diçka tjetër. Kjo është domethënë jo transparente dhe kjo është në fakt me këqyr holl e hollë edhe jo ligjore. Do të shihet tash e mbas, unë nuk dua të jem ai i cili e kundërshton një projekt sidomos kur është çështja kur ka të bëjë me bamirësi. Por që forma, procedura janë me të vërtetë që lëjnë shumë për të dëshiruar.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Karanfil. Urdhëro Dafina.

Dafina Alishani: A nuk ekziston mundësia me bë dhënia në shfrytëzim me emërim të OJQ-së sepse tashmë po dihet, na të njetën e kemi pasur edhe me stadiumin e qytetit. Formalisht i banëm krejt procedurat por në fund u dike kush ka me marrë. A është e drejta e kryetarit sikurse ka bë me OJQ-të tjera me që me vendim ja jep në shfrytëzim, a nuk mundemi me e bë atë, pse jo?

Gursel Skenderi: Jo Dafina, neni 16 sipas rregullores është veç me konkurim.

Dafina Alishani: si ja dhamë PPDMK-së mrapa bibliotekës?

Kujtim Gashi: Ajo u kanë afatshkurtër.

Bajram Kastrati: Për sa vjet është kjo?

Gursel Skenderi: është propozimi 15 vite, se afatshkurtër është prej 1-15 vite, kryetari ka propozuar 15 vite.

Dafina Alishani: çka ka me përfshi aty përveq kuzhinës popullore?

Gursel Skenderi: Atë bartësi i projektit e din.

Dafina Alishani: Kush është bartësi i projektit? Ju si zyre e pronës ish dashtë me ditë për çka po jipet.

Gursel Skenderi: Po jipet për projektin, na nuk e bëjmë projektin Dafina, DPMS-ja, e ka projektin.

Dafina Alishani: Gursel a po kuptohemi, ju si zyre e pronave mirreni veç me procedura.

Gursel Skenderi: Në aspektin juridik, po ashtu.

Dafina Alishani: Mu si kuvendare më duhet me ditë se çka ka me pasë në atë hapësirë të madhe?

Gursel Skenderi: Prej bartësit projektit duhet me pyet.

Dafina Alishani: Kush është bartësi i projektit?

Gursel Skenderi: Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Dafina Alishani: Ku është drejtorja e mirëqenies? Pse s'ka ardhur me na informu?

Çelë Lamaj: Kryesuese a ka mundësi ti përgjigjem profesionalisht pak?

Antigona Bytyqi: Po urdhëro drejtor.

Çelë Lamaj: Derisa prona jep një lokacion, qaj përfituesi i atij lokacioni ka me ofru një projekt, i cili projekt duhet me ju dhënë edhe leje të ndërtimit, duhet të hapet një diskutim publik edhe rreth projektit apsolut, ku keni me mujt me marrë pjesë edhe ju kuvendarët, shoqëria civile, qytetarët dhe gjithë akterët të cilët kanë interes për me pa se çka do të ndërtohet në atë lokacion. Kështu që, kjo është procedurë vetëm dhënie në shfrytëzim një hapësirë ku do të ndërtohet një objekt, në këtë rast e tha Nënkrjetari një kuzhinë popullore. Atëherë projekti ka me ta përcaktu ty sipas lokacionit, ke me pa cila është hapësira që ju duhet atyre që ne nuk mundemi me ditë.

Dafina Alishani: A nuk është diskriminim kjo krahas OJQ-ve tjera, domethënë pse një OJQ me pas këtë.

Çelë Lamaj: Po le të konkurojnë të gjithë OJQ-të të cilët kanë një interes për me ndërtu edhe me dhënë bukë pa pare. Gjethkush mundet me konkuru, nuk ka një adresë që mundesh me thënë që filani ka me marrë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor. Bajrami fjalën e ka.

Bajram Kastrati: Te konkurenca drejtor, këta që do të konkurojnë për me marrë, a ofrojnë projektin qaty te konkurenca apo bahet projekt mandej pasi ta fiton atë.

Çelë Lamaj: Masi ta merr lokacionin.

Gursel Skenderi: N'varet edhe prej Komisioni i cili i vendos kriteret.

Bajram Kastrati: Edhe tjera Dafinë, po më duket ndoshta paragjykim kjo që po destinohet, po orientohet për një organizatë të caktume. Ku po bazohesh përderisa e kemi edhe komiosionin?

Karanfil Haxhillari: A po lidhem?

Dafina Alishani: Këta pa pasur destinacion deri tash asnjë pikë s'na kanë sjellë.

Bajram Kastrati: Unë jam tuj folë parimisht, seriozisht edhe ligjërisht. A kemi naj hapësirë qetu te nenet që na është i orientuar për një organizatë të caktume? Apo veç po paragjykoni.

Karanfil Haxhillari: Po dihet mor burrë.

Bajram Kastrati: Po jo bre se s'dihet përderisa komisioni ka mu përzgjedh prej anëtarëve të kuvendit Fil, qysh dihet?

Karanfil Haxhillari: Po aty ja kanë nisë punës o burrë.

Kujtim Gashi: Karanfil, a po hyn ti?

Bajram Kastrati: A nëse ja ka nisë projekti, ajo është diçka tjetër.

Kujtim Gashi: S'ja ka nisë jo.

Bajram Kastrati: Jo se tash kur e votojmë, mos ta votojmë me paragjykim.

Karanfil Haxhillari: Këtu në bazë të ligjit është qekjo që po e thotë dhe shumë mirë nenet, në rregull jemi qysh e përcakton ligji. Por, realiteti do të jetë krejt ndryshe sepse.

Bajram Kastrati: A është paragjykim kjo?

Karanfil Haxhillari: Në qoftëse kemi të bëjmë me një kuzhinë popullore apo drejtor?

Çelë Lamaj: Po.

Karanfil Haxhillari: çka nëse bëhet aty edhe një administratë, një zyre administrative?

Çelë Lamaj: Dëgjo, nëse don me fol profesionalisht atëherë ti nëse don me e kuptu se çka është një projekt, atëherë nuk ka objekt i cili nuk e ka edhe një pjesë administrative i cili duhet me u menaxhu nga një menaxhment, atë duheni me e ditë. Edhe në shtëpi tane nëse ke mundësi financiare ke me e bë një kënd pune, d.m.th. ke me bë një zyre, në shpi tane private e le ma në institucione. Kjo ka me qenë institucion edhe aj institucion duhet me pas...

Karanfil Haxhillari: A e kemi të drejtën për ne si kuvendar, në këtë rast përfaqësues të qytetarëve të komunës së Prizrenit, para se me e votu me e ditë se çka do të bëhet?

Çelë Lamaj: Komisioni ka me ditë edhe keni me e paraqitë aty.

Karanfil Haxhillari: Në momentin që ne e votojmë masnesër 20 ari shkojnë, a po kupton.

Kujtim Gashi: Nuk shkojnë, në shfrytëzim jepen.

Dafina Alishani: Po më vjen mirë që drejtorinë e mirëqenies Sociale e paska fillu çela edhe atë drejtori me e kaplu.

Çelë Lamaj: Jo, nuk kaploj unë ti Dafinë kurgjo hiç, po mundona me ndihmu.

Dafina Alishani: Drejtor, ish dashtë bre drejtori i cili e ka si sponsorizues ish dashtë me ardhë qetu me na tregu. Unë se di pse Drejtori i DSHP-së ka nevojë me na spjegu për mirëqenie! Flet për turizëm, flet për mirëqenies, heqni drejtoritë, s'po jeni serioz.

Antigona Bytyqi: Nënkryetari e ka fjalën. Ju lutem flisni me radhë për shkak të procesverbalit, ta mbajmë një rregull.

Kujtim Gashi: Disa projekte në mënyrë automatike barten edhe nëpër sektorët e vetë sipas natyrës. Ky është prioritet i Kryetarit të Komunës, s'ka të bëjë me drejtori por natyrisht që një drejtori e bartë projektin. Edhe një rrugë e caktume është prioritet i kryetarit por e bartë shërbimet publike sepse s'mundet se s'mundet me bartë zyra e kryetarit. Kështu që në këtë kontekst jemi në

rregull. Pse s'është drejtori, jemi ne të tjerët këtu e para. E dyta, ky është hap i parë që kuvendi me vendim e jep në shfrytëzim një pronë për një qëllim të caktuar të cilin qëllim e keni në vendim. Tash në vendimin e dytë e keni me formu komision, edhe ti nëse don me ditë po ja jep autoritetin qatij komisioni me i zhvillu procedurat sepse krejt kuvendi 41 anëtarë s;munden me kanë në komision, i ka përcaktuar ligji këto procedura. Në momentin kur ja jep votën ti i ke besu një anëtar që e ke qu në këtë komision edhe qaj anëtarë ka të drejtë edhe me të raportu edhe me të njoftu ty për ecurinë e punëve. Nuk ka aktualisht projekt, ka një qëllim, qëllimi është me u ba kuzhina popullore, tani procedurat janë në vazhdim dhe ajo për 1 javë nuk bëhet. Ai që e fiton ka me prezantu projektin, ka me marrë lejen, ka me i marrë kushtet, janë do procedura që të gjithë i dimë, se di pse po hyjmë në debate të panevojshme! Nëse është e nevojshme kuzhina popullore duhet me e mbështetë, nëse nuk është e rëndësishme duhet me kundërshtu, dy gjëra janë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Nënkyetar. Dikush tjetër?

Karanfil Haxhillari: Edhe njëherë të sqarohemi, a e din të mos keqkuptohemi. Kuzhina popullore është e mirëseardhur për Komunën e Prizrenit e cila me të vërtetë ka skamnorë, nuk jemi kundër apsolutisht kësaj. Vërejtjet tona dhe ky debat u zhvillua kryesisht në bazë të pjesës ligjore dhe në bazë të pjesës tjetër të cilën pe dimë dhe që shpresoj të shkoj sa më mirë. Por ama kundër politikave sociale nuk jemi.

Antigona Bytyqi: Atëherë prezent jemi nëntë anëtarë, po e hedh në votim pikën e tretë që ti rekomandohet mbledhjes që do të mbahet të enjten. Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues

Antigona Bytyqi: atëherë siç e dini për secilin vendim paraprak që e merr kuvendi komunal, duhet me formu një komision. Përbërjen besoj që tashmë e dini: 2 anëtarë do të jenë nga kuvendi, dy nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile. Ne si kuvendar shkojmë me formulën qysh e kemi pasur 1 pozitë, 1 opozitë, e dini formulën.

Dafina Alishani: Formulën që e urren Bajrami.

Bajram Kastrati: Unë jam parimor dhe vazhdoj të jem, le të përzgjedhen dy anëtar të kuvendit, s'ka pozitë-opozitë. Munden me u zgjedh 2 të opozitës pasi në këtë rast janë veç dyshime që po thu është i orientum. Le të shkojnë dy të opozitës edhe qata e përcaktojnë. Si proces unë prej fillimit jam kanë kundër pozitë-opozitë për ndarje sepse nuk po e përcakton ligji edhe jam kundër.

Kujtim Gashi: Duhet të jetë zëri i pushtetit dhe i opozitës, jo veç një krah.

Bajram Kastrati: Kam qenë parimor edhe vazhdoj të jem.

Antigona Bytyqi: Kështu që, emrat i sigurojmë atë ditë në kuvend edhe nga ekzekutivi edhe nga shoqëria civile. A keni dikush tjetër me shtu diçka. Nëse jo atëherë po e hedhi në votim edhe pikën e katërt. Prezent jemi nëntë anëtarë, kush është për? 8 janë për. 0 kundër dhe 1 abstenim. Kalojmë te pika e pestë.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Prizrenit 2024-2029; 26.20 min.

Antigona Bytyqi: Fjala për juve Nënkyetar.

Kujtim Gashi: Jemi këtu bashkë me drejtorin, por si proces e kam bartë pak më shumë unë edhe po mundohem shumë shkurt ta sqaroj sepse dokumenti është shumë voluminoz. Në fakt kur kemi filluar hartimin e dokumentit i kemi pasur vërejtjet tona për shkak se dokumenti ka shumë përshkrim edhe i tërë KAB-i është i përfshimë në këtë strategji, por fatkeqësisht kjo është edhe një fushë që duhet me përfshi për shkak se strategjia bazohet në programin nacional për zhvillim ekonomik lokal edhe në udhëzimin administrativ përkatës edhe që të dy këto dokumente i obligojnë komunat me i përshi komplet këto që i kemi paraparë në këtë dokument. Gjatë diskutimit publik por edhe në diskutim me komunitetin e biznesit ka lindur më shumë idea me pas pak më shumë progres në të ardhmen vizion, parashikim por megjithatë ka edhe shumë material pa u përfshirë meqë këto dy dokumente na kanë obligu dhe ne s'kemi mujt me i tejkalu për shkak se edhe në shkresën e ministrit të pushtetit lokal i cili ka kërku që komuna me përfundu strategjinë për zhvillim ekonomik lokal edhe me u bazu në mënyrë eksplicite në të dy dokumentet edhe në strategjinë dhe programin nacional për zhvillim edhe në udhëzimin administrativ i cili e rregullon këtë fushë. Kështu që e di që ka me pasur vërejtje pak më shumë në atë pse është përshkru ma shumë edhe historiku i Prizrenit edhe që ka Prizrenit kapacitetet ekonomike. Një pjesë e madhe e dokumentit është i përfshirë buxheti d.m.th. KAB-i, psh. drejtoresha e arsimit e ka pasur një vërejtje ku janë të përfshimë disa projekte që aktualisht ose janë tuj u realizu ose ndonjë prej tyre edhe ka përfundu, por ai figuron për shkak se është marrë prej KAB-it edhe rregulli që është paraparë me u përfshi. Përkundër vërejtjeve që kanë ekzistuar dokumenti si i tillë është qind për qind i bazum në programin nacional të qeverisë edhe në udhëzimin administrativ edhe çdo gjë që mundemi me i hjek për me u largu prej këtij dokumenti kërkush nuk mundet me siguru që i njëjti nuk kthehet prap prej ministrisë për rishqyrtim për shkak se ka praktika të tilla për disa komuna që kanë ba planin qysh kanë mendu ato vetë. Struktura, korniza edhe krejt janë të bazuara në programin nacional për zhvillim ekonomik loka. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Nënkyetar. A ka dikush me shtuar diçka rreth kësaj pike.

Dafina Alishani: Jam e interesuar me ditë cilat OJQ kanë marrë pjesë në përpilim e kësaj strategjie? Për shkak se sikurse e pashë prej OJQ-ve vetëm AZHR-ja ish pjesëmarrës.

Kujtim Gashi: AZHR-ja ka qenë pjesë e hartimit.

Dafina Alishani: Ju keni vendosur si grup punues apo ?

Kujtim Gashi: Grupi punues e kemi kërku mbështetje dhe ndihmën e tyre në aspektin profesional.

Dafina Alishani: Pa thirrje pa kurgjo, vetëm ju keni vendosur?

Kujtim Gashi: Po thirrje s'kemi pasur sepse si kemi paguar.

Dafina Alishani: Ok. Sa i përket OJQ-ve tjera të cilat përfaqësojnë bizneset a kanë pasur pjesëmarrje në përpilim të këtij dokumenti. Ishin aty disa të dhëna qesharake të cilat nuk e di a

është dashtë me i paraqitë se cilat shërbime i jep komuna! Apo vetëm sa me e bë dokumentin voluminoz e kanë pa të arsyeshme për me e vendos atë. Edhe te pjes e çështjes së grave jeni duke u tallë me gratë e qytetit! Flitni aty për pjesëmarrjen e grave, flitni aty për rëndësinë e grave ndërsa në praktikë na i shohim që kërka nuk jeni me ato objektiva të cilat i keni pas edhe para fushatës edhe pas fushatës. Andaj, ju kisha lutur hjekni komplet ato fjalitë që i zbukuroni e që i lavdëroni gratë, domethënë as në strategji nuk e kanë vendin sepse nuk i keni ju qëllim me i përfshi gratë, ajo shihet edhe në akzekutiv ose p.sh. e keni cek aty që mbrojtja kundër diskriminimit ose ngacmimit, ndërkohë ngacmuesit i keni hala nëpër shkolla e sinjalizuesit po i largoni prej shkollave. A e din, për strategji disa herë e kam thënë edhe prap po ju them, dorën ja u zgjas për dokumente, në praktik kur po vjen po qaloni. Te pjesa e zonës ekonomike nuk pashë shumë dokumente ose të dhëna se çka pritet për zonën ekonomike, kur flasim për një strategji afatgjate për ekonomi, ish dashtë me pasë prioritet të lartë zonën ekonomike por edhe informatat në qet strategji për zonën ekonomike. Ato po mbesin prap në dokumente edhe nuk na intereson se a i përmbushim ato.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Dafina. Po urdhëro Bajram.

Bajram Kastrati: Sigurisht që si dokument është pak i madh me diskutu për secilën veç e veç por një vërejtje që e kam vërejt në fillim është te territori i komunës së Prizrenit përfshihen 76 vendbanime përfshirë fshatrat Atmaxhë dhe Arbanë. Arbanën e keni shti në mesin e fshatrave.

Kujtim Gashi: Fshat është.

Bajram Kastrati: Ka qenë por tash s'është. Ka edhe vërejtje tjera që kemi mi prezantu. Për që jemi fshatar nuk jemi në fshat por në lagje të qytetit. Unë se kam problem se jam edhe katunar edhe fshatar por dikush preket. Nuk është e drejtë sepse është lagje edhe zyrtarish është lagje edhe me tabela edhe me futë në mesin e fshatrave.

Kujtim Gashi: Këtu qenkan krejt fshatrat.

Bajram Kastrati: po de edhe Arbana fshat është, ti a po don Arbanën me Atmaxhë me krahasu a, s'mun me krahasu, ti je ma tutje.

Kujtim Gashi: Veç me ta spjegu nëse më lejon.

Bajram Kastrati: Po nuk janë në lagje të përfshime nënkryetar, këqyri.

Kujtim Gashi: Në rregull, a po më ndëgjon pak. Nëse më ke ndëgju kur kam folë thash është një përshkrim që bazohet në dokumentet ekzistuese dhe në dokumentet ekzistuese Arbana është fshat në të dy dokumentet ekzistuese.

Bajram Kastrati: Jo.

Kujtim Gashi: Në dokumentet e reja është lagje por ne punojmë në dokumentet të cilat hala s'janë ndërru, referoju pak edhe Statutit të komunës edhe e sheh aty, përndryshe pajtohna që është lagje.

Antigona Bytyqi: Vendbanim bre i paskan thënë Bajram.

Bajram Kastrati: Vendbanim or si ka cekt edhe vendbanimet tjera, as Dardaninë se ka cek, veç Arbanën e ka shti në mesin e fshatrave.

Çelë Lamaj: Gjithçka çka është brenda hartës zonale ma është paralagje, lagje.

Bajram Kastrati: Po duhet na tash me votu një diçka që!

Antigona Bytyqi: Bajram a ke diçka tjetër?

Bajram Kastrati: Jo jo, qeta për momentin e në seancë tjerat mundemi me i diskutu.

Kujtim Gashi: Mundemi me e ndërru por thashë çdo ndërhyrje bjen në kundërshtim me dokumentet ekzistuese.

Bajram Kastrati: Tashi na me Landovicë e me Atmaxhë s'mundemi me u krahasu.

Florent Ukaj: çka ka Landovica e Atmaxha.

Dafina Alishani: Te sfidat te secili sektor, te sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale nuk ka asgjë, d.m.th. po shihet që e ka lënë zbrast për me e plotësu drejtoria përkatëse. Unë mendoj që është e mangët ose a planifikohet me u paraqitë edhe këto sfidat apo drejtorat nuk po kanë kohë me u marrë me këtë strategji. Te sfidat ne e kemi të zbrazët pastaj te pjesa e objektivit është paraqitë edhe shëndetësia dhe mirëqenia sociale, ju rekomandoj me e plotësu këtë pjesë te zbrazët. Edhe kush e ka përgjegjësi këtë me e monitoru se këto objektivat se këto objektiva a po mirren parasysht apo jo, ky grup që e ka bënë apo direkt kryetari si si menaxher.

Kujtim Gashi: Grupi në fakt e kryen punën ditën kur miratohet si komision edhe e pushon aktivitetin. Ndërkohë mbikëqyrja është e kezekutivit edhe në raport përfundimtar bazohet edhe në këtë farë dokumentin e qeverisë në planin nacional ku bëhet një analizë e përgjithshme edhe e planit edhe e strategjive komunale rreth implementimit, domethënë ka me qenë një raport nacional përfundimtar edhe për komunat edhe për qeverinë.

Dafina Alishani: Bartëse a nuk është Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik?

Kujtim Gashi: Në këtë strategji është zyra e kryetarit sepse është gjithëpërfshirës.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër, a keni diçka me shtuar? Në qoftëse jo po e hedhi në votim edhe pikën e pesë. Prezent jemi 9 anëtarë, kush është për që ti rekomandohet mbledhjes? 6 jemi për, 0 kundër dhe 3 abstenim. Faleminderit edhe kjo pikë i rekomandohet mbledhjes. Kalojmë te pika e gjashtë.

Pika e gjashtë:

Informatë rreth gjendjes së furnizimit me ujë, menaxhimit të mbeturinave dhe energjisë elektrike.

Antigona Bytyqi: Ne e kemi të përfshirë edhe furnizimin me ujë, mbeturia dhe energji elektrike sepse në pajtueshmëri me drejtorin Çelë Lamaj, që përfaqësuesit me i ftu, kemi kërku informata edhe prej KEDS-it, pastaj duhet me hjek për energjinë elektrike në qoftëse nuk na vijnë edhe në kuvend. Fjalë po ja kaloj drejtorit Çelë Lamaj.

Çelë Lamaj: Faleminderit Kryesuese. Unës sot këtu do t'ju prezentoj në vija të trasha sepse e kemi edhe Sektorin e Ambientit i cili do t'ju përgjigjet edhe pyetjeve tuaja eventuale rreth menaxhimit të mbeturinave, e keni edhe pjesën e Hidro-regjionit të cilët i kena këtu prezent dhe i falënderoj shumë për bashkëpunimin. Fatkeqësisht nuk e kemi KEDS-in, i cili përkundër tentativave të mia, kontaktit me ta, mirëpo nuk kanë ofruar material as nuk kanë pasur gatishmëri së paku deri më sot që të jenë prezent edhe në seancën e ditës së enjte. Unë deshta vetëm diçka që sa i përket menaxhimit të mbeturinave shpesh po bëhen statuse nëpër facebook dhe po bahen hedhje të mbeturinave vend e pa vend në qytetin e Prizrenit tuj e ditë që ne e kena një ndërmarrje e cila është e angazhume për pastrimin e qytetit. Mirëpo hudhja e mbeturinave kishte me qenë mirë kur bëhen statuse kishte me qenë mirë që njerëzve të papërgjegjshëm të cilët bëjnë hudhjen e mbeturinave edhe dalin e bëjnë fotografi menjëherë edhe qesin statuse në Facebook, më mirë është me pasë një mesazh edukativ për qytetarët që nëse ne si komunë nuk bëjmë ndonjë shërbim ose si ndërmarrje publike nuk bënë shërbimin e duhur, atëherë adresohet së pari në DSHP, nëse ne nuk reagojmë eventualisht sepse sun i rrimë te dera aty me pa se qysh po e qet një thes mbeturina që ka ndodhur para disa ditësh në sheshin e shatërvanit që janë disa biznese që kanë gjujt, tuj e pa që ka aktivitet dhe ka punë tash, qasja është shumë problematike, shkohet edhe hudhen thasë me mbeturina bash në qendër të shatërvanit edhe bëhen postime, është për me të ardhë keq në përgjithësi për të gjithë ato që bëjnë veprime të tilla. Sot, në unazën e qytetit ku ne jena mundu edhe kena mbjellë disa drunjë dekorativ, sot lokalet përreth aty pasi që të kalon transporti, aty 5 herë mbrenda ditës qarkullohet me mbledhjen e mbeturinave dhe e dinë shumë mirë orarin. Një pjesë të mirë të fajit e mbanë edhe Drejtoria e Inspektoriatit e cila duhet të reagoj përkundër mungesës së stafit të cilën ne e dimë të gjithë që e kanë edhe dalin e gjunë mbeturia në hapësira të gjelbërta. Kjo duhet me të ardhë keq për të gjithë ata të cilët i bëjnë veprime të tilla. Ne të gjithë si qytetar duhet të reagojmë edhe të bëjmë një fushatë vetëdijësuese edhe pse këtu nuk e di çfarë vetëdijësimi duhet me pasë sepse çdonjëri se te shtëpia e vetë nuk e merrë me gjujt në bari ose në lulet e veta por në hapësirën publike e merrë sikur na jena të detyrum tashti saherë ta qet ai me nejtë gati sepse s'ka mundësi teknikisht as në Japoni e cila ka pasë një projekt me komunën e Prizrenit i cili ka pas një efekt shumë pozitiv në grumbullimin e mbeturinave t% bëhet një veprim i tillë. Kështu që, ju kisha lutur edhe juve si kuvendarë në përgjithësi që të bëni apel edhe në grupet e juaja që është shumë mië mire sepse ky qytet nuk është i Partisë Demokratike, është i gjithë qytetarëve të Prizrenit edhe ne të gjithë bashkë duhet të bëjmë që këtë qytet ta mbajmë sa më pastër sepse është për ne dhe fëmijët tanë të cilët jetojnë këtu. Për pyetje të cilat e kemi këtu sektorin e menaxhmentit e mbeturinave i cili do të jepë përgjigje, normalisht edhe të Hidroregjionit. Për KEDS-in, do të bëjë tentatia edhe gjatë ditës së sotme që së paku në seancë të na vijnë, nuk e di. Na i kemi thënë gjithmonë që ata janë një autoritet tjerë dhe nuk ki mekanizëm si me thënë me i marrë me zor edhe edhe me i pru me na ardhë. Kam kontakti jo veç me menaxhmentin e Prizrenit por edhe në Prishtinë, më kanë premtu që po, qe po mirremi, kena me dërgu një raport, mirëpo deri sot nuk kemi asnjë përgjigje pozitive. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi: atëherë me që s'kemi naj raport në kërkesën me energji elektrike, nuk po besoj ma që ndoshta do të vijmë edhe në kuvend.

Çelë Lamaj: Unë do të provoj edhe sot gjatë ditës mos po ma konfirmojnë së paku për kuvend.

Antigona Bytyqi: Atëherë me e lënë edhe energjinë elektrike.

Egzona Hoxhaj: Po leje si opion.

Çelë Lamaj: Po në fund të fundit, më fal Kryesuese por mund të diskutohet edhe aty se ajo është mediatike edhe le të diskutohet që KEDS-i është i përgjegjshëm në kërkesat e kuvendarëve të komunës së Prizrenit.

Antigona Bytyqi: Atëherë po e lëmë emërtimin e plotë të pikës.

Egzona Hoxhaj: Po, le të hjeket përgjegjësia prej neve, le të mbetet përgjegjësia tyne.

Antigona Bytyqi: Në rregull. Po ja kalojmë fjalën zyrtarëve fnga Hidro-regjioni. Urdhëroni.

Fadil Berisha: Faleminderit, së pari ju përhëndes të gjithëve dhe faleminderit për ftesë. Është kënaqësi që kam rastin të raportoj dhe të diskutoj me ju për gjendjen aktuale, por jo vetëm aktuale por të përgjithshme të situatës së furnizimit. Për informatën e juaj, unë jam Fadil Berisha, jam i angazhuar nga fillimi i vitit si Ushtrues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv për ata që nuk më njohin. Për këtë arsye unë jam absolutisht, gjithmonë nga dita e parë jam për transparencë dhe për bashkëpunim pa marrë parasysh sepse interesi qytetar, interesi publik sidomos për çështjen e furnizimit me ujë s'ka të bëjë fare me politikë, mos më keqkuptoni që po shprehem kështu drejtpërdrejtë. Unë kur e kam marrë ftesën edhe pse në fillim në mënyrë jo zyrtare po absolutisht nuk qon peshë ajo për mua.

Çelë Lamaj: Më fal kryeshef, edhe një thirrje telefonike gjatë orarit është zyrtare, s'don me thanë që gjithmonë duhet me pas e-mail, edhe një telefonatë nëse e ke marrë.

Fadil Berisha: Për mua mjafton edhe me sms unë e pranoj, nuk thash unë që, ftesat zyrtare nuk po du me hy në atë, për mua mjafton edhe me sms. Por ftesa zyrtare, unë jam mësu ja qon një ftesë zyrtare nëse ju mendoni, në rregull është edhe ajo, nuk thash në atë kuptimin sepse përndryshe s'kisha qenë këtu e me thënë s'ma ke dërgu ftesën.

Çelë Lamaj: Drejtor ju ka ardhë një e-mail në adresë të Hidro-regjionit.

Fadil Berisha: Mirë de por u dashtë, mos të humbim kohë sepse e keqkuptove menjëherë me diçka tjetër. Është me rëndësi me bisedu edhe për gjendjen aktuale. Unë, në kohë sa më të shpejtë dhe të shkurtë që e keni kërkuar ju thjeshtë me pasë një pasqyrë ndoshta në pika të shkurtëra për me ditë gjendjen ose historikun se si funksionon kompania e krejt ato, unë po flas veç për Prizren, jam fokusuar për Prizren edhe pse e dimë që është kompani regjionale. Unë në fillim të raportit e kam dorëzuar edhe një hartë të zonës së shërbimit përgjegjshmëri që kemi. Nga këto zona që i menaxhon fshatrat dhe Prizrenin kuptohet. Kërkoj falje se kanë mbetë disa gjana Dushanovë aty edhe fshat.

Bajram Kastrati: Po ja keni inati Dushanovës.

Kujtim Gashi: Edhe me ujë kokit fshat.

Fadil Berisha: Zonat që i kemi nën menaxhimin e KRU-së, janë 30 fshatra po e them veç si numnër, nga to zonat e investuara dhe jashtë menaxhimit, e kam fjalën që zyrtarisht janë të regjistrueme dhe i kam gjetë të dhënat zyrtare që janë të regjistrueme, figurojnë që janë nën menaxhimin tonë, defakto nuk janë, dejure janë, por defakto nuk janë. Janë 6 fshatra si Shpenadi, Velezhë, Smaç, Novakë, Caparc dhe Llutogllavë, se këtu ka pasur investime edhe nga donatorë edhe nga Kuvendi Komunal e tjera e tjera, unë nuk po marë përgjegjësi çka ka qenë këtu, unë flas për gjendjen aktuale, na nuk i menaxhojmë, nuk kanë ujë nga Hidroregjioni nuk i faturojmë. Zonat që janë jashtë menaxhimit të KRU-së janë hiç më pak se 30 fshatra edhe pse ligjërisht do të duhej të ishin në menaxhimin e KRU-së. Poashtu kemi edhe zona të menaxhuara edhe nga KRU Gjakova, janë në komunën e Prizrenit, s'po du me i përmend me emra krejt, dnosta i dini janë nga Lubizhda deri e Randobrava. Tek departamenti i ujit të pijes kemi 12 stacione të pompimit, kjo është shumë me rëndësi edhe për juve me e ditë që ka lidhje me, sa për informacion, ndoshta e keni ditë por i kam dorëzuar në raport krejt ku janë ato, s'po nalna ku. Që të gjitha këto stacione të pompimit rrjedhimisht po e lidhi me këtë që dashta me thënë edhe në fund këto punojnë me energji elektrike, janë me stacione pompat por edhe me energji elektrike, jo kot e thash këtë. E keni edhe hartën se ku janë stacionet e pompimit, të dhënat edhe të burimeve ujore, ne i kemi 14 burime, janë stacionet e pompimit por janë edhe 14 burime, spo i përmendi me emra, ato i keni në raport, kjo ka të bëjë se ne nuk n'varemi prej 1 burimi por edhe prej shumë burimeve tjera, domethënë prej 14 burimeve. I kemi hiç më pak se 27 rezervuare që janë , domethënë që i kemi, gjithmkonë po flas për zonën e Prizrenit ku janë të caktume. Nga këto aktivitete në kryesore unë po fokusona veç në pika të shkurta, i kemi raportet domethënë tash është raporti i tremujorit të dytë, por ligjërisht vetë raporti i tremujorit të parë është i publikuar dhe miratuar nga bordi, për shkak të mirëkuptimit të juaj nuk i kam qitë në raportin e tremujorit të dytë që është tuj u përgatit. Për gjendjen e furnizimit, flasim për gjendjen aktuale, ne këtu në Prizren i kemi pasë hiç më pak se 533 intervenime të avarive dhe defekteve të ujrave edhe këto tjerat nuk po i përmendi. Çka është më e rëndësishme, është cilësia e ujit që monitorohet, ne e kemi kompania është një prej kompanive të pakta në Kosovë që e kemi laboratorin që është i licencuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në nivel qendrorë, por paralel me këtë ne e kemi edhe një marrëveshje me Institutin Kombëtar i Shëndetit Publik që e kanë edhe degën në Prizren, ku edhe ata i bëjnë analizat paralele sepse për neve cilësia e ujit është prioriteti numër një edhe normal i kemi dhënë rëndësi të veçantë. Nga këto rezultojnë po flas në Prizren tek ujësjellësi të gjitha analizat jo vetëm për këtë tremujor por edhe sot të fundit që e kam marrë, se ne i bëjmë edhe në burim edhe në ujësjellës është me rëndësi qytetari qysh e merrë, asnjë dështim të analizave nuk e kemi pasë se janë të dokumentum, të arkivum nga personi përgjegjës, domethënë nuk kemi pasur asnjë problem te kualiteti. Tek situata e furnizimit e përmendi në fund, unë veç po e përmendi te departamenti komercial në Prizren vetëm në tremujorin e parë janë çkyq 246 lidhje ilegale, janë indentifiku dhe çkyq nga rrjeti, ndërsa deri sot po flas ndoshta është me rëndësi po flas për këtë vit që mbi 450 lidhje ilegale janë indentifiku dhe janë çkyq nga rrjeti. Po ju them mua më intereson për çështjen prej momentit që jamë unë këtu, por në bazë të raporteve që i kemi parë edhe më herët edhe tash kur të raportohet janë transparente edhe kur raportohet tash krahasimi, unë jam ithtar i krahasimeve se si ka qenë edhe ku jemi sepse problemet me një sustë nuk munden me u zgjidhë. Tri vitet e fundit me i bë bashkë nuk ka pasur aktivitete në identifikimin e lidhjeve ilegale ma shumë se që ka pasur në qet periudhën gjashtë mujore, janë dokumente të publikuara në ueb-faqe. Këtë e thash unë me qëllim, s'po i them unë këto tjerat sepse qëllimi kryesor i kontrollimit të lidhjeve ilegale është ruajtja e

stabilitetit të furnizimit me ujë të pijes. Nga aspekti nuk po e përmendi atë financiar sepse për mua është normale që duhet me pasë mjete me investu, por me rëndësi për mua, misioni kryesor është kualiteti i ujit të pijes dhe situata e furnizimit dhe transparencja. Në bazë të që i kemi, unë po flas për periudhën të cilën jam këtu, unë i kam kushtuar një rëndësi tepër të veçantë transparencës dhe nga të dhënat që i kam marrë dhe më kanë raportuar, më rezultoi që në Prizren në raportin 3 mujor i kemi humbjet 73.8%, nga këto të nderuar pjesëmarrës nga 26.2% të ujit nën kontroll që e kam pasur në kemi arritur që në 3 mujorin e parë me pasur një qëndrueshmëri të furnizimit pa asnjë problem as në qytet as në lagje. Kur kam ardhë unë në fillim ka pasur reduktime, s'po flas kur janë rritur temperaturat, në nëntor kemi pasur reduktime në Bazhdarhanë në Tusuz, në Arbanë në Landovicë, në Zhur dhe shkozë. Unë po flas dhe po më intereson me thënë që këto aktivitete kanë ndikuar që kemi pasur qëndrueshmëri furnizimit. Gjendja aktuale tash është një problem kryesor që e kemi evidentuar që nga fillimi ka qenë përveç keqpërdorimeve, lidhjeve ilegale që i përmenda që janë shifra të evidentuara dhe kallxime penale ka për herë të parë. Kanë qenë, jo kot i përmenda ato stacione të pompave, ka qenë ndërprerja e energjisë elektrike nga KEDS-i, çdo ndërprerje që e kanë pasë e kanë çrregullu, jam mundu me qenë transparent me i publiku çdo ndërprerje, fatkeqësisht kemi pasur raste kur ka pasur ndërprerje edhe të pa, fare s'kemi qenë të informuar. Kam reaguar, kam bërë reagime zyrtare, kam takime me KEDS-in që këto mu ndërpre. Hapi i parë unë që kam ndërmarrë që të 40 burimet sado që udashtë procedurat me i ndjekë, mi bërë presion të jashtëzakonshëm, të gjitha ato planifikime e tjera që s'kanë qenë fare të planifikuara, të 40 burimet për herë të parë Prizreni ka një gjenerator që kur nalet rryma aktivizohet automatikisht, që s'ka pasur kurrë. Paralel me këtë është konstatuar gjendja që edhe në stacionet tjera kryesore sidomos në Sozi ku janë 12 fshatra që atakohen, këto zonat prej Nashecit edhe zonat e Hasit si Kojush i dini ato mos t'ju marrë kohë që ka pasur ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike dhe aty i kemi marrë të gjitha procedurat edhe pse s'ka qenë aspak e lehtë sepse s'ka qenë as në plan biznes as e planifikime. Por u dashtë me marrë një miratim të jashtëzakonshëm edhe të bordit komplet edhe pritët, është e publiku do të vendoset, instalohet një gjenerator me kapacitet edhe më të madh se të 40 burimet sepse ashtu qenka nevoja edhe kjo në ditët e ardhshme pritët me u vendos edhe me u zgjedh, mu siguro që kur të nalet rryma sikur të 40 burimet automatikisht vihet në funksion edhe banorët nuk e vërejtë këtë. Një problem tjetër gjatë kësaj periudhe ka pasur avari apo defekte të shumta që unë i kam të evidentuara me datë krejt edhe nga shërbimi teknik, kam kërkuar që me pasur një raport të veçantë që nga operatorët ekonomik, unë i kuptoj që gjatë punimeve kryhen defekte, por ka pasur me të vërtetë defekte të mëdha që faktikisht shumë lehtë unë kam mujt me thënë ok dhe me ja dërgu inspektoriatin e komunës që unë shpesh edhe i kam thirrë, kanë ardhë dhe unë i falënderoj me ba proces edhe në punën tonë që me thënë nuk e kam unë obligim, e ka dëmtu operatori ekonomik, ose nga komuna ose nga qeveria në projekte të ndryshme. Por, unë jemi angazhu maksimalisht në interes të qytetarëve që mi rregullu na, më vonë çka shohim ja dërgojmë kallxim penal atij të përmbartësi për të gjitha defektet, avaritë që janë shkakto nga operatorët ekonomik kompania i ka rregulluar në interes të qytetarëve që ka pasur mundësi. Në ditët e fundit ose mos të them tash që 2 javët e fundit me ngritjen e normave të temperaturave edhe pse kemi arritur me pasë në kontroll këtë situatë pa marrë parasysh ato që i përmenda, është rritë konsumi në mënyrë enorme, kur them enorme nuk mundeni me marrë me mend të paparashikueshme. Unë e kam ba evidencë s'ka pasur përpara në fshatra sa po qojmë ujë sidomos në zonat rurale kryesisht, nuk menjanohen edhe zonat periferike në qytet këtu kah kurrila kjo lagja Dardania, por sidomos në zonat rurale mbi 95% d.m.th. ka pasur humbje të ujit, ju e dini më mirë se unë se çka do të thotë 95%, ka pasur ose rrjedhje ose keqpërdorime ose në forma të ndryshme, vetëm 5% i kemi pasur në kontroll. Por gjithsesi unë them qytetarit nuk i intereson, qytetari don ujë edhe na jemi përgjegjës për atë. Për këtë arsye unë kam angazhuar edhe pse dikush nga aspekti juridik i dini, unë kam angazhu me stafin, me ekipën që e kam pasur në dispozicion që për mua

nuk mjafton në këtë situatë, sidomos te operativa edhe inspektoriati, që jemi angazhuar edhe me punë shtesë, me punu edhe vikendit që i kam kalu në aspektin ligjor orët jashtë orarit, 40 orë është së paku sa më kanë thënë që nuk guxon me i tejkalu 40 orë jashtë orarit sepse i ke shkel ligjet. Thash unë do ta marr qat përgjegjësi nëse e kam shkel qat ligj sepse më intereson interesi publik që qytetarët me pas ujë. Gjithsesi në këtë kohë, kush është ma gjatë këtu se unë s'kam qenë kryeshef edhe pse kam qenë në punë edhe më herët në kompani, gjithmonë në këto temperatura ka pasur edhe rënie të burimeve, lehtë mujm me thanë kanë ra burimet kemi reduktime. Ne fatmirësisht të nderum gjendja e burimeve është shumë stabile, janë të gjitha kapacitetet maksimale, opmpat gjeneratori sidomos te 40 burimet. Mua më raportojnë në baza ditore, çdo ditë kërkoj raport sepse mundet edhe me pas sikurse ka pasur më herët rënie të burimeve, nuk është që s'ka edhe ramje por është stabile dhe me kapacitet të plotë komplet tuj funksionu. Por, siç e potencova kemi një rritje enorme të konsumit fatkeqësisht edhe të keqpërdorimeve, paralel me këtë për shkak të rritjes së konsumit shkon edhe rritje e avarive ose prishjeve. Përderisa në ditët më herët kur s'ka pasur rritje të temperaturave, brenda ditës kemi pasur 4 ose 5 avari përveç atyre të pa planifikuara nga operatorët që i përmenda. Sot në baza ditore i kemi kah 15 dhe 20 defekte që duhet mu rregullu. Unë, me kapacitete tona që i kemi kam kërkuar, thjeshtë nuk është gjendja e jashtëzakonshme por është gjendje serioze, unë kam kerkuar të bëjmë takime të rregullta ditore, jo 1 herë në muaj qysh kam ba me menaxhmentin, por për shkak të situatës edhe kam kërku që me kërku shtesë jo vetëm jashtë orarit por me kërku që avaritë që ndodhin me kërku edhe nga operatorët privat me pagu që mu rregullu defektet sa më shpejtë. Inspektoriati mu shtu që me punu edhe të shtunave edhe të dielave, i kam mbështet në kuptimin që mu pagu edhe jashtë orarit, sepse fatkeqësisht unë edhe vetë kam qenë dëshmitar, nuk rri shumë në zyre që mundet me thënë dikush rrin në zyre, unë apsolutisht shumë kam dëshirë me bisedu me qytetar, me pa edhe me punëtorë por edhe me qytetarë bashkërisht me qenë transparent me pa nuk është puna me lëshu ose me nal ujin edhe fatkeqësisht të shtunën kam qenë nga ora 7 kemi pasur probleme teknike në Shkozë edhe Zhur dhe fatmirësisht janë zgjidhë. Mbi 20 raste unë i kam vërejtë vetë, jo inspektoriati kolegët e mi që i bëjnë, unë i kam vërejtë vetë si qytetarë unë kam dalë civil me veshje sportive me makinë temen edhe në këmbë, mbi 20 raste me tuba-zorrë te ujit tuj ujit edhe fatkeqësisht jashtë orës. Kjo me të vërtetë, nuk është arsyetim por me të vërtetë është tepër serioze sepse unë i thash dikujt edhe drinin e bardhë me ngritë, duhet me u ngritë një vetëdije qytetare. Unë ju tham aktivitetet i kemi qitë në faqen tonë aty në Facebook dhe të internetit, por nuk mjafton me këtë me ngritë vetëdijen sepse kjo gjendje është, sepse dy ditë që ka ra shi, ne me 26% të ujit që e kemi në dispozicion 24 orë po ka ujë dhe po ka kapërderdhje në rezervuarët. E vetmja mundësi është masat ndëshkuese te keqpërdoruesit, përpos masave ndëshkuese unë po them kam angazhuar maksimalisht që tërë ekipet e inspektoriatit por edhe shërbimet e tjera këto që janë lexues me mbështet, me punu edhe ata në identifikimin e lidhjeve ilegale edhe keqpërdoruesve. Kjo është gjendja momentale, problemet deri sot po flasim i kemi sidomos në lagjen Arbana, por jo në të gjithë lagjen Arbana sepse dje koleg të nderum në lagjen Arbana u identifiku me një lagje 63 gypi në ora 7 ma ka dërgu kontrolla aty, edhe ka pasur ujë në lagjen Arbana, s'po flas si shkas, ajo lidhje ilegale që ish kanë 63 kur e ka lëshu ujin, ujë kish pasur mirëpo disa pjesë po por disa pjesë në lagjen Abrana. E kemi pa mundësinë që ato pjesë për mua të gjithë janë qytetarë të njëjtë, nuk ka zona të caktume të privilegjum, që me pa mundësinë në lagjen Arbana me bë reduktime qajo pjesë kah varrezat që me pas ujë, jo dikush me pas ujë e dikush mos me pasë ujë. Një tjetër është këtu te lagjia Jeta e Re, unë po them prej Nashecit e këto sado që janë duke punuar pompat 24 orë, kam angazhuar ekip-staf që mu nal rryma me qenë, mu aktivizu edhe pse gjeneratori s'ka ardhë por me kontrollu, por fatkeqësisht po them edhe këto fshatrat që i kemi mbi 90% janë keqpërdorime edhe 24 orë ju kam thënë me shku me inspektu fshatit Atmaxhë, Tupec, Landovicë që spo vjen tash hiç edhe pse jam unë i Landovicës sepse ndalet uji edhe me pas një, nëse ka nevojë me bë një reduktim për këto

fshatra që me ditë që me të vërtetë ata me pasë ujë. Në Prizren ende vazhdon të jetë situata nën kontrollë edhe pse në Bazhdarhane, një pjesë e Bazhdarhanes sot në mëngjes ka fillu edhe aty me ra shtypja. Kjo është gjendja aktuale edhe unë po e shfrytëzoj rastin, pa marrë parasysh sepse në rend të parë jemi qytetar edhe konsumatorë të gjithë, që në këtë situatë edhe Kompaninë Rajonale të Ujësjetës sepse ma herët ka pasur kësi iniciativa ku ka pasur përpara reduktime të zakonshme që i quaj unë, që me ba një marrëveshje thjeshtë, unë e di që edhe ju s'keni kapacitet inspektimin me inspektorë, unë i kam kërku me pasë një takim me Drejtorin e Inspektoriatit, më thanë që është në pushim vjetor. Arsyeja pse ka qenë tash po e shfrytëzoj tash këtu pse mu taku me të që thjeshtë me dal në inspektim edhe me inspektorët e komunës edhe me ne bashkërisht që këto keqpërdorime me u ndal, thjeshtë derisa të kalon qekjo, këto ditë vapa e jashtëzakonshme dhe keqpërdorim i jashtëzakonshëm i ujit të pijes.

Antigona Bytyqi: A i lëmë këto më gjërësisht në kuvend që edhe ju mos të mundoheni sepse kanë me u përsëritë gjërat. Ti marrim pyetjet këtu të anëtarëve.

Fadil Berisha: Unë e përfundova, faleminderit edhe ju kërkoj falje nëse ja u shfrytëzova minutazhën pak më tepër.

Antigona Bytyqi: Jo apsolut. Të shohim a kemi pyetje meqë lagjia Arbanë ka. Po urdhëro Bajram.

Bajram Kastrati: Faleminderit Kryesuese, faleminderit Kryeshef, të përgësoj për punën për angazhimin. Meqë ndërhyri edhe Kryesuesja edhe na kemi me diskutu, ftesën sigurisht e ki edhe për pasnesër në seancë, do të diskutojmë edhe më gjërësisht. Unë veç nja 5 pika, se unë prej takimit, isha në Hidroregjion me zyrtarët e juaj për çështjen e Arbanës edhe pak a shumë i informova në këtë formë qysh raportove ti. Unë veç po i cekim si shpejtë e shpejtë disa që sigurisht kemi me i diskutu edhe në seancë. Unë dola jashtë njëherë edhe ka mundësi e ke përsërit por se kam ndëgju. A je i informuar që ka gypa të “azbestit” shumë në qytet edhe a i konsideroni që janë të rrezikshëm për furnizim me ujë? Edhe pse dikush një ditë më tha që jemi furnizu qe sa vite me qeta gypa edhe kurgjo s'na ka gjetë! një. Shtypja e ujit në vazhdimësi, nuk është veç tash, në lagjen Arbanë e kemi, po ndërlihdna në Arbanë përderisa jetoj edhe vetë e kemi 90% mos me thënë 100% furnizimin me ujë me motorr për shtypje të ujit, secila shtëpi e ka motorrin për shtypjen e ujit përderisa nuk furnizohet mjaftueshëm me ujë. Unë jam ithtar i kësaj me i hjek këta motorrë, me pa një formë qysh me i hjek se tash dikush kur ka rrymë e ajo pjesa që s'ka rrymë ky po ja merr ujin krejt, edhe kjo lagjia nalt që vjen, edhe ajo e ka qet problem sepse pjesa tjetër po e merr me motorr e te ata nuk po shkon uji fare se ju veç e kishit ngushtu, e kishit ndërpre pak këtë shtypjes kryesore, ama këtë problemin e shtypjes së ujit ne e kemi në vazhdimësi, jo veç tash, tash është ma ekstrem, qajo pjesë diku rreth 200-300 shtëpi s'kanë ujë fare që qe 4-5 ditë sepse një banorë më tha që ka prit mbrëmë tan natë e uji s'ka ardhë as 1 orë as fare hiç. Do të thotë për qet ndërprerjen është mirë me marrë masa, më premtuan edhe ata zyrtarët që kanë me marrë.

Fadil Berisha: Nëse është si pyetje unë muj me tu përgjigj shkurtë, nëse don me vazhdu unë muj me të ndëgju, por nëse don si pyetje unë ta jap përgjigjen menjëherë. Mirë është me i ndërru krejt gypat e “ azbestit” që është bë një punë e madhe në Prizren me investime edhe Hidroregjioni Jugor edhe Komuna edhe qerisë ka pasur edhe donatorë, por unë po të garantoj nuk është problemi i gypave të “azbestit”, nuk po flas këtu për publik as për kurgjo, m po ju them me kompetencë shumë zyrtare, nuk është problemi i “azbestit” ai që po zmadhohet, problemet janë rrjedhjet nëntokësore që po ndodhin.

Bajram Kastrati: Ajo është temë tjetër, veç veta që a është e rrezikshme?

Fadil Berisha: Paraqet rrezik kur prehet “azbesti”, ai pluhuri rrezik për punëtorët paraqet por jo për qytetarët.

Bajram Kastrati: do të thotë nuk paraqet problem? Je i pari që po ndëgjoj!

Fadil Berisha: Jo i pari, por merre unë ta jap.

Bajram Kastrati: Tash te kontrolla e lidhjeve ilegale, ju e keni një ekipë bajagi të madhe që i kontrolloni qeto. Mua sot ma kërkuan aty edhe komuna edhe tash ti kërkove që komuna mu angazhu në kontrolla.

Fadil Berisha: Me mbështetë.

Bajram Kastrati: Sigurisht që mbështetjen e keni. Por kjo kontrolla, a s’po mundet me menaxhu kontrolla qeto?

Fadil Berisha: Unë nuk po du me ju marrë ma shumë kohë. Ne kemi 61 mijë konsumatorë, shumica e konsumatorëve sidomos këta keqpërdorues i kanë ujëmatësi brenda zonës shtëpiake, unë për me ardh me të kontrollu, mos më keqkupto me marrë personale po e marrë si shembull, duhet 24 orë me të kontrollu çka po keqpërdor ti. Unë kam shkue në Nashec 7 lidhje ilegale i kemi gjetë masdite, mas orës 8, nuk është veç ajo anë, në tana anët ki. Edhe tash qet ekipin që unë po mudona sa më transparent me angazhu edhe jashtë orarit komplet, nuk mjafton jo qeta por edhe 5 fish me i bë qysh po mendon ti 24 orë unë nuk muj. Më fal që po shprehna kështu, babgjyshi jem thojke tuta e ruan bostanin. Unë po ju bëj kallxime penale, unë po shkoj edhe me ta, për atë kam me mbështet atë punë bile së paku mu ba mediatike që përveç lidhjeve ilegale që po i identifikojmë, ti përmenda me shifra që s’ka pasë, kqyre raportin kurr s’ka pasë më shumë edhe kam kallxime penale, kallëximet penale i nënshkruaj unë personalisht edhe nuk ka asnjë tolerim. Le që përpara e ke njoftë Kryeshëfin, e ke njoftë menaxherin, e ke pas drejtorin teknik Besarin i ke thënë hiqma kallximin penal. Te unë s’ka, nëse ma gjeni një rast që unë kam toleru, sepse e kam interesin qytetarë me pasë ujë edhe unë mendoj që zgjidhja është e ndëshkimeve, ndëshkimet përveç kallëzimeve penale, është kodi penal se s’jam unë jurist, e parasheh 3 vjet burg mbi keqpërdoruesit. Të nderum, asnjë nuk u denu në Kosovë, jo veç në Prizren, mjafton 1 le ta dënojnë, unë po them jo 3 vjet por 1 muaj le ta dënon. Unë asnjë tolerim nuk po e bëj, unë po kërkoj me shku me të vërtetë sepse këto keqpërdorime duhet me u ndalë sepse ka me 26%, unë humbjet po mundohem maksimalisht me i zvogëlu, thash unë çdo ditë kam shku edhe lagjen Arbana e di, lagjja kah varrezat kurrë s’ka pasur ujë shtypje, mundesh me thanë gjithçka por kurr s’ka pasur shtypje. Mua sivjet më kanë pyet se i kam shok krejt, Fadil çka ke ba që për herë të parë kam ujë atje te varrezat? Kurgjo s’kam bë, vetëm këto lidhjet ilegale po i zvogëloj, po i qoj kallëximet penale, kjo është.

Bajram Kastrati: Te obligimi i projekteve, ndërtimi furnizimit me ujë. Tash kur e kërkoj unë një projekt të caktum, ose e kërkojë qytetarët ose e kërkon vevoja, qeto projekte shpesh herë din Hidroregjioni me thënë komuna duhet me investu ose e kundërta. Kah duhet me u orientu na për ndërtimin e ktyne?

Fadil Berisha: çdo projekt, unë domethënë e kam dërgu e keni në fund të raportit, nuk po du me ju marrë kohë. Çdo projekt na përpara edhe kompania e Hidro-regjionit Jugor, qat tarifë që e ka për për volumetrie 1000 litra 38 cent, unë krejt investimet, unë nuk jap llogari çka ka qenë përpara, unë këtë muaj nga aspekti juridik e dini që kam të drejtë me bë revidimin e planit të biznesit, të gjitha projektet që kanë të bëjnë me uljen e humbjes së ujit, me përmirësimin e furnizimit, unë ju kam thënë duhet me pasë prioritet, që e kam prioritet më falni që po shprehna që 2 muaj kam mbetë pa makinë s'është me rëndësi, me makinë teme private jam, u dashtë me ble një makinë të re, por unë po them me prioritet këto janë lista edhe kemi bashkëpunim edhe me komunën edhe me, mirëpo projektet me pas prioritet që ka humbje të ujit edhe aty ku ka problem. Këtë muaj, në qet kohë kur po flasim me mjete vetanake Hidro-regjioni jugor, janë tri rrugë në Arbanë tuj u ndërru, hyn kqyre tabelën.

Bajram Kastrati: E di ku janë tuj u ndërru, por a ka me pasë nevojë, ka me pasë.

Fadil Berisha: Apsolutisht ka nevojë sepse po ju them, mos të bana i tepërt, çdo lidhje kur po e gjejmë, me të vërtetë unë kam mendu me i publiku me emra s'po du me thanë qysh ka me shku. Çdo rrugë që po e qelin kanë shpia kah 2 a tri lidhje ilegale mbrena që i kanë, tash nuk mujmë na.

Antigona Bytyqi: Ta ndëgjojme Florentin edhe Naxhijën mandej.

Florent Ukaj: Faleminderit Kryeshef për kë prezantim që na bëtë, tash politikisht po flas, shpresoj që qeveria e Karanfililit ta vazhdoj edhe një mandat sipas këtij raporti që na tregove sot, shpresojmë ta vazhdojë paske me i shpëtu këto fshatrat tjerë sepse ne jemi të lidhur me Radoniqin, paske me na shpëtu se s'ka me pasë nevojë ma për ankesa e për. Unë veç një sen po du shumë, unë çdo seancë qetu ndëgjoj prej bashkëpartiakëve tonë sidomos prej Petritit edhe prej Shukri Qunit, çdo ditë ndëgjoj ankesa që 5-6 fshatra anej nuk kanë furnizim me ujë, ndërsa ti këtu në raport po na tregon se qysh është e furnizume, qysh nuk ki problem! Shkurt e ship po du me e ditë, a ka ujë në Prizren a nuk ka ujë në Prizren?

Fadil Berisha: E dhashë unë po e quaj rezyme të shkurtër se nuk i përmenda kot, nuk i kam dërgu kot kush don me e kuptu.

Florent Ukaj: Për neve ma pak që po kuptojna.

Fadil Berisha: Jo po them kush don, nuk është që s'din me kuptu, e kupton më mirë se unë. Na n'varemi prej stacionit të pompave, jo kot unë i përmenda to pompa, na n'varemi prej rrymës. Nuk është çështje që s'ka ujë kur nalet rryma.

Florent Ukaj: Po a tha kam ble agregat?

Fadil Berisha: është te 40 burimet, unë sa stacione të pompave ti përmenda.

Florent Ukaj: Ndoshta s'jeni për tjerat.

Fadil Berisha: Edhe ato tjerat jemi apsolutisht.

Egzona Hoxhaj: Mandatin tjetër.

Fadin Berisha: Jo mandatin tjetër, ditët e ardhshme, e keni në raport në Sozi 50 mijë euro ka mu vendos gjenerator ditët e ardhshme, e kam shti në procedurë. Por, gjendja unë nuk thash që është e mirë edhe s'kemi probleme, unë vetëm ju tregova që jemi tuj punu maksimalisht me qeto kapacitete që i kemi, na duhet me dhanë kontributin të gjithë bashkë që nuk është çshtja ma veç mu vetëdijësu por për shembull, po flas me kompetencë se ka problemn në krejt Kosovës, por Prizreni ka ujë edhe për 1 Prizren i nderum. A mundet me sustë jo kryeshefi, jo Fadili, por 100 Fadila tjerë me sustë po them, unë i kam identifiku, në bazë të përvojës teme unë e di qysh zgjidhet ky problem, vetëm me i idenfitiku mos me i toleru keqpërdoruesit dhe paralel me investu në projekte që ka të bëjë me humbje të ujit edhe çdo projekt, çdo rrugicë që vendoset, ndërrohet gypi. Është konstatu fatkeqësisht po them që janë dy faktorë kryesorë që në fillim duhet me zgjedhë, një ndëshkimet mos me toleru për keqpërdorues edhe e dyta me funksionu edhe prokuroria, kodi penal e paraqet shumë qartë, 3 vjet shkruan burg për keqpërdoruesit, duhet me denu dikan.

Florent Ukaj: Te humbjet drejtor, ne në fillim të mandatit të kryetarit Totaj, na u ka bë një raport prej dikujt tjetër, s'ke qenë ti edhe aty na u ka paraqitë që 70% ka pasur humbje, tash ti po na thu 73%, nuk tu paskan zvogëlu humbjet por tu paskan rritë sipas të dhënave që i keni dhënë ju në raport.

Fadil Berisha; Jo jo, të dhënat që i jap unë, çka kanë dhënë përpara unë i kam pasur të vitit të kaluar 55% ti i nderum.

Florent Ukaj: Tash mas teje munder me ardhë me thënë, ama po bini në kundërshtim shumë.

Fadin Berisha: Unë jam transparent edhe po tregoj me fakte, këto që po ti jap unë ty çdo gjë është e dokumentume dhe ti dokumentoj, nuk është puna as çshtje politike as me zbukuru situatën. Unë po them qekjo është situata dhe qeto janë aktivitetet që jemi tuj i ndërmarrë.

Antigona Bytyqi: A ke Florent diçka tjetër?

Florent Ukaj: Jo u kry, pastaj edhe në seancë.

Antigona Bytyqi: Naxhija pastaj edhe Bajrami.

Naxhije Memaj: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. unë thajse çdo seancë kam kërkuar që të rregullohet defekti në ujësjellësin e fshatit Llutogllavë. Drejtori thotë vazhdimisht drejtohuni tek Hidroregjioni, por në këtë rast po e hiqni kompetencën e juaj, po thoni nuk kemi kompetencë në fshatin Caparc, Llutogllavë dhe Malësi e Re, nuk është në menaxhimin e juaj. Atëherë kujna duhet na me ju drejtu që për një defekt të vogël fshati Llutogllavë nuk ka ujë me vite! Kjo 1 apo 2 orë është tepër mos me pas ujë, paramendo ma shumë. Kujna duhet na me ju drejtu?

Fadin Berisha: Ju duhet me ju drejtu Hidroregjionit Jugor, shumë në rregull është kujt me ju drejtu. Por unë kur flas nuk e zbukuroj situatën, por për me zgjedh një problem duhet me qenë transparent, me qitë problemin mbi tavolinë edhe mi shku nga aspektet ligjore dhe përgjegjësiive, përgjegjësinë e ka Hidroregjioni jugor. Fshati Llutogllavë në bazë të informatave të mia nuk është në menaxhimin tonë sepse, ka pasur investime marramendëse aty nga donatorët, nga komuna, por unë nuk e kam nën menaxhim, unë nuk faturoj, përderisa unë të faturoj dhe ti e paguan qat obligim, unë e mbaj përgjegjësinë. Për atë i përmenda, i kam me emra krejt se i kam marrë informatat. Unë nuk muj me marrë përgjegjësinë se çka ka ndodhë s'po muj me marrë përgjegjësinë, por çka mujmë

me ba. Për këtë arsye zgjidhja është që fshati Llutogllavë me hy nën menaxhimin e KRU Hidroregjionit Jugor, me shiku a duhet me investu, ato investime që kanë qenë fatkeqësisht po them dështun. Kolegën e mi në zyrën për planifikim e kanë ba me zgjidh problemin jo veç me fjalë, është projekti i gatshëm, tash duhet me kqyr për me financu edhe mu kry komplet rrjeti me hy nën menaxhim, me i vendos ujmatat jashtë edhe me i faturu. Tash jo me ardhë banori i Llutogllavës, edhe Korisha duhet me hy nën menaxhim, nuk ka ma privat këtu e jo kur të dodhë problem atëherë. Edhe mu faturu, jo z'du mu faturu, e njëjta ka ndodhë edhe investimet e pa planifikuara edhe nuk kanë përfundu, paret janë dhënë.

Naxhije Memaj: Faturat vijnë, vazhdimisht vijnë aty.

Fadil Berisha: Po unë i kam me emra, qetu e kam raportin se s'po du me hy në detaje.

Naxhije Memaj: Problemi nuk është aty, problemi është që ujë nuk ka fshati.

Fadil Berisha: Ujë fshati, ti po thu vjen fatura, a e din ti që prejse e kanë regjistru, unë po flas gjendjen qysh e kam këtu, 163 euro qe 5 vjet janë inkasu prej Llutogllavës, ti po më thu është tuj u faturu. Atëherë

Naxhije Memaj: Faturat po vijnë, ato pse si paguajnë është tjetër.

Fadil Berisha: Jo jo, unë kam lyp raport zyrtar, nëse më kanë rrejt ata, unë po të them e kam raportin zyrtar dhe ta dërgoj privat ty që në llutogllavë nuk është tuj u faturu, ti po thu po. Malësi e Re po.

Naxhije Memaj: Ato kanë ujë.

Fadil Berisha: Ato po, kanë ujë se po faturohen, po e pagujnë, po faturohen.

Naxhije Memaj: Faturat po vijnë e ato pse se pagujnë është diçka tjetër.

Fadil Berisha: Jo jo, nuk është tuj ardhë fatura fare zonjë, nuk është tuj ardh fare fatura.

Naxhije Memaj: Deri vonë kanë ardhë.

Fadil Berisha: Epo a po e sheh tash, të lutem. Unë po flas për vete, unë po flas për gjendjen teme, çka ka ndodhë. Më fal që po të them tash një kojshi i jemi shkova mysafir, tha s'kam pas ujë as me marrë abdes, i thash më fal ku banon? Në qet rrugë tha, mirë i thash ose unë jam tuj të rrejt ose ti, pa teklif se e njifsha. Burrit plak, ilakës tem i thash ose ti je tuj rrejt ose unë, atëherë tha jo përpara s'kemi pasë. Unë nuk marrë përgjegjësi çka ka qenë përpara, unë po flas gjendja qysh është sot edhe çka muj pastaj përgjegjësia është e jona.

Naxhije Memaj: Gjendja është katastrofë sot.

Fadil Berisha: Gjendja është katastrofë sepse nuk faturohet fare prej Hidroregjionit Jugor.

Bajram Kastrati: Veç një sen po ta them që me rrejt ne nuk rrejnë.

Fadil Berisha: Jo bre kërkush nuk po thotë.

Egzona Hoxhaj: Unë e kam veç një kërkesë shumë të shkurtë. Në seancën e kalume na me lan Shuk e ngritëm këtë çështje për shkak që regjioni i Hasit, konkretisht Nasheci, Tupeci, Gjonaj, Kojushi, Planej, gorozhupi edhe Mazzreku, s'kena pas 5 ditë ujë edhe gjithmonë regjioni i Hasit po neglizhohet te kjo pjesa e informacionit. Kur të keni punime në rrjet ose diçka, a mundeni me na njoftu paraprakisht, me na përgatit, me na njoftu për shkak që.

Kujtim Gashi: Që mu la para vaktit.

Egzona Hoxhaj: Nuk është mu la para vaktit, por na regjioni i Hasit jemi mësu me i mbush ato bogamet e sene sepse deri para 3-4 viteve qashtu kena jetu. Kështu që jena të përgaditun e së paku me na njoftu çka po punohet.

Fadil Berisha: Nuk keni nevojë as me marrë bure, as me marrë bidona as kurgjo sepse regjioni i Hasit 24 orë ka ujë kur s'ka ndërprerje të energjisë elektrike.

Egzona Hoxhaj: Tash pra një agregat na bini qaty kur të na nalet uji.

Fadil Berisha: Gjeneratori zyrtarisht tash është çështje ditësh kur ka mu sjellë. Paralel me këtë jena tuj punu që me këqyr edhe me bë investime në humbje të ujit, edhe me qeto humbje ku knej në Nashec edhe në Kojush 1 dhe Kojush 2, me 26% që e kemi ujin nën kontroll, ju keni 24 orë ujë, pa ndërprerë edhe kjo është gjendja aktuale, nuk ke nevojë as me bajt unë as kurgjo. Unë po flas me fakte, por kur po nalet rryma, unë nuk po pritoj me ju njoftu, por KEDS-i nuk po më njoftoj që kam me ta ndal nesër kam me ta ndal rrymën ai po e ndal të pa planifikum. Unë e kam instaluar edhe gjendjen e thirrjeve edhe nëpërmjet Facebook edhe krejt, edhe unë ju them me i informu konsumatorët për çdo ndërprerje. Unë tash nuk muj se nuk mund të them që e kemi krejt situatën në kontrollë, te qendra e thirrje ka hapësirë gjithmonë me e përmirësu, sepse e kam vëejtë sepse nganjëherë arsyetime po gjejnë gjithmonë. Kam angazhuar staf shtesë që qendra e thirrjeve me funksionu në atë kuptimin sikur në perëndim 24 orë, nuk ka qenë në plan biznes, e kam fut tash me qenë edhe në plan biznes, ka me pas kosto shtesë, normal por unë jam për me i informu qytetarët, nëse ka njoftim të KEDS-it, hyn në ueb-faqen e kompanisë krejt njoftimet i keni zonjë.

Antigona Bytyqi: Ju faleminderit. Tjera pyetje a keni?

Levent Bush: Unë shkurt e kam një pyetje. A jeni i kënaqur me Komunën e Prizrenit në bashkëpunim, shkurt po ose jo?

Fadil Berisha: Unë s'jam i kënaqur as me vetveten kurrë.

Levent Bush: Unë shkurt të pyeta po ose jo? Për politike të bëj pyetje tjetër.

Fadil Berisha: E di që ka pasur edhe më herët bashkëpunim, por unë flas prej ditës së parë që kam ardhë unë jam shumë ithtar i bashkëpunimit me kuvendin komunal të Prizrenit, jo vetëm Prizrenit por edhe Suharekën, Malishevën. Pardje kam pasur takim me kryetarin e Malishevës, ata prej sodit fillojnë inspektimet e përbashkëta, kjo është formë e bashkëpunimit. Edhe investimet, me qenë investimet e përbashkëta mu akordu, se s'qenka Çela këtu, unë i kam thënë çdo investim mu akordu

bashkërisht që qytetarët me pas ujë. Deri më tani unë s'kam kurrfarë vërejtje, unë e kam par se pasojë e moskoordinimit janë do pasoja sot. Por unë jam ithtar që me rritë, me forcu këtë bashkëpunim edhe e shoh një gadishmëri pozitive, spo du me hy tash p.sh. qka ka qenë një problem.

Kujtim Gashi: Te monumenti apo?

Fadil Berisha: Te monumenti p.sh. falë një bashkëpunimi shumë të shpejtë me të gjitha institucionet edhe qendrore edhe lokale kemi arritë, kjo është shenjë që kur të dojmë me bashkëpunu mirë mujna mi zgjidhë problemet më shpejtë.

Antigona Bytyqi: A keni diçka tjetër.

Dafina Alishani: Te pjesa e menaxhimit të mbeturinave dhe energjisë elektrike. Drejtori shkoj, unë po du me repliku edhe me e shprehë shqetësimin tim. Tash unë e di që është një orar edhe e di që është një rregullore. Pjesa e menxhimit të mbeturinave nuk i ka hije as qendrës ashtu me u dok, as lagjet që nuk po mirren me ditë të tëra, e keni mbara këtu, unë banoj aty dhe unë vetë personalisht kam reaguar. Unë e mbaj mend qekjo parti kur ka qenë Ek-regjioni i bllokum në OSHP, su nal me reagime. Tash po i mbetet hatri që asambleistët ose qytetarët po reagojnë e ky e bile bile s'paskëm na punë tjetër e po shkojmë po hudhim mbeturina e po bëjmë foto, kjo është e palogjikshme! Nuk jena na shizofrena ne me shku qaq ult edhe me i bë këto akte. Ata që i hudhin bërllokin vend e pa vend, pa orare, ju e keni një rregullore vazhdoni edhe i denoni ata, vetëdijësimi bëhet vetëm me dënime. Asnjë asambleist nuk e ka obligim, e ka ndoshta bashkëpunimin me ju informu por nuk muj unë me ba punën e inspektorave. Evidente është që bërlloku nuk po mirret, evidente është që në këtë të nxehtë nuk po kundërmon secila lagje edhe ish dashtë me u marrë me këtë problem e jo me u marrë me statuset e asambleistëve edhe me akuzu që na po trillojmë kësi gjëra. Nuk është e vërtetë që po trillojmë, qe në lagjen time 4 ditë, çdo ditë e nali Ekoregjionin i them pse nuk e merrë këtë? Qashtu, na vijmë masdite, i pret masdite prap nuk vijnë. Ka raste që qytetarët i lëjnë veturat jo mirë edhe nuk mundet me ndërhy kamioni, por jo qdoherë. Nuk është puna ime me e monitoru kush në ora sa po e hudh bëlllokun, është dikasteri përkatës. Sa i përket për energjinë elektrike, drejtori tha nuk kemi na mekanizma se si me i thirrë KEDS-in, mua më ka pëlqy idea e Bajramit atëherë edhe prap ndoshta ka ardhë koha me e ripërsëritë. Kur KEDS-i neve na kërkon prona komunale, menjëherë po ja japim me arsyetimin interesi publik, lagjja po mbetet keq. Por, unë mendoj që komuna, kjo emërimi le të mbetet kështu edhe mendoj që qat prononcimin qe e ka pasur atëherë, me pas tash na një prononcim komplet si kuvend edhe me ja u qu një selam që tash e mas mos kërkoni ma prona komunale prej neve se nuk se nuk ju votojmë. Nëse nuk vini me raportu në kuvend, atëherë nuk ka na pse i votojmë, pavarësisht që lagjet mbesin keq, qytetarët janë me rëndësi por le ta kemi, qet forcë e kemi, qet mekanizëm e kemi. Ne atëherë dolëm me reagim, i bënë thirrje KEDS-it, edhe mas 2 muaje na erdh një kërkesë, qetu vetë na lobonin, na thonin mos se po mbetet keq lagjja. Pa qenë na konsistent në qet aspekt, nuk mendoj që KEDS-i ka me qenë serioz. Pastaj, na shumë të interesum me ditë çka ka ndodhë me Shadërvanin? Qaj KEDS që e bllokoj 1 muaj e gjysmë komunën, ish dashtë me ardhë me raportu sepse po flitet për qendrën, zemrën e qytetit. Kështu që, ta shfrytëzojmë qet kuvend dhe ta japim një mesazh krejt grupet, le të mbledhen shefat e grupeve edhe ta bëjnë një lexim, t'ja japim një selam që pasi s'po vijnë, na e lexojmë në kuvend edhe shkresë i qojmë secili asambleist. Qatë që e ke pasur të njëjtën Bajram, e nënshkruajmë edhe ja dërgojmë si kërkesë edhe Prishtinës edhe Prizrenit, është jo serioze.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Atëherë zyrtarit po ja japim fjalën për menaxhimin e mbeturinave.

Muhamet Bajrami: Faleminderit Kryesuese. Unë jam Muhamet Bajrami, Udhëheqës i Sektorit për mjedis dhe Mbeturina. Meqenëse drejtori e bëri një parahrje të menaxhimit të mbeturinave, unë po flas pak sa i përket raportit të përgatitur. Ky raport është i përgjithshëm, raport që përfshin periudhën diku prej vitit prej vitit 2015, prej kohës kur është marrë menaxhimi i mbeturinave nga komuna edhe një historik i shkurtër për zanafillën e krijimit të këtij sektori prej një projekti që e ka pasur “Gjajka” në vitin 2011 deri 2015 kur e ka marrë menaxhimin komuna, kjo është periudhë kur është kriju ky sistem, bazat e krijimit të këtij sistemi për menaxhimin e mbeturinave tuj e pasur parasyshë edhe ndihmën që e ka bërë “Gjajka Japoneze” për 3 vjet si në aspektin e ngritjes së kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave por edhe grantin ndihmës për kompaninë. Kjo përfshijë ka qenë deri në vitin 2015, këtu është një pasqyrë edhe zyrtarëve të sektorit që është udhëheqësi i sektorit, zyrtar për mjedis, zyrtar për menaxhim dhe zyrtar për menaxhim të mbeturinave. Sa i përket stafit, stafi është shumë i vogël për menaxhim të këtij sektori sepse vetë plani 5 vjeçar, plani master kur është bërë planifikimi aty si sektor parashihet që ka qenë dashtë me punu 16 vetë d.m.th. në fillim e pastaj me u rritë numri i tyre. Kemi përfshirë edhe bazën ligjore në bazë të cilës është formu ky sektor, tuj pasur parasyshë ligjin për mbeturina ligjin për mjedis. Sa i përket bazës ligjore, sektori ka pasur planin 5 vjeçar, planin master të cilit i ka skaduar afati vitin e kaluar, për momentin nuk kemi pan 5 vjeçar. E kemi rregulloren për menaxhim të mbeturinave, raporti është kryesisht për menaxhim të mbeturinave d.m.th. nuk ka përmbajtje diçka tjetër. Këtu është një tabelë e të dhënave ku prej vitit 2015 përfshihet numri i amvisërive edhe tash në vitin 2023 tuj u bazu në kontratat e nënshkrume me kompaninë për shërbimin e grumbullimit, transportit dhe deponimit. Këtu shihet në 2015 është 30094 amvisëri, ndërsa në 2023 kontrata është për 33 mijë familje, ky numër është dhënë tuj u bazu në planin master për planifikim të rritjes së cilësisë brenda viteve. Këtu është edhe një historik siç thashë zgjerimi i shërbimit të mbeturinave si ka filluar prej vitit 2015 komuna nuk është mbulu me shërbim komplet, prej vitit 1 janar 2015 është lidhë kontrata me kompani dhe prej atëherë vazhdon kontraktimi i kompanive. Është edhe një tabelë këtu sasia e mbeturinave të deponuara, ky është raport i deponisë i cili është marrë prej tyre edhe inkasimi i mjeteve brenda vitit. Në 2015 nuk është qitë, janë mbledhë 600 mijë d.m.th. ka qenë viti i parë, ndërsa vitet tjera janë 1.000.000-1.100.000, përveç 2021 që kena pasur 1.380.000. euro, kjo shumë e mbledhur nuk mbulon kontratat të cilën e kemi me kompaninë, gjithmonë komuna duhet me dhënë pak më shumë edhe pse sipas rregullores çdo kushtëzim në komunë është me pagesë të mbeturinave, ajo është në fuqi por para 2 viteve ky kushtëzim u anashkalu sepse njerëzit po munden me u furnizu onlline me disa dokumente. Kështu që ai kushtëzim pak ka rënë poshtë por në 2023 edhe tani inkasimi është aty diku, ka rënë pak por inkasimi përfaqësohet është i njëjtë. Me këtë po du me thënë që brenda 10 viteve kemi arritur që ndoshta me i ndërgjegjësu qytetarët që duhet pagesat me u bërë edhe pse kemi shumë telashe me pagesa sepse shumë qytetarë nuk paguajnë, kemi numër të madh! Kontrata me Eko-regjionin për shërbim të grumbullimit është sistemi derë më derë, kamioni derë më derë shkon 1 herë në javë në të gjitha fshatrat por edhe në qytet ku kemi banime individuale. Ndërsa 2-5 herë është shërbimi ku kemi banim kolektiv, edhe rruga unazore bëhet shërbimi 5 herë brenda ditës. Nëse bëhet shërbimi brenda rrugës unazore 5 herë, z’don me thënë që ky shërbim bëhet edhe për qytetarë, për ta bëhet 1 herë në javë dhe shpesh herë qytetarët ndoshta e keqkuptojnë, kur kemi banim kolektiv shkojnë 2-3 herë në ditë, unë kam pasur raste që kanë thënë tek na vjen 2 herë në javë, gjë që s’është e vërtetë, shërbimi bëhet 2-3 herë kur kemi banim kolektiv. Shpesh është bërë pyetje se kush i monitoron këto, përgjigja u kanë gjithmonë se qytetarët janë gjithmonë monitoruesit më të mirë, mbikëqyrësit ma të mirë sepse ata njëherë mos me u bërë shërbimi kanë me thirrë, e këtyre thirrjeve

këta e kanë numrin e komunës, janë shumë të rralla dhe gjithmonë unë dyshoj tek ato thirrje sepse ose është vonuar me i qitë ose ka qitë mbeturinat një sasi të mbeturinave që nuk e marrin ata sepse mbeturinat inerte nuk merren. Sa i përket pikave në të zeze-pikave ilegale, shërbimi bëhet i rregullt dhe se besoj që ka nevojë me u bë ato pika do të thotë këto pika janë kryesisht të mbetjeve intere edhe në periferi të qytetit nëpër fshatra, edhe mbeturinat kur përzihen me mbetjet e materialeve ndërtimore ato krijojnë përshtypje që ka mbetje edhe të kuzhinës por që nuk. Sektori çdo vit bënë raportim në ministri deri më 31 mars, domethënë ky është obligim. Në fund është një tabelë dhe është një gabim te numri i ekonomive familjare ka mbetë vetëm një 3-sh, aty është 33.124 në bazë të kontratës që është nënshkruar me kompaninë, raportet që bëhen, bëhen tuj u bazu në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, domethënë kemi 177.731.000 është numri i ekonomive familjare, është numri i bizneseve të cilin e marrim prej kompanisë e cila është e planifikume për shërbim. Sasia e mbeturinave të deponuara është diku 50.000.00 ton brenda vitit, të deponuara, të gjeneruara munden me kanë ma shumë diçka ku ka raste hudhen edhe ilegalisht, mundem me kanë diku 136 ton për ditë si mesatare. Mesatarja e sasisë së mbeturinave të gjeneruara për kokë banori në Kosovë është diku 07-1 kg, domethënë këtu sipas të dhënave po na del 0.75 kg për kokë banori.

Antigona Bytyqi: A i lëmë detajet në seancë.

Bajram Kastrati: Detajet më mirë në seancë.

Muhamet Bajrami: Veç geto të fundit thash ta spjegoj, por në rrengull. Qekjo ke një prezentim i shkurtër për sa i përket sektorit, shërbimi bëhet.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, meqë jeni edhe në kuvend. A kemi ndonjë pyetje të anëtarëve?

Dafina Alishani: Qysh veç pak. Shërbimi nuk po bëhet, tash edhe unë jam qytetare. Ju po thuani monitoruesit më të mirë janë qytetarët, shërbimi nuk po bëhet. A muj me pas një numër të telefonit apo ku mu orientu si qytetare, jo si asambleiste?

Muhamet Bajrami: Si qytetare, fatura çdo muaj shpërndahet tek çdo familje, aty është edhe numri kontaktues edhe gjithmonë qytetarët thirrin në qat numër kontaktues.

Dafina Alishani: E a kena të drejtë na me u anku kur nuk bëhet shërbimi apo ju e ekni të pjekun në tru që po bëhet shërbimi edhe nuk ka nevojë me pasë?

Muhamet Bajrami: Sigurisht që ki të drejtë nëse nuk bëhet, atëherë për çka kemi lidhë na kontratë me kompanin? për shërbim.

Dafina Alishani: A mundeni me u marrë me qeto punë?

Muhamet Bajrami: Po, neve nuk na ka ardhë naj ankesë që su bë naj shërbim rregullisht. Në qoftëse shihet një thes me mbeturina z'don me thënë që nuk bëhet shërbimi. Për mua është problem nëse nuk bëhet shërbimi kur e ka çdo ditë nuk shkon, e ka 1 herë në javë, nuk shkon, për mua është qasj shqetësim. Në qoftëse vonohet ai me i qitë ose në qoftëse i qet në mbrëmje edhe shkojnë qentë e shkapërderdhin ajo është pak edhe përgjegjësi e qytetarëve.

Karanfil Haxhillari: Zotëri Bajrami a po bëhemi transparent?

Muhamet Bajrami: Po urdhëro.

Karanfil Haxhillari: Po du me fillu debatin me një pyetje. Sa borgj ja keni Eko-regjionit?

Muhamet Bajrami: Eko-regjionit?

Karanfil Haxhillari: Po

Karanfil Haxhillari: Kush?

Dafina Alishani: Komuna.

Muhamet Bajrami: Për komunën s'muj me fol, muj me folë për sektorin tem.

Karanfil Haxhillari: Ju jeni ndërmjetësit, sektori i Menaxhimit të Mbeturinave është domethënë ndërmjetësi që është në mes të ndërmarrjes që sot i ka projektet për pastrim, grumbullim mirëmbajtje e të gjitha projektet edhe komunës.

Muhamet Bajrami: Fakturat e 2 muajve të fundit janë pa paguar.

Karanfil Hashillari: Një vlerë, vlerën? 600 mijë euro?

Muhamet Bajrami: Jo, 532. 400....

Karanfil Haxhillari: E nisa prej ktuhit për arsye se më herët nuk ka pasur kështu problem, është bërë edhe pastrimi i pikave ilegale edhe grumbullimi i regullt. Por në momentin kur komuna ndërmarrjes kontraktuese nuk ja jep paret dhe ndërmarrja mbetet pa naftë, ajo nuk mundet me dalë me ti mbledhë bërlllogun. Të folim haptas tash, media s'kemi qetu, po flasim hapur. Unë kam qenë në Komisionin Komunal të Aksionarëve të Eko-regjionit dhe e di si funksionon. Në momentin kur komuna i detyrohet ndërmarrjes ajo pa naftë s'ka qysh del me ta mbedh bërlllogun pavarësisht që detyrohet. Prandaj që të jemi korrekt, edhe ju në ndërmarrje edhe ndërmarrja me qytetarin në këtë rast, pagujani borgjin që të ketë naftë që të dalin ta mbledhin bërlllogun. Mos na akuzoni neve në këtë rast qysh na akuzoi drejtori që po dalim me postime! Po dalim me postime sepse temperaturat 45* celcius dhe ato jane edhe burim infeksioni përveçse papastërti dhe erë. Në këtë rast të bëhemi korrekt, ndërmarrja punën deri tash e ka bërë domethënë qe 1 muajin e fundit është kjo neglizhencë, por edhe arsyetimi i ndërmarrjes është kjo. Prandaj, obligimi juaj në këtë rast në takim me kryetarin, ta paguajnë borgjin që të ketë ndërmarrja naftë dhe të dalë ta kryej punën e vetë duke mos bërë bishta të asnjë debati dhe të jemi transparent. Fatmirësisht Prizreni e ka një ndërmarrje të mirë të grumbullimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së rrugëve si verore si dimërore. Por, ama edhe ju duhet të jeni korrekt me këtë ndërmarrje në këtë rast sepse fatmirësisht nuk e kemi tash një situatë qysh ka qenë më herët që e kam përjetuar unë por është shumë më e mirë brenda strukturalizimit dhe funksionimit të ndërmarrjes së Eko-regjionit. Por të jemi real, po mblidhen ato mbeturina, mos ti fajësojmë qytetarët, qytetari është mësu tan kohën në qat orar me i qitë qat pjesën me bërlllog qaty, e tash që është faji i tjetërkujt që s'ka naftë me e mbledhë qatë, nuk ka faj qytetari sepse ai tan jetën e ka gjujtë qat pjesën e bërlllogut në qat pjesën e caktume, s'di sa jam i qartë.

Muhamet Bajrami: Unë jam edhe mbikëqyrës i zhvillimit të punimeve, deri tash nuk kam marrë naj ankesë që su bërë shërbimi për një kohë të gjatë.

Karanfil Haxhillari: Po shihen bre Muhamet grumbujt me bëlloke.

Muhamet Bajrami: Mirë de, kjo ka fillu qet javë! Unë e kam bërë raportin për 15 vjet. Nëse është lyp një raport për qet periudhë kohore është diçka tjetër. Drejtori mundet me dhënë përgjigje për këtë gjë, për shërbim unë them dhe i rri mbas asaj që po bëhet.

Antigona Bytyqi: Ta ndëgjojmë Florentin.

Florent Ukaj: Edhe unë pak a shumë deshta me u ndërlikohë Filin por edhe me ju kundërpërgjigj drejtorit që ke që akuzoj që po i hudhim na që po postojmë se edhe na LDK-ja e kemi bërë një reagim. A ka ndërmarrë inspektoriatin naj veprim ndaj atyre përderisa po i dijka drejtori kush i ka hudhë mbeturinat si në sheshin shadërvan si kudokoftë? Pyetje a parë është kjo. Pyetja e dytë, sipas informatave që i kam unë prej punëtorëve të Eko-regjionit ti po thu që në unazën e qytetit bëhet 2-5 herë brenda ditës! Edhe unë pajtohem me Filin që muajin e fundit vetëm 1 herë unaza e qytetit është tuj u pastru, arsyet po besoj që i shpjegoj edhe Fili. Edhe e treta, deshta me të pyet përgjegjësi e kujt është mirëmbajtja rreth lumenjëve që janë në Komunën e Prizrenit? Ti e din besoj sepse sidomos në fshatin tonë ku jetoj është një kundërmim i madh aty. A kemi naj kompetencë që mujna mi pastru ose me na.

Muhamet Bajrami: Aty duhet me naj kontratë kështu të veçantë, nuk ka mirëmbajtje të rregullt të brigjeve. Sa i përket pyetjes së parë, unë thash që janë inspektorat me i dënu jo na, na jemi për shërbim, kërkesa duhet me ju drejtu atyre sepse ajo janë për me dhënë dënim e jo unë. Unë mundem me dhënë përgjegjësi nëse nuk e merr dikush.

Florent Ukaj: Ty tash po të thojmë në emër të drejtorit, se drejtori na akuzoj neve që po i gjumë bërlloget edhe po shkojmë po bëjmë foto!

Muhamet Bajrami: Për fat të keq nuk kam Facebook me i pa fotografitë, duhet ku janë, ku po bahet.

Florent Ukaj: Qajo në shatërvan është shëmti, hajde tjera po i nxajmë qe lena fajin neve por qajo e shatërvanit nuk besoj që merr guximin një asambleist ose një partiak me shku në shatërvan me hudh, këto tjera hajde po e nxëmë që i kemi gjujtë na por qajo në shatërvan!

Muhamet Bajrami: Jo ju, por dikush i gjuan.

Florent Ukaj: Qate deshta me pyet, nuk po them që nuk ka, qatë dashta me vetë drejtorin a ka ndërmarrë inspektoriatin diçka? Besoj që e dinë ato se i kujt është ai bërllog.

Muhamet Bajrami: Ndoshta e din, ai mban përgjegjësi për atë.

Antigona Bytyqi: Bajrami e ka kërku fjalën.

Bajram Kastrati: Po, faleminderit. Sa i përket unazës i nderuari zotëri Bajrami është e vërtetë sepse unë e kam edhe biznesin-lokalin në unazë edhe ndodh që jo veç njëherë, por ndodh që brenda ditës asnjëherë mos me ardhë! Është shumë e vërtetë që nuk e marrin bëllogun edhe pse

bajagi e qesim te rruga, sidomos qet kohën e fundit, më herët janë kanë më mirë, tash kohën e fundit.

Muhamet Bajrami: Duhet me e specifiku.

Bajram Kastrati: Sa i përket kësaj kositjes në trotuar e kujt është?

Muhamet Bajrami: Mirë de është, por tash ky raporti është për menaxhimin e mbeturinave dhe mirëmbajtje.

Bajram Kastrati: A është edhe ajo mbeturinë, se edhe ajo mbeturinë po bëhet në rrugë. Kush e menaxhon?

Muhamet Bajrami: Bari a?

Bajram Kastrati: Po de qaj bari, qat bërlllogun që e mbledhin, ai kur po vjen me kositë po e mmbledhin komplet bërlllogun, tash është bë bajagi i madh nëpër lagje, flas për Arbanë edhe nuk vijnë me kositë edhe krahas asaj këtë bërlllogun që e mbledhshin anën tjetër, as atë nuk vjen me mbledhë kërkush! E ka si pa orar, me ditë bile që vjen 1 herë në javë ose 1 herë në dy javë, qysh e kanë të rregullune këtë çshtje?

Muhamet Bajrami: Thash unë jam për menaxhimin e mbeturinave, por sa i përket mirëmbajtjes ata e kanë kontratën edhe vendet cilat kanë me i mirëmbajtë, s'don me thënë tash që krejt qyteti duhet me shku e me u kositë, ndërsa koha edhe në kontratë shkruan brenda muajit por s'po më kujtohet sa është e qysh është mirëmbajtja e rregullt, nuk domethënë me caktu p.sh. datën 15 por mirëmbajtje e rregullt që nënkupton që normal që duhet me u kositër por vendet e kontraktume.

Bajram Kastrati: Atëherë më mirë po u duka na mu drejtu tek Eko-regjioni për me marrë një informatë pak më të saktë kur vinë e qysh vijnë sepse ajo u ba keq.

Egzona Hoxhaj: Kryesuese unë veç deshta me i falënderu sepse tek ne në regjionin e Hasit mbeturinat mirren 1 herë në javë, janë shumë të rregullta edhe çdo herë është e njëjta ditë edhe nuk ndërrohet orari, si kur kemi kërkesa për mu ba kositja e barit, pastrimi i varrezave, gjithmonë janë në gatishmëri edhe kjo është një diçka që po doket edhe po duartrokitet edhe prej banorëve sepse sinqerisht kurrë ma pastër se gjatë kësaj kohe s'kena qenë.

Muhamet Bajrami: Egzona edhe unë sinqerisht po të them ankesat i kemi menjëherë prej qytetarëve, ankesat i kemi shumë të rralla edhe po them pa arsye.

Dafina Alishani: Qysh bre pa arsye, s'jeni ju me vlerësu me arsye apo pa arsye. Ju jeni me mbikëqyr sektorin e mjedisit edhe menaxhimin e mbeturinave. Është arrogancë me thënë pa arsye, nëse qytetari e ka një ankesë ju duheni me marrë parasyshtë, nuk jeni ju me e vlerësu a ka arsyeshmëri a jo.

Muhamet Bajrami: Po ta demostroj me një shembull. Erdhi njëri tha nuk ma kanë marrë barin që e kam kositë.

Dafina Alishani: Leni Barin, qe bërlllogun, a don me shku mas KPF-së me të kallxu.

Muhamet Bajrami: E thirra kompaninë se pse se ke marrë, aty kish pasë 20 thasë edhe inerte.

Bajram Kastrati: Ka edhe asi, por s' do të thotë që krejt është qashtu.

Muhamet Bajrami: Po, por edhe në anë tjetër nuk është krejt qashtu.

Dafina Alishani: Pa arsye, nuk jeni ju për me e vlerësu arsyeshmërinë e ankesës, gabim është kjo qasje.

Muhamet Bajraqmi: Ankesa po bëhet te unë, edhe gjithmonë unë e kam qu kompaninë me reagu edhe ka qenë për vonesë ose.

Antigona Bytyqi: A e përfunduat ta qesim në votim.

Dafina Alishani: çka ki me qit në votim kur po lun hajgare, hajgare po lun, s'ka arsye thotë.

Bajram Kastrati: qe unë po të flas me fakte. Kraas kësaj krejt e ki pa pastru, rrugës kryesore është.

Muhamet Bajrami: Bajram nashta aty se kanë hiç me shku, duhet me këqyr kontratën.

Bajram Kastrati: E ka kontratën, janë kanë më herët por tash s'po vijnë.

Antigona Bytyqi: Pikën e 6-të po e hedhi në votim që t'i rekomandohet mbledhjes. Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e shtatë.

Pika e shtatë:

Raporti financiar janar - qershor 2024;

Antigona Bytyqi: Fjala për juve Gjafer.

Gjafer Ponik: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Unë raportin financiar po e prezentoj vetëm në pika të trasha, e keni drejtori në seancë për më në detaje. Vetëm deshta me cekë që buxhetin për vitin 2024 e kemi 67.822.000.00, shpenzimi shpenzimi deri më 30 qershor është 30.339.000.00, kurse kurse me përqindje është 74.73%.

Dafina Alishani: Veç një pyetje e kam. Pse po vonohen pagesat si në subvencione si te pjesa e nënave lehona. A s'keni mjete a çka është problemi?

Gjafer Ponik: Problemi është që të hyrat vetanake kanë qenë pak më të vogla edhe subvencioni shkon përmes të hyrave vetanake. Një pjesë është lëshuar në qershor edhe një pjesë tash është përgatit për me shku për prishtinë, për lehonat po flas, domethënë është nënshkru të premtën nga kryetari, lista është përcjellë në Prishtinë sepse atje ekzekutohen pagesat për lehonat. Mirëpo pjesa tjetër domethënë gradualisht qysh po ka të hyra ashtu po lëshohen mjetet.

Dafina Alishani: DKRS-ja, Drejtorja e Zhvillimit?

Gjafer Ponik: Ato nuk e di, unë po foli për lehonat sepse kam qenë kryetar i komisionit edhe.

Dafina Alishani: Te subvencionet?

Gjafer Ponik: Aty ka mungesë të mjeteve. Janë të hyrat e vogla edhe janë lëshuar një pjesë për lehonat dhe një pjesë për DKRS-në.

Dafina Alishani: Edhe pse s'po jepni qasje në dokumente?

Gjafer Ponik: Nuk e di për qasje në dokumente, çka i përket Drejtorisë së Financave çka ka ardhë deri tash na e kemi dhënë nëse është aprovuar nga zyra e informimit.

Dafina Alishani: E për bursa?

Gjafer Ponik: Për bursa pritet këtë javë me u publiku lista, e për pagesë nuk muj me garantu kurgjo hiç se ka mungesë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. A ka dikush tjetër diçka? Prezent jemi 7 anëtarë, kush është për që ti rekomandohet mbledhjes? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e tetë.

Pika e tetë:

Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor;

Antigona Bytyqi: Drejtoreshë fjala për juve, veç tu kisha lutë sa më shkurtë.

Luljeta Veselaj Gutaj: Ju faleminderit Kryesuese. Unë veç një informatë që është shumë e rëndësishme, këtë vit Prizreni, ka ba dallimin më të lartë te kalueshmëria e testit të maturës, ka rritje diku afër 10% nga vitet e kalume dhe ky është një sukses i përbashkët i të gjithë akterëve. Përndryshe sa i përket raportit i keni të përshkrum, jo në detaje sepse ka edhe shumë punë tjera që janë bë, por një përmbledhje e punëve që janë bë. Çkado që keni pyetje unë jam këtu mu përgjigj.

Karanfil Haxhillari: A është e vërtetë që shumë nga drejtorat nëpër shkolla kanë bë thirrje që nxënësit të kopjojnë më shumë për testin e kalueshmërisë sepse nëpër disa informata që i kemi pasë, gjithandej janë, nuk kam se janë rritë fëmijet unë se di.

Luljeta Veselaj Gutaj: Në arrtshmëri po thua apo ku?

Karanfil Haxhillari: Ne maturë. Një, edhe e dyta po du me potencu përsëri këtë punën e këtij rastit në shkollën Ekrem rexha në Lubizhdë. Me të vërtetë drejtoreshë, Komisioni Disiplinor me përjashtu prej pune një sinjalizues është e tmerrshme për gjithë atë ngjarje që ka ndodhë edhe që të gjithë jemi të informuar. Kjo është në të gjitha variantet një e padrejtë edhe pse se njoh atë njeri edhe pse nuk kam ndonjë informacion sepse më së paku jam marrë me këtë çështje. Por, definitivisht në qoftëse vetëm një logjik të thjeshtë e përdorim e shohim që të përjashtohet me një vendim të Komisionit Disiplinor një sinjalizues për një ngacmim që ka ndodhë dhe të amnistohet ngacmuesi, ose së paku të dytë ti kishit përjashtuar! S'po kapet edhe është një kafshatë e pa gëlltitshme sepse me këtë a e din çka ndodhë të nesërmen? Me këtë ndodhë që të gjithë të cilët vërejnë ndonjë ngacmim tjetër, ata e kanë parasyshë që ndoshta do të përjashtohet sikur ky, do ta

kenë e këtij. Pra, kjo është një bllokim në avancimin e vetëdijësimit edhe ndalimit të fenomeneve negative në shkolla! Fenomenet negative nëpër shkolla duhet ti ndalojmë të gjitha format dhe duhet të kemi sa më shumë sinjalizues nëpër shkolla që të ndërhyjnë në ato gjëra negative në mënyrë që ta kemi një siguri shumë ma të madhe nëpër këto shkolla. Por, vendimi i Komisionit Disiplinor, kur e kam kuptu që nëpunësi përjashtohet nga puna ka qenë një tronditje e rëndë, sinjalizues, kurse ngacmuesi amnistohet!

Luljeta Veselaj Gutaj: Njëherë a ti marrë apo të përgjigjem menjëherë? Po përgjigjem. Sa i përket thirrjes që thatë drejtorët kanë bë thirrje për kopjim, të paktën unë për herë të parë po e ndëgjoj këtu! Përkundrazi i kemi bë thirrje për vëmendje edhe për përqëndrim në test. Kanë bë përgatitje paraprake me ditë tana nëpër shkolla në lidhje me ushtrimet e detyrave, kua di unë pyetjeve çka mund të jenë temat të cilat trajtohen në test. E kam përcjellë me vëmendje procesin e maturës, ka pasur një sfidë në lidhje me aplikimin në e-kosova por janë ndihmu, kanë asistuar shkollat me kujdestarët të klasave dhe ju ka shku mirë procesi. Poashtu, për dallim nga herët e kalume asnjë nxënës të një klase nuk kanë qenë bashkë domethënë ka qenë një kombinim krejt ndryshe që jo të klasës por as të shkollës ndoshta nuk i kanë pasur brenda klasës, krejt varësisht nga aplikimet që i kanë pasur në e-kosova dhe monitorimi brenda sa e kemi parë nga zyrtarët e ministrisë, nga administruesit që kanë ardhur nga komunat tjera, por përveç tyre ka pasur edhe student që e kanë monitoruar këtë proces. Shumë mirë që kanë qenë studentë por ka qenë një proces i parregullt me student sepse s'kanë pasur kartelë identiteti sepse ministria është dashtë me ja u bë nga një bexh edhe me thënë që është në cilësinë e vëzhguesit-monitoruesit. Por. Kanë qenë të pranishëm dhe janë kombinu brenda shkollave dhe si proces nuk ka pasur asnjë vërejtje për Prizrenin. Sa i përket pyetjes së dytë, janë vendimet e Komisionit Disiplinor, shpesh jam e pakënaqur me vendime që marrim unë në cilësinë e drejtueses nëse kam inicuar sepse kam pasur edhe raste tjera që kemi inicuar në Komision Disiplinor dhe kam pranuar vendime ku unë kam mendu ndryshe, por ndryshe ka ardhur vendimi dhe ne jemi të obliguar me i respektu vendimet të cilat na vijnë qoftë prej gjykatës, Komisionit Disiplinor ose tjerëve që na obligojnë.

Dafina Alishani: Me ligj sinjalizuesit mbrohen.

Luljeta Veselaj Gutaj: I kërkon të drejtat e veta, me sa e di unë janë edhe në gjykatë ato. Unë p.sh. Dafina e kam kthi në punë ose kam lidhë kontratë me mësimdhënësen për 2020 apo 2019, ju ka bë e padrejtë, ka vazhduar me procese të gjykatës dhe e ka fitu në gjykatë rastin dhe filanja ka ardhë e ka lidhë kontratën se gjykata i ka thënë kqyre se qetij personi ju ka ba e padrejtë dhe të gjitha provat dhe argumentet flasin në të drejtën e saj apo të tij dhe vazhdon procedura. Janë vendime të cilat na obligohemi me i respektu.

Dafina Alishani: Po veç herën e parë kur është ngritë si shqetësim puna e ngacmimit, ju vetë keni deklaruar dhe keni thënë që pa i kry punët policia edhe gjykata ne nuk kemi çka mirremi me atë punë edhe nuk kemi çka marrim vendim.

Luljeta Veselaj Gutaj: Pa të dal një vendim final, neve na ka ardhë një vendim, kanë thënë ki me respektu qet vendim.

Dafina Alishani: Po para kësaj ju vetë jeni deklaruar, na vet1% ju kemi ftuar juve me marë hapa konkrete.

Luljeta Veselaj Gutaj: E vërtetë. Komisioni Disiplinorë kërkon argumente edhe prej policisë edhe prej të gjithë akterëve të cilët kanë marrë pjesë sepse policia kanë qenë të pranishëm në shkollë. Nuk kanë mundur me nxjerrë një vendim pa i pasur argumentet për me dalë, për me u qitë prej pune.

Dafina Alishani: A është përfundu procesi në polici e gjykatë?

Luljeta Veselaj Gutaj: Nuk e di për atë proces sepse ata e kanë qu njëri tjetrin në gjykatë. Policia e bënë raportin dhe ja dorëzon Komisionit Disiplinor. Komisioni Disiplinor mbi bazën e të gjeturave që i ka pasur, e ka nxjerrë një vendim, ata kanë të drejtë ankese në gjykatë dhe në instanca tjera. Nëse vjen një vendim tjetër, prap po them ndryshe është situata kur.

Karanfil Haxhillari: Po bre drejtoreshë, por a ta jep ty me kuptu që, hajde po dalim po e shoh një ngjarje dhe logjika menjëherë më qon se në qoftëse unë e lajmëroj një feonomen negativ përjashtohem sikur ai zotnia atje prej punës. Efekti është një feket tepër i dëmshëm për vetëdijësimin dhe për të ardhmen.

Dafina Alishani: E këtu ju keni përgjegjësi, jo Komisioni.

Luljeta Veselaj Gutaj: Qysh na.

Dafina Alishani: Po de, po komisioni nuk mundet me dalë mbi DKA-në edhe këtu po shkelet e drejta e një fëmisë, po shkelet e drejta e një mësimdhënësi edhe DKA-ja po heshtë! Pse? Sepse Komisioni paska marrë vendim por nuk e di as qysh e ka marrë atë vendim, a është qashtu? Tash nesër, masnesër një ngacmim tjetër, a jeni marrë me qat ngacmim a jo?

Luljeta Veselaj Gutaj: Na nuk kemi hesht hiç sepse na e kemi delegu, është një komision në kuadër të komunës që në fakt i mbledh të gjitha provat.

Dafina Alishani: Kush e ka kthy drejtoreshën në vend pune?

Luljeta Veselaj Gutaj: E ka kthy Komisioni Disiplinor se ka marrë vendim, e ka vendimin që ju ka dhënë edhe një masë ndëshkimore për komunikimin që e ka pasë. Mbi bazën e të gjeturave dhe provave e ka nxjerrë një vendim edhe Komisioni menoj që nuk guxon me nxjerrë një vendim, e ka qat guxim i cili nuk ka fakte dhe prova për me nxjerrë një vendim.

Dafina Alishani: Ose ngacmimi te shkolla Abdyl Frashëri, çka ka ndodhë me atë person?

Luljeta Veselaj Gutaj: U largu prej punës.

Dafina Alishani: U largu prej punës. Kush e ka marrë arë vendim?

Luljeta Veselaj Gutaj: Komisioni Disiplinor.

Dafina Alishani: E ju s'jeni marrë hiç?

Luljeta Veselaj Gutaj: Ata, na menjëherë e kemi inicu në Komision Disiplinor mbi bazën e fakteve ka vendim për largim nga puna edhe ai po vazhdon me proces gjyqsorë.

Dafina Alishani: A mundemi na me pas qasje te Komisioni Disiplinor se në çfarë baza apo çfarë dokumente prej policisë ata kanë marrë?

Luljeta Veselaj Gutaj: Është në kuadër të komunës te Zyra e Burimeve Njerëzore. Ju mundeni me kërku qasje, ndoshta keni të drejtë nuk e di sa keni të drejtë, tek ajo pjesë nuk e di.

Antigona Bytyqi: Ju faleminderit. Dikush tjetër a ka diçka me shtuar? Po urdhëro Naxhije.

Naxhije Memaj: Na jemi të gjithë dëshmitarë të problemeve të vazhdueshme në arsim. Edhe unë pajtohem plotësisht me parafolësit.

Luljeta Veselaj Gutaj: N'varet çka quan problem?

Naxhije Memaj: Tuj fillu prej kopjimeve, ngacmimeve, të gjitha këto janë alarmante në arsim këto gjëra. Por sidoqoftë unë po mendoj që kjo pikë e rendit të ditës duhet me ju dërgu kuvendit dhe aty do ti paraqesim problemet dhe shqetësimet që i kemi. Është një temë shumë e rëndë që shumë mund të diskutohet aty.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, dikush tjetër a ka? Në qoftëse jo po e hedhim në votim. Prezent jemi 7 anëtarë, kush është për që ti rekomandohet mbledhjes së kuvendit? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e nëntë.

Pika e nëntë:

Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024.

Antigona Bytyqi: Veron fjala për juve.

Veron Tara: Përshëndetje të gjithëve, jam Veroni, Kryesues i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, një institucion që krijohet prej ligjit të veçantë për qendrën historike. Për ata që nuk e dinë, Prizreni e ka një qendër historike që është formuar me ligj, që I ka 42 hektarë, se shumë shpesh jemi tuj e harru qet informacion, plus e ka edhe një zonë të dytë të mbrojtur që është votuar tashmë në ministri e që I ka sa 3 herë zona e qendrës historike. Është një institucion që gjithmonë anashkalohet si prej nivelit qendror si prej nivelit lokal, shumica e drejtorive e shohin këtë institucion si pengesë për realizimin e projekteve të tyre e jo si ndihmesë për me arrit me pas një produkt apo një shërbim sa më të mire Brenda qendrës historike. Zyrtaari për mbeturina shkoj, kam pasur me bë një diskutim apo një pyetje që. Deshta një replikë Karanfililit me ja bë, ok qytetari është mësuar me lënë bërlllokun aty, nuk mundesh me e lënë hala me u mësuar që me e lënë midis shatërvanit, midis monumentit hala bërlllokun.

Karanfil Haxhillari: Në qoftëse nuk ka kanta aty?

Veron Tara: Jo jo, e ki Ligjin për Qendrën Historike i cili thotë që nuk guxon me pas kanta brenda qendrës historike, pikë, e mban bërlllokun në shtëpi dhe kur të vjen kamioni, ja qet kamionit. Unë tash e 6 vite shkruaj reagim që duhet me u hjek të gjitha kantat e bërlllokut jashtë monumenteve. Te Xhamia e Sinan Pashës, jo marre por ma se di çka është aty, te Bajraklia qashtu e ki, te Namazxhahu. Gjethkah i ki, po flas për xhamia por kjo vlen edhe për krejt monumentet tjera. Pse

po flas Brenda qendrës historike? Sepse komplet qendra historike konsiderohet monument, me ligjin e veçantë, me ligjin e zonave të veçanta, me ligjin e trashëgimisë kulturore. Janë 3 ligje që ta determinojnë që e ki zonë të veçantë dhe trajtohet si monument ansambël. Tash unë sun tham mos qitni shporta hiç sepse është e pamundur ti me I thënë mos qit shporta, por jo vende të grumbullimit të mbeturinave. Menaxhimi që këta e bëjnë, është menaxhimi që është bë para 150-200 vjetëve, qe ky menaxhim, ky menaxhim nuk vlen. Në ligj kërkohet që komuna me bë plan të menaxhimit në bashkëpunim me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore dhe Këshillin e Trashëgimisë Kulturore. Unë tash e 5 vite kurrë s'kam marrë asnjë kërkesë prej DSHP-së, që me ardhë me thënë hajde tregonani se ku mundemi me i vendosë qeto vendgrumbullime për mbeturina, që është mëse e nevojshme. Te Sinan Pasha, shumica e restauranteve hedhim mbeturina të kuzhinës që i vjen shumë era e rëndë sepse është pika e verës na po e dimë. Por, qysh mujnë me hudhë edhe mbeturina tjera? Unë aty kam pa kauqa, jogi, kam pa dollapa, frigorifera. Qysh mundesh me thane ti mbeturinat vëllimore veç njëherë mblidhen, s'ka logjikë! Inspektoriati është në gjum, po shpresoj që seancën e kalume, se është bë 1 vit që s'na keni thirrë, po shpresoj që seancën e ardhshme ka me qenë edhe rejtori i inspektoriateve sepse herën e kalume ja nisi tuj më bërtit dhe tuj um quajtë rrenc për senet që po i djeg kryesisht! Edhe me pasë një diskutim ma të hapur sepse asnjë përgjigje asnjëherë nuk marrë unë prej inspektoriatit, asnjëherë edhe pse gati muj me thënë çdo javë na e kontaktojmë edhe I dërgojmë shkresa por që asnjëherë nuk kemi përgjigje! Puna për ndaljen që nuk ka ndërtime pa leje është 99.9% gënjeshtër, se unë jam çdo ditë në rrugë edhe shoh çdo ditë tejkalime ose ndërtime pa leje edhe në aspekt komuna kur investon edhe në aspekt kur investitorët privat, domethënë 99.9% të rasteve. Unë muj me ju dhënë të gjitha rekomandimet, të gjitha lejet që janë leshu nga komuna e Prizrenit, dilni në teren edhe i verifikoni se a janë të njëjta me projektin që e kanë dorëzuar. Edhe të gjitha lejet tjera shkoni lypjani intervenimet në fasada, në kulma, në kate gjithçka në dysheme, krejt janë pa leje. Këto domethënë unë i kam të verifikume, i kam me parcela, me fotografi e me krejt. S'po du me u ndal shumë sepse ashtu, ashtu kam me e lexuar raportin në asamble, po shpresoj që e keni lexuar dhe nëse keni naj pyetje. Por, nuk është hiç gjendja e mirë brenda qendrës historike, hiç aspak e mirë, çdo vit e më shumë po bëhemi keq e ma keq. Nëse ndalemi nga aspekti i ruajtjes së trashëgimisë sepse gjithmonë thirrëmi në aspekt të historisë, kulturës dhe trashëgimisë, ajo ma nuk vlen. Prizreni e ka hup vlerën e trashëgimisë kulturore sepse çdo ditë Komuna e Prizrenit lëshon leje për rregullimin e objekteve të vjetra apo objekteve që komuna bëhet në këtë rast vlerësuese e trashëgimisë kulturore që nuk ka të drejtë edhe jep leje rrënimin e monumenteve, mos të them monumenteve por çdo ndërtesë që është brenda qendrës historike konsiderohet monument. Gjendja është shumë alarmante, investime s'ka hiç në aspekt të trashëgimisë, nuk mundemi me i quajte rrugët investim në trashëgimi kulturore se nuk është. Shenjëzim nuk kemi, ndriçim nuk kemi, mirëmbajtje nuk kemi, kurgjo nuk kemi në aspekt të trashëgimisë. Strategjia për zhvillim ekonomik, unë atë ditë jam kanë edhe e kam dhënë komentet e mia, në aspekt të asaj strategjie, ajo nuk është strategji. Kështu që, nëse keni naj pyetje, jam i hapur.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. A dëshiron dikush me e marrë fjalë?

Karanfil Haxhillari: Në kuvend, por unë ndoshta nuk do të jem në kuvend. Çështjen e rrënimin të Farmakosit të vjetër e kam ngritë në kuvend por s'kam marrë përgjigje nga snjë drejtor! A mundet ta di, në fakt ju si qendër a keni njohuri çka ka ndodhë aty? Tashmë po e di që janë ndal punimet nga ministria, por çka do të ndodhë? Tash ai u rrënu, aty u bë gërdec! A mund të marr informacion, jam rritë e kam pikë të dobët, kur e kam pa tuj u rrënu lotët më kanë dalë.

Veron Tara: Po e di, edhe neve qashtu. Puna e parë është që Farmakosi nuk hyn brenda qendrës historike edhe ne si këshill nuk kemi kompetencë kurrfarë vendim i me marrë ose kurrfarë rekomandimi me lëshuar ose reagim në aspekt të Farmakosit, si institucion po flas, ndërsa privatisht mundem me të kallxu jashtë seancës.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër?

Karanfil Haxhillari: Prap s'mora përgjigje!

Veron Tara: Po më vjen keq por nuk këna kompetencë jashtë qendrës historike.

Dafina Alishani: Por komuna është kompetente për ruajtjen e trashëgimisë, është votu për këtë pavarësisht a është në qendrën historike a jo.

Veron Tara: Nga aspekti i Drejtorisë së Urbanizmit po, por na si institucion.

Dafina Alishani: Edhe është dhënë një leje për rrënim, besoj që dikush ish dashtë me u marrë me këtë e kryetari ka pasur premtime të shumta për mbrojtjen e trashëgimisë. A mundemi tash me thënë jo s'është kompetencë e jona, atëherë s'është kompetencë as shatërvani i kryetarit, por duhet me u marrë se është zotu.

Veron Tara: Shumë është e vërtetë, unë thash personalisht mirrna më shumë se që është e nevojshme por po flas në aspektin ligjor s'kam kompetencë me leshu as reagim as rekomandim as hiç kurgjo.

Dafina Alishani: Pyetjet tjera unë kam me i parashtru në kuvend, por unë deshta me ditë për punën e pagesës qysh ka mbete te ju? Ta lash ujin në fyt!

Veron Tara: Jo kurgjo, punojna hala vullnetarisht.

Dafina Alishani: Hala vullnetarisht! E qaj vendimi që u ba edhe për rastin?

Antigona Bytyqi: S'janë tuj u zbatu, s'janë tuj u pagu. S'kemi përgjigje prej ministrive, thuhet që vetëm komitetet obligative paguhen.

Dafina Alishani: A këna marrë përgjigje për vendim?

Antigona Bytyqi: Jo, normal që e ka kaluar afatin për shqyrtim të ligjshmërisë, pothuajse si çdo vendim tjetër këto 3 muajt e fundit, jo s'kemi përgjigje.

Dafina Alishani: Masi s'kemi përgjigje a është heshtje administrative edhe vazhdon me vendimin.

Antigona Bytyqi: Po po, na e kemi publiku e krejt.

Dafina Alishani: Ani pse mos mi pagu?

Antigona Bytyqi: S'po paguhen se ministria s'po i paguan!

Kujtim Gashi: Ministria s'po i ekzekuton.

Dafina Alishani: Nëse s'kanë kthyer përgjigje vendimi është qashtu qysh është marrë.

Kujtim Gashi: Vendimi s'është kthy prej Ministrisë së Pushtetit Lokal hiç, as mirë as keq.

Dafina Alishani: Po bre, por edhe për tregun Fatoni s'ka kthy por ke vazhdu.

Kujtim Gashi: Mos dil prej temës në temë.

Dafina Alishani: Jo prej temës në temë, por këta nuk kanë pagë!

Kujtim Gashi: E di sepse edhe unë jam marrë me këtë.

Dafina Alishani: Po edhe?

Kujtim Gashi: Jam marrë bajagi si shumë edhe ministria dhe thesari nuk e ekzekuton sepse thotë vetëm 2 komitetet paguhen, pikë.

Dafina Alishani: Pse na shtinët me votu pra?

Kujtim Gashi: Sepse dashtëm me e bë një zgjidhje, përpjekje ishte për me bë zgjidhje. Nëse ka tjetër edhe atë përpjekje e bëjmë sepse unë e di sa i rëndësishëm ai këshill.

Antigona Bytyqi: Meqë u ndal edhe 50 eurshi, u munduam me bë një zgjidhje duke u bazuar në rregulloren e re që pat dalë, por nuk po e lejojnë ekzekutimin për pagesë. E din Veroni sa takime i kemi pasur, sa përpjekje.

Veron Tara: E kemi leshu ma, s'është që.

Kujtim Gashi: Ekzekutimin e pagesave e monitoron Ministria e Financave, ajo e ka kuletën.

Antigona Bytyqi: Ju faleminderit. Dikush tjetër për këtë pikë? Atëherë prezent jemi 7 anëtarë, po e hedhi në votim. Kush është për që ti rekomandohet mbledhjes? Unanimish, ju faleminderit. Kalojmë te pika e dhjetë.

Pika e dhjetë:

Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);

Antigona Bytyqi: Zonja Mybexhele, fjala për juve. Të lutem shkur meqë sot ja u dërgojmë materialin.

Karanfil Haxhillari: Më së miri na dërgon materialin.

Mybexhele Zhuri: Unë veç disa fjali deshta sa me ju njoftuar sepse po më vjen keq që ka ndodhë kështu.

Karanfil Haxhillari: S'paska shumë, nja 30 faqe.

Mybexhele Zhuri: Jo këto s'kam me I lexu sepse këtu është plani. Vetëm deshta me thënë se futja në rend të ditës për shqyrtim dhe miratim të Draft- planit lokal të veprimit për barazinë gjinore, është një domosdoshmëri për Komunën e Prizrenit, pasi që edhe kërkesa për të pasur një plan të tillë u miratua nga kryetari dhe tashmë është pjesë e kriterëve për vlerësimin e performances komunale nga MAPL-ja. Draft-plani është përgatitur me një metodologji në përputhje me kërkesat dhe standartet evropiane të gjithëpërfshirjes si dhe I ndjek hapat e domosdoshme në respektimin e legjislacionit kombëtar. Theksoj se komuna jonë është në ndërhyrjen e projektit GIF apo Qendër Infality facility, Uen Women, i cili zbatohet me fondet e Bashkimit Evropian së bashku me 17 komunat tjera. Kjo është fat sepse këto komuna kanë përfituar edhe janë si model të përgatitjes të një Draft-plani, ku hormanizohet dhe përafrohet me standartet ndërkombëtare dhe ato kombëtare. Ky process prej filimit është i përkrahur nga Agjensioni për Barazi Gjinore dhe MAPL-ja. Për mos me hy më tepër sepse me të vërtetë u lodhët të gjithë, sot unë vetëm do të ju them se pengesa ka qenë vetëm plani i veprimit për dhunë në familje edhe pse si objektin ne e kemi paraparë në këtë planin për barazi gjinore sepse ky plan është gjithëpërfshirës edhe bazohet në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, ku një prej fushave është edhe dhuna në familje. Mirëpo kjo nuk pengon aspak në draftimin e planit të mekanizmit komunal kundër dhunës. Edhe kostimi që është paraparë, mundet lirisht me kalu në atë plan, ose me u zgjeru me aktivitete tjera sepse faktikisht edhe ka një hendek në kostim i cili kemi mendu me u përmbush me fonde tjera, nga organizata tjera dhe aspak nuk ndikon në fuqinë e planit as të barazisë gjinore apo në planin kundër dhunës. Kështu që, në kuvend ndoshta vendosi a me e lënë atë objektiv, është objektivi numër 5, apo me ja lënë mekanizmit. Mekanizmi sipas meje është një rang më poshtë sesa plani komunal sepse ai përfshinë vetëm një fushë, fushën e cila trajton dhunën.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. A keni dikush diçka me shut?

Karanfil Haxhillari: E analizojmë edhe në kuvend i japim.

Antigona Bytyqi: Prezent jemi 7 anëtarë, kush është për që ti rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, ju faleminderit. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe shihemi pasnesër.

Përfundoi në ora: 12:19 minuta

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi Komunës së Prizrenit

Nr.001/011 -

Më: shtator 2024

Prizren

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1, 2, pika d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafit 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, nenit 27 paragrafit 1, të Statutit të Komunës Nr. 01/011-5643, dt.15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më shtator 2024, miratoi këtë:

PROPIZIM-V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
PËR PERIUdhËN 2024-2026

Neni 1

Miratohet Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore për periudhën 2024-2026, në Komunën e Prizrenit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi do të jetë, Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore për periudhën 2024-2026.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdesen: Kryetari i Komunës, drejtoritë dhe njësitë – sektorët tjerë të përfshira në këtë Plan.

Neni 4

Vendimi, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Municipality of Prizren - Prizren Belediyesi

PLANI LOKAL I VEPRIMIT
PËR
BARAZINË GJINORE

2024 - 2026

Maj 2024

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 u përgatit nga Komuna e Prizrenit me mbështetjen e UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Grupi Punues

1. Mybexhele Zhuri, Kryesuese
2. Kumrije Bytyqi, Anëtare
3. Nexhat Maçkaj, Anëtar
4. Veton Xhemaj, Anëtar
5. Jakup Kastrati, Anëtar
6. Emine Gashi, Anëtare
7. Haziz Krasniqi, Anëtar
8. Adelina Hoxha, Anëtare
9. Gjafer Ponik, Anëtar
10. Eleonora Fetollari, Anëtar
11. Fatlum Berisha, Anëtar
12. Eroll Shabani, EC Ma Ndryshe, Anëtar
13. Fisnik Minci, Gazetar Anëtar

Në përgatitjen e këtij plani ndihmuan edhe znj. Tringa Kasemi, Drejtore Ekzekutive, Qendra për Barazi dhe Drejtësi, dhe znj. Dhurata Prokshi, DEMOS.

Ekspertiza teknike nga UN Women / GEF:

Artan Binaku, Koordinator Projekti
Monika Kocaqi, Konsulente ndërkombëtare

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, z. Shaqir Totaj

Të nderuara/nderuar, bashkëqytetare e bashkëqytetarë!

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj një dokument tepër i rëndësishëm për Komunën tonë, që fuqizon themelet e ndërhyrjeve për Prizrenin tonë të dashur dhe fokusohet në një çështje tepër të rëndësishme për mbarë shoqërinë e për mua personalisht, siç është përparimi drejt barazisë gjinore.

Për barazinë gjinore flitet shumë dhe përparimi i legjislacionit e politikave të Kosovës në këtë drejtim vlen për t'u theksuar e përgëzuar. Komuna jonë, është përpjekur të zbatojë e bëjë realitet këto ligje e politika kombëtare, me qëllim që të mundësojë shërbime të barabarta e gjithëpërfshirëse, por edhe të trajtojë me respekt e dinjitet çdo qytetare e qytetar, që askush të mos mbetet pas. Prizreni, vatra e dijes dhe shkollimit shqiptar, nuk mund të mos hedhë hapat e duhur për të plotësuar nevojat e grupeve më të cenueshme dhe për të fuqizuar zërin e grave, të rejave e vajzave, në të gjitha fushat e jetës. Këtë qëllim e kam pjesë të punës sime, pasi mendoj se thelbi i mirëqeverisjes dhe bashkëqeverisjes është pikërisht identifikimi i nevojave të ndryshme të gjithsecilës dhe gjithsecilit në komunitet si dhe përdorimi me mençuri dhe drejtësi gjinore i të gjitha burimeve komunale, për t'i trajtuar me efektivitet këto nevoja.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 që ju po shfletoni tani, na shërben si mjet praktik i përmbushjes së qëllimit tonë të përbashkët, për Prizrenin e mundësive të barabarta për të gjitha/gjithë banoret e banorët e tij, si dhe për të gjitha/gjithë kalimtarët/kalimtarët, mikeshat/miqtë, e vizitoret/vizitorët, pavarësisht moshës, gjinisë e karakteristikave të tjera individuale. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan janë reflektim i nevojave të identifikuar nga zyrtaret/zyrtarët komunalë, por të para edhe nën dritën e përparësive të dokumenteve kombëtarë e ndërkombëtarë të rëndësishëm, veçanërisht të atyre dokumenteve që unifikojnë përvojat e komunave në mbarë Evropën, siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave e Burrave në Jetën Lokale.

Gjithashtu ky plan është rezultat i konsultimeve të gjera dhe gjithëpërfshirëse me institucionet publike dhe jo publike në nivel lokal. Falënderimet shkojnë për përfaqësueset dhe përfaqësuesit e këtyre institucioneve, organizatat e shoqërisë civile, të rejtat dhe të rinjtë, si dhe anëtarët e anëtarët e Kuvendit Komunal, të cilat/cilët u bënë pjesë e takimeve këshilluese në kuadër të hartimit të këtij plani dhe e miratuan pa hezitim atë. Falënderime të veçanta për UN Women Kosovë që na mbështeti me asistencë teknike përgjatë gjithë procesit, përmes Projektit "Gender Equality Facility" që zbatohet me fonde të Bashkimit Evropian.

Së fundmi, së bashku me falënderimet për zyrtaret dhe zyrtarët e komunës, për angazhimin dhe punën e palodhur për hartimin e këtij plani, dëshiroj të shpreh angazhimin tonë të përbashkët edhe për zbatimin e tij, duke vënë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, financiare, e infrastrukturore, për të përparuar me hapa të sigurt dhe të qëndrueshëm drejt arritjes së barazisë gjinore!

z. Shaqir Totaj
Kryetar i Komunës së Prizrenit

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE.....	5
I. HYRJE.....	6
II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE.....	8
III. METODOLOGJIA	10
IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE.....	12
V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2024 - 2026.....	15
VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	18
VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026	19

DRAFT

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ABGJ	Agjencia për Barazinë Gjinore
BDPFA	Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DA	Drejtoria e Administratës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DBZHR	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
DEF	Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave
DES	Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
DEZH	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
DGJK	Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastër
DI	Drejtoria e Inspektorateve
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DPMS	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë
DTZHE	Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
DUPH	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GG	Grupi Jo-Formal i Grave
KBGJ	Komiteti për Barazi Gjinore
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
NJDNJBGJ	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ON	Organizatë Ndërkombëtare
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore
PLVBGJ	Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SDG	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
ZBGJ	Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore
ZK	Zyra e Kryetarit

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 – 2026 u përgatit nga Komuna e Prizrenit, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore. të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritimit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin Jo Formal të Grave, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Prizrenit, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).¹

Siç përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale², njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave³, të reja dhe të rinjve⁴, vajzave dhe djemve.⁵

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifike për zbatimin e të cilave duhet

¹ Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

² Tekstin e Kartës mund ta gjeni në: <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>

³ “Gra dhe burra” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

⁴ “Të reja dhe të rinj” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 29 vjeç.

⁵ “Vajza dhe djem” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.

Siç përcaktohet edhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024 – 2026, misioni i Komunës së Prizrenit është: “Promovimi dhe ofrimi i zhvillimit dhe rritjes së mirëqenies së banoreve dhe banorëve të komunës, duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar shërbime sa më cilësore, në kohë dhe **të barabarta** për të gjitha / gjithë, si dhe **të ndjeshme për nevojat** e grave/të rejave/vajzave dhe burrave/të rinjve /djemve.”

Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, Komuna e Prizrenit, ka themeluar Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore dhe ka emëruar një Udhëheqëse të Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore e cila në mënyrë të përvitshme harton dhe zbaton një plan të veprimeve konkrete për përparimin drejt barazisë gjinore. Ky plan e ka gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga komuna dhe donatorë, përmes partneriteteve e bashkëpunimit. Po kështu, Komuna e Prizrenit po aplikon parimet e integritit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor përmes analizave gjinore të programeve të drejtorive të caktuara⁶, mbledhjes së të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, përcaktimit të treguesve të ndjeshëm gjinorë, etj.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtaura mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integritimin gjinor në politikën, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

PLVBGJ 2024 - 2026 është konceptuar dhe lidhur pikërisht me kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare, por mbështetet dhe merr frymëzim edhe nga dokumentet ndërkombëtarë të rëndësishëm, e synon të përafrohet me standardet dhe kërkesat e *acquis* të BE-së për barazinë gjinore. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan, janë hartuar duke pasur parasysh faktin që asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtareve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PLVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “**në të gjithë diversitetin e tyre**”.⁷ Përmes saj theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave (por edhe burrave, të rinjve e djemve) në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur, për shkak të seksit, moshës, zonës ku jetojnë, etnisë, aftësi të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, të qenit prind i vetëm, të qenit viktimë / e mbijetuar / i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore, apo formave të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statusit të migrantës / migrantit, azilkërkuësës / azilkërkuësit, apo për shkak të të qenit “person nën mbrojtje ndërkombëtare” (pra me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), me status “pa shtetësi”, etj.

⁶ Rol të rëndësishëm këtu ka luajtur edhe mbështetja e vazhdueshme e dhënë nga UN Women, sidomos në kuadër të Programit Rajonal: "Financimi transformues për Barazinë Gjinore drejt një Qeverisjeje më Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga SIDA dhe i zbatuar në Kosovë prej vitit 2020.

⁷ Në kuadër edhe të përafritimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore me Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore – EU GAP III.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PLVBGJ 2024 - 2026, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesore ku mbështeten hapat e planifikuar.

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikurse Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (njohur si CEDAW), Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, apo Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit), drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Ligji për Barazi Gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.⁸

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 i Komunës Prizren, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Kosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve,
- Deklarata dhe Platforma për Veprimin e Pekinit,
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje,
- Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë,
- Agjenda e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2030,
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020 - 2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021 - 2025,
- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

2. Korniza ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7, 21 dhe 22,
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040,
- Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020,
- Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26,

⁸ Shih PKBGJ, fq. 11

- Ligji Nr. 06/L-077 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen,
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr.05/L-021,
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154,
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212,
- Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore Nr. 08/L-185,
- Ligji Nr.04/l-81 Për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17,
- Ligji Nr.2011/04-L-096 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit të Skemës së Ndhimave Sociale Nr.2003/15,
- Ligji Nr. 03/L022 Për Mbështetje Materiale të Familjeve me Fëmijë me Aftësi të kufizuar Përhershme,
- Ligji Nr. 08/L-109 Për Kompensimin e Viktimave të Krimin,
- Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës,
- Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi,
- Ligji Nr. 06/L-026 Për Azil,
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 - 2024,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
- Programi i Reformave Ekonomike,
- Strategjia për Rregullim më të Mirë,
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore,
- Rregullorja për banim social,
- Plani i Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026, i Ministrisë së Shëndetësisë, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PLVBGJ 2024 - 2026 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuar sipas fushave të tyre.

Përgjegjëse kryesore për zbatimin e PLVBGJ mbetet **Komuna**. Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe aktorët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse komuna nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukturore që të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mundësi, duke përfshirë edhe OJQ, institucionet private, organizatat ndërkombëtare, etj. Udhëheqësja e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore do të mbetet përgjegjëse për një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara në PLVBGJ, por, tashmë ky është një plan i të gjithë komunës ndaj dhe përgjegjësia kryesore për këtë plan në tërësi jo domosdoshmërisht bie mbi ZBGJ. Gjithashtu, PLVBGJ 2024 - 2026, i zberthyer vit pas viti, zëvendëson edhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore që ZBGJ përgatiste dhe paraqiste përpara Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë të përvitshme.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin lokal luan edhe Grupi Jo Formal i Grave (GG), të cilat gjithashtu kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për hartimin e këtij Plani. Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ të cilat kanë dhënë kontribut gjatë hartimit të PLVBGJ përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PLVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PLVBGJ.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është:

- një mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishëm kombëtarë, por edhe ndërkombëtarë në lidhje me barazinë gjinore (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).
- një dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, me hapa të mirë përcaktuar, e në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat e ndeshura ndër vite nga Komuna, në përparimin drejt barazisë gjinore.
- një pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësi të domosdoshme për t'u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në Komunën e Prizrenit.

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PLVBGJ 2024 - 2026 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- ✓ **Ngritja e Grupit Punues për përgatitjen e këtij plani, me Vendim të Kryetarit të Komunës.** Grupi Punues për përgatitjen e këtij PLVBGJ u ngrit me Vendim të Kryetarit Nr.650/23 datë 09.10.2023 dhe kishte në përbërje të tij 11 (njëmbëdhjetë) zyrtarë / zyrtarë dhe 2 (dy) përfaqësues të shoqërisë civile, konkretisht:
 - Mybexhele Zhuri, Kryesuese
 - Kumrije Bytyqi, Anëtare
 - Nexhat Magkaj, Anëtar
 - Veton Xhemaj, Anëtar
 - Jakup Kastrati, Anëtar
 - Emine Curfri, Anëtare
 - Haziz Krasniqi, Anëtar
 - Adelina Hoxha, Anëtare
 - Gjafer Ponik, Anëtar
 - Eleonora Fetollari, Anëtar
 - Fatlum Berisha, Anëtar
 - Eroll Shabani, EC Ma Ndryshe, Anëtar
 - Fisnik Minci, Gazetar Anëtar
- ✓ **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues.** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues të komunës, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kornizës ligjore dhe të politikave ekzistuese kombëtare e lokale, të lidhura me çështjet gjinore.
- ✓ **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes,** të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2024 - 2026. Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, si vlerësimi i arritjeve dhe sfidave të komunës për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, identifikimi i prioritetëve bazuar në analizën e cekur më sipër, marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimet me stafin e komunës, etj.).
- ✓ **Konsultimet paraprake brenda komunës dhe hartimi i draft matricës së PLVBGJ.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e komunës si dhe në veçanti me anëtarët / anëtarët e Grupit Punues dhe me Grupin jo Formal të Grave. Që prej fillimit të këtyre konsultimeve u prezantuan instrumente kryesore të rëndësishme ndërkombëtare, sidomos ato të BE-së të lidhura me barazinë gjinore (si për shembull Plani i Veprimit i BE-së për Barazinë Gjinore / EU GAP III, apo Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.). Po kështu u prezantuan edhe prioritetet e cekura në dokumente të rëndësishme kombëtare si Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 - 2024, Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III, 2021 – 2025, etj. Më pas u kalua në përgatitjen e draft matricës së PLVBGJ-së, e cila përmbante objektivat strategjike, rezultatet e

prishme, dokumentet se ku referoheshin masat dhe veprimet e parashikuara, objektivat specifikë, treguesit në nivel objektiv, së bashku me vlerën bazë (e matur për vitin 2023 ose që do përcaktohet gjatë vitit 2024) dhe vlerën e synuar (target) deri në vitin 2026, rezultatin në nivel të objektivit specifik, si dhe aktivitetet, drejtorinë përgjegjëse për zbatim, partnerët dhe bashkëpunëtorët, afatin kohor, koston për tre vitet, burimin e financimit, treguesit për çdo aktivitet, si dhe përgjegjësit për monitorimin e zbatimit të PLVBGJ.

- ✓ **Postimi në faqen e Komunës për komente dhe sugjerime nga individët dhe grupet e interesit.** Draft PLVBGJ 2024 - 2026 u postua në datën xxxx 2024 në linkun xxxxxxxx Postimi qëndroi i hapur për komente dhe sugjerime deri në datën xxxx.2024, duke plotësuar kështu detyrimin për konsultimin publik, në mbështetje të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03L-040 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.
- ✓ **Mbajtja e konsultimit publik me banoret dhe banorët e Komunës.** Në përputhje dhe vijim të sa cekur më sipër, Komuna e Prizrenit, mbajti edhe sesionin e dëgjimit publik në datën xxx. 2024, në ora xxxx.
- ✓ **Përmirësimi i draft PLVBGJ.** Pas seancës së dëgjimit publik dhe në përfundim të të gjithë procesit të konsultimit publik, Grupi Punues bëri edhe përmirësimin e draft PLVBGJ, bazuar në të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra.
- ✓ **Kostimi i matricës së PLVBGJ.** Procesi i kostimit të matricës së PLVBGJ ishte një proces tepër i rëndësishëm që gjithashtu mori kohën e tij përgjatë përgatitjes së dokumentit të plotë. Kostimi u krye për secilin nga aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së dhe fondet u ndanë sipas burimit të financimit, konkretisht fonde të mbuluara nga komuna, me burime ekzistuese njerëzore, infrastrukturore apo financiare, fonde të mbuluara nga donatorët, por edhe fonde për gjetjen e të cilave duhet të bëhen rishikime dhe planifikime në buxhetet përkatëse të viteve të ardhshme, ose duhet të llobohet për t'i siguruar përmes bashkëpunimit me donatorët, subjektet private e OJQ-të (pra hendeku financiar).
- ✓ **Dorëzimi i dokumentit të plotë, të kostuar e përfunduar, për miratim në Kuvendin Komunal.** Pas përgatitjes dhe përfundimit të të gjithë procesit, dokumenti i plotë i PLVBGJ, edhe i kostuar, u dorëzua për miratim në Kuvendin Komunal, duke ndjekur të gjitha hapat, detyrimet dhe afatet ligjore përkatëse.
- ✓ **Miratimi i PLVBGJ në Kuvendin Komunal.** PLVBGJ u miratua në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal në xxx 2024.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë jo vetëm me detyrimet kombëtare, por edhe me metodologjinë e përgatitjes së PLVBGJ-ve siç sugjerohet nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).⁹

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PLVBGJ kanë luajtur organizatat e shoqërisë civile, si dhe mbështetja dhe asistencat teknike e ofruar nga UN Women Kosovë, përmes një ekipi të mirë përgatitur si dhe një konsulenteje¹⁰ të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të Projektit “Gender Equality Facility” (GEF) që financohet nga Bashkimi Evropian.

⁹ Për më shumë shikoni në: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

¹⁰ Znj. Monika Kocaqi, konsulente ndërkombëtare.

IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Vizioni i PLVBGJ-së adreson:

“Një qeverisje të mirë, gjithëpërfshirëse e të drejtë gjinore, ku gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Prizrenit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësi të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantëve/migrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të “personit nën mbrojtje ndërkombëtare” (me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), statusit “pa shtetësi”, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet¹¹ që udhëheqin zbatimin e PLVBGJ, mbështeten kryesisht në parimet që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, siç paraqiten në vijim:

- 1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.** Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë; ajo përfshin gjithashtu edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, të drejtpërdrejta apo të tërthorta.
- 2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.** Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore duhet të marrin parasysh dhe të trajtojnë – nga një këndvështrim gjithëpërfshirës, sistemik dhe strukturor – mënyrat se si ndërvepron gjinia me faktorë të tjerë si seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinionesh të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, origjina në lindje, aftësitë e kufizuara, mosha, ose orientimi seksual.
- 3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.** E drejta për barazi të grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, kërkon që organet vetëqeverisëse lokale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së balancuar në të gjitha sferat e vendimmarrjes.
- 4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.** Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të nxisin punën për eliminimin e stereotipeve dhe pengesave që krijojnë pabarazi në statusin dhe gjendjen e grave / të rejave / vajzave dhe që janë burimi i vlerësimit të pabarabartë të roleve të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve nga pikëpamja politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.
- 5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes lokale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.** Perspektiva gjinore duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullsisë lokale – për shembull përmes përdorimit të teknikave të “vlerësimeve gjinore”, “auditimit gjinor”, “integritimit gjinor”, dhe të “buxhetimit të përgjegjshëm gjinor”. Për arritjen e këtij synimi duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e shumta dhe të gjera të grupeve të ndryshme të grave në jetën lokale, si edhe kushtet e jetesës dhe të punës së tyre.
- 6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.** Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të hartojnë

¹¹ Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

plane dhe programe veprimi për barazinë gjinore, të mbështetura me burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

Objektivat strategjikë të PLVBGJ.

PLVBGJ 2024 - 2026 përbëhet nga pesë objektiva strategjike, të cilat janë harmonizuar edhe me:

- Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore,
- Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024,
- Planin e Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën të Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025,
- Konventën për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit),
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPfA),
- Agjendën 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030,
- Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III),
- Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

Pesë objektivat strategjike të PLVBGJ 2024 - 2026 të Komunës Prizren, renditen në vijim:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Secila nga këto objektiva strategjike është zbrërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit

Objektivi strategjik:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre

Rezultatet e pritshme:

- 1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar.
- 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.

Objektivat specifikë:

- 1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për lidhësi në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejtat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar

<p>normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.</p> <p>1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.</p>
<p>Treguesit në nivel objektiv:</p> <p>1.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.</p> <p>1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>2.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë.</p> <p>2.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.</p>
<p>Objektivi specifik:</p> <p>2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.</p>
<p>Treguesi në nivel objektiv:</p> <p>2.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>3.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitim të subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik, e përmirësuar ndjeshëm.</p> <p>3.b. Mbështetja e komunës me shërbime sociale cilësore e të ndjeshme gjinore, e rritur.</p>
<p>Objektivat specifike:</p> <p>3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.</p> <p>3.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.</p>
<p>Treguesit në nivel objektiv:</p> <p>3.1.a. Numri i grave / të rejave fermere e në ndërmarrësi, përfituese të granteve dhe subvencioneve të Komunës.</p> <p>3.2.a. Numri i banoreve/banorëve të komunës që përfitojnë nga shërbimet sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>4.a. Numri i grave, të rejave e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, të përfshira në arsim cilësor e në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, rritur ndjeshëm.</p> <p>4.b. Mundësitë e barabarta për angazhim dhe vlerësim të figurave të artit, kulturës e sportit, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat e djemtë, të përmirësuara.</p>
<p>Objektivat specifike:</p> <p>4.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.</p> <p>4.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.</p>
<p>Treguesit në nivel objektiv:</p>

4.1.a. Numri i vajzave, të rejave dhe grave nga të gjitha grupet, të përfshira në shërbime cilësore të arsimit dhe formimit profesional.

4.2.a. Numri i grave të rejave dhe vajzave që promovohen si modele të suksesshme në art, kulturë dhe sport.

Objektivi strategjik:

5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Rezultatet e pritshme:

5.a. Gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, janë agjentë të ndryshimit për një shoqëri të mundësive të barabarta e pa dhunë.

Objektivi specifik:

5.1. Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues në mbrojtje të viktimeve/të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore.

Tregues në nivel objektiv:

5.1.a. Numri i rasteve të menaxhuara me efektivitet e në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, nga anëtarët e Mekanizmit Koordinues në Prizren.

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ MAJ 2024 - 2026

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ 2024 - 2026 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Komuna (si me burimet ekzistuese njerëzore, financiare e infrastrukturore, ashtu edhe me burime që duhet të shtojë), kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Komuna e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra zyrtareve / zyrtarëve, të cilat/cilët aktualisht marrin një pagë fikse, sallave/ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin, etj.), në këtë Plan Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PLVBGJ nuk merr jetë, Komuna duhet të përfshijë në kornizën e parashikimeve buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në këtë PLVBGJ. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë Grupi Jo-Formal i Grave për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Komunës, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Lokal të Veprimit, **duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara**, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo KAB-et e Komunës, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së KAB-eve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PLVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PLVBGJ 2024 - 2026 janë në vlerën **3,263,065 EUR**. Nga këto:

- **243,765 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
- **136,315 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

- **2,203,300 EUR** (ku përfshihen grante dhe subvencione në total të parashikuara nga komuna) janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
- **616,740 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
- **62,945 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Në totalin e koston **3,263,065 EUR** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PLVBGJ 2024 - 2026 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tre vite):

- **3,105,428 EUR janë kosto që do të mbulohen nga Komuna** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra të cilat nuk kanë nevojë të përlogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukurore ekzistojnë. Këtu përfshihen edhe grante apo subvencionime të planifikuara për fusha të caktuara dhe për banoret dhe banorët në të gjithë diversitetin e tyre dhe vit pas viti do maten se sa kanë përfituar gratë, të rejtat dhe vajzat në veçanti.
- **28,353 EUR janë kosto që mbulohen nga donatorë** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PLVBGJ-së).
- **129,285 EUR (ose 4% e totalit të buxhetit të tre viteve) janë hendek financiar**, për të cilat komuna do të llojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në KAB-et e ardhshme, duke filluar nga KAB 2025 - 2027.

Objektivat strategjikë	Objektivat specifike	Gjithsej kosto për tre vjet	Komuna	Donatorë të konfirmuar	Hendek financiar
1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.	1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për leadership në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejtat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.	117,700 EUR	37,973 EUR	15,618 EUR	64,110 EUR
	1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.	126,065 EUR	71,890 EUR	11,235 EUR	42,940 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 1:		243,765 EUR	109,863 EUR	26,853 EUR	107,050 EUR
2. Promovimi i shëndetit dhe të	2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e	136,315 EUR	133,315 EUR	1,500 EUR	1,500 EUR

drejtave seksuale dhe riprodhuese.	vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.				
Gjithsej Objektiv strategjik 2:		136,315 EUR	133,315 EUR	1,500 EUR	1,500 EUR
3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të reja dhe grave.	3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të reja, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.	6,300 EUR	6,300 EUR	0 EUR	0 EUR
	3.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të reja, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.	2,197,000 EUR	2,191,000 ¹² EUR	0 EUR	6,000 EUR
Gjithsej Objektiv strategjik 3:		2,203,300 EUR	2,197,300 EUR	0 EUR	6,000 EUR
4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të reja, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.	4.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të reja dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.	613,800 EUR	613,800 ¹³ EUR	0 EUR	0 EUR
	4.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të reja dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.	2,940 EUR	1,380 EUR	0 EUR	1,560 EUR

¹² Këtu futen edhe subvencionet në total për të gjitha familjet skamnore. Ndarja sipas kryefamiljareve gra, do të bëhet në raportimet e përvitshme

¹³ Këtu përfshihen edhe bursat dhe investimet në total. Komuna do raportojë në mënyrë të përvitshme sa % e këtij buxheti shkon për gratë, të reja dhe vajzat.

Gjithsej Objektivi strategjik 4:		616,740 EUR	615,180 EUR	0 EUR	1,560 EUR
5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.	5.1. Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues në mbrojtje të viktimave/të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore.	62,945 EUR	49,770 EUR	0 EUR	13,175 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 5:		62,945 EUR	49,770 EUR	0 EUR	13,175 EUR

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit Lokal të Veprimit në vijim.

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit tek **Zyra e Kryetarit**.

Menjëherë pas miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, si hap i parë i zbatimit të tij, do të mblidhen të dhënat për vlerën bazë të treguesve në nivel të objektivave specifike. Po kështu do të hartohen edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. **Raportimet në bazë të objektivave specifike** do të përgatiten **dy herë në vit (çdo 6 muaj)** ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit.

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit **në nivel të objektivave** do të kryhet nga **Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)** dhe **Grupi Jo Formal i Grave (GG)** në nivel të **Kuvendit Komunal**. Raportet e përgatitura do të përcillen sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore apo në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Bazuar në monitorimin e kryer, **PLVBGJ duhet të rishikohet dhe përmirësohet** në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	1. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.								
Rezultatet e pritshme:	1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar. 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.								
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivi specifik 1.2, objektivi strategjik 3, objektivat specifike 3.1 dhe 3.2. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 1, objektivat specifike 3.2 dhe 3.7, fusha tematike 4, objektivat specifike 4.1, 4.2 dhe 4.4. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 7. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 7, 8 dhe 9. - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, target 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.a dhe 5.c, treguesit 5.1.1, 5.2.1, 5.2.2, 5.3.1, 5.4.1, 5.5.1, 5.5.2, 5.a.1, 5.a.2 dhe 5.c.1; SDG 16, target 16.7 dhe 16.b, treguesit 16.7.1, 16.7.2 dhe 16.b.1 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 4. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.								
Objektivi specifik:	1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për leadership në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.								
Treguesi			Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati				
1.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.			Do përcaktohet	Rritur me 10%	Më shumë vajza, të reja e gra, në të gjithë diversitetin e tyre, informohen e vetëdijesohen për të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.				
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2024	2025	2026			
1.1.1. Takime informuese me gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin	Grupi Jo-Formal i Grave (GG)	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe	2024 - 2026	1,220 € (komuna)	1,220 € (komuna)	1,220 € (komuna)	Zyra e Kryetarit (ZK)	- 6 takime të zhvilluara (2 në vit)	Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)

e tyre, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në Këshillat Lokale.		Barazinë Gjinore (NJDNJBGJ) Organizatat jo Qeveritare (OJQ) Organizatat Ndërkombëtare (ON)						- 240 gra të informuara (80 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	Grupi Jo Formal i Grave (GG)
1.1.2. Sesione informuese me nxënëset / nxënësit dhe studentet/studentët mbi pjesëmarrjen dhe lidhshpimin e barabartë gjinor, si dhe për çështje të tjera të fuqizimit të gruas e barazisë gjinore, në shkollat e komunës.	Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)	NJDNJBGJ Shkollat OJQ ON	2024 - 2026	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	DKA Donatorët ¹⁴	33 sesione të zhvilluara (9 sesione në shkollat dhe 2 sesione në universitet, në vit) - 825 persona të informuar (275 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	KBGJ GG
1.1.3. Sesione informuese /trajnuese mbi barazinë gjinore dhe rëndësinë e integritimit gjinor në politikat lokale, për Grupin Jo Formal të Grave.	Kuvendi Komunal	NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 220 € donatori)	ZK Donatorët ¹⁵	- 6 sesione të zhvilluara (2 në vit)	KBGJ GG

¹⁴ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

¹⁵ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe DEMOS

				220 € donatori)	220 € donatori)			- 10 asambleiste të informuara, ndarë sipas moshës, pozitës, partisë politike, etj.	
1.1.4. Aktivitete sensibilizuese në kuadër të “Javës së Gruas” (8 Mars).	NJDNJBGJ	GG OJQ ON	2024 - 2026	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	ZK Donatorët ¹⁶	- 15 aktivitete të zhvilluara (5 në vit) - 300 persona të informuar (100 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.5. Aktivitete vetëdijesuese për shënimin e ditës (ditëve) ndërkombëtare të vajzave ¹⁷ .	NJDNJBGJ	DKA GG OJQ ON	2024 - 2026	2,060 € (nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	2,060 € (nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	2,060 € (nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	ZK Donatorët ¹⁸	- 6 aktivitete të zhvilluara (2 në vit) - 300 persona të informuar (100 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG

¹⁶ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

¹⁷ Data **11 tetor** është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara si Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Vajza, për të njohur të drejtat e vajzave dhe sfidat unike me të cilat përballen vajzat në mbarë botën (miratuar me Rezolutën 66/170, datë 19 dhjetor 2011). Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Vajza fokuson vëmendjen në nevojën për të adresuar sfidat me të cilat përballen vajzat dhe për të promovuar fuqizimin e vajzave dhe përmbushjen e të drejtave të tyre njerëzore. Për më shumë shih: <https://www.un.org/en/observances/girl-child-day> Ditë të tjera ndërkombëtare të lidhura me fëmijët (pra vajza dhe djem), si dhe me të rejtat e të rinjtë, janë: 12 qershori – Dita botërore kundër punës së fëmijëve, 12 gushti – Dita ndërkombëtare e rinisë, 20 nëntori – Dita botërore e fëmijëve; në prill (data ndryshon çdo vit, nga 22-28 prill) – dita ndërkombëtare e vajzave në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, etj. Për më shumë shih kalendarin e ditëve ndërkombëtare në: <https://www.un.org/en/observances/list-days-weeks>

¹⁸ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

1.1.6. Takime vetëdijesuese për ndërgjegjësimin e prindërve (nëna dhe baballarë), si dhe të vajzave e djemve, për parandalimin e martesave të hershme.	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (DPMS)	NJDNJBGJ DKA OJQ ON	2024 - 2026	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendek financiar)	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendek financiar)	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendek financiar)	ZK Donatorët	- 6 takime të zhvilluara (3 në vit) - 135 persona të informuar (45 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.7. Promovimi i rolit të rëndësishëm të grave në proceset zhvillimore të shoqërisë duke evidentuar modelet pozitive të grave në vendimmarrjen politike e publike.	GG	NJDNJBGJ DKA Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik (DTZHE) OJQ ON	2024 - 2026	830 € (komuna)	830 € (komuna)	830 € (komuna)	ZK Donatorët	- 6 takime promovuese të zhvilluara (2 në vit). -180 persona të informuar (60 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, aftësive, etj. - Numri i modeleve të grave në vendimmarrje të promovuara çdo vit	KBGJ GG
1.1.8. Publikimi i revistës “Barazia Gjinore në Fokus”.	Drejtoria e Administratës (DA)	NJDNJBGJ Të gjitha drejtoritë komunale	2025 - 2026	/	31,650 € (nga të cilat 450 € komuna dhe 31,200 €	31,650 € (nga të cilat 450 € komuna dhe 31,200 € hendek financiar ²⁰)	ZK Donatorët	- Revista “Barazia Gjinore në Fokus” e publikuar dhe shpërndarë çdo	KBGJ GG

²⁰Njëlloj si më sipër

		GG OJQ ON			hendek financiar ¹⁹⁾			2 muaj (nga 500 copë për çdo botim)	
1.1.9. Takime me të punësuarat/punësuarit në institucione lokale dhe diskutimi mbi rëndësinë e njohjes dhe raportimit të ngacmimeve seksuale në vendin e punës.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	ZK Donatorët ²¹⁾	- 42 takime të zhvilluara (14 në vit) - 420 persona të informuar (140 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.10. Hartimi dhe miratimi i një politike komunale kundër ngacmimit seksual në vendin e punës.	DA	Zyra Ligjore (ZL) NJDNJBGJ GG OJQ ON	2024	7,875 € (nga të cilat 5,300 € komuna dhe 2,575 € donatori)	/	/	DA Donatorët ²²⁾	- Politika e hartuar dhe miratuar	KBGJ GG
1.1.11. Fillimi i punës për ngritjen e Muzeut të Nënë Terezës.	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS)	DTZHE DA ON	2025 - 2026	/	Do përlogaritet varësisht hapave që do hidhen gjatë vitit	Do përlogaritet varësisht hapave që do hidhen gjatë vitit	DKRS Donatorët	- Procedurat për ngritjen e Muzeut të përfunduara së bashku me	KBGJ GG

¹⁹⁾ Organizatat Jo Qeveritare janë angazhuar se do të mbështetin komunën për të mbuluar këtë hendek financiar

²¹⁾ Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

²²⁾ Për këtë aktivitet do të kontribuojë Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren si dhe UN Women

								studimin e fizibilitetit; - Puna për ngritjen e muzeut e filluar	
1.1.12. Miratimi i masave të veçanta ²³ që sigurojnë barazi gjinore në praktikë, në pozitat vendimmarrëse të ekzekutivit komunal, për shtimin e zyrtareve gra / të reja në të gjitha drejtoritë komunale sipas nevojës.	DA	ZL NJDNJBGJ GG OJQ ON	2024	2,650 € (nga të cilat 2,050 € komuna dhe 600 € hendek financiar)	/	/	DA	- Masat e hartuara dhe miratuara	KBGJ GG

Objektivi specifik:

1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Treguesi	Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati
1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.	Do përcaktohet	Rritur me 6%	Komuna do të hedhë hapa konkretë për integrimin gjinor në të gjithë fushat e veprimtarisë së saj, që do të realizohen duke përdorur si mjet kryesor buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2024	2025	2026			
1.2.1. Takime koordinuese me institucionet lokale, OJQ dhe ON për zbatimin e PLVBGJ.	NJDNJBGJ	Drejtoritë komunale përgjegjëse për	2024 - 2026	365 € (komuna)	365 € (komuna)	365 € (komuna)	ZK Donatorët	- 3 takime të zhvilluara (1 në vit)	KBGJ GG

²³ Vendosja e poenteve, sistemit të kuotave apo zbatimi i masave të tjera të përcaktuara në Ligjin 05/L -020 "Për Barazi Gjinore", që mundësojnë pjesëmarrjen e barabartë gjinore në Këshillat Lokalë, në përzgjedhjen dhe punësimin e zyrtareve/zyrtarëve në pozitat vendimmarrëse në komunë, institucionet lokale publike (shkolla, shëndetësi, etj.), si dhe gjatë plotësimit të vendeve në drejtoritë përkatëse komunale me zyrtare gra / të reja.

		zbatimin e PLVBGJ						- 60 persona të përfshirë (20 në vit), ndarë sipas seksit, institucionit, etj - Plani i punës i koordinuar për zbatimin e PLVBGJ i përgatitur çdo vit	
1.2.2. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për integrimin gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike në nivel lokal.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna, 1,030 € donatori dhe 1,030 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	ZK Donatorët ²⁴	- 6 trajnime të zhvilluara (2 në vit). - 90 persona të trajnuar (30 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG
1.2.3. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna, 1,030 € donatori dhe 1,030 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	ZK Donatorët ²⁵	- 6 trajnime të zhvilluara (2 në vit). - 90 persona të trajnuar (30 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG

²⁴Për të realizuar këto trajnime do ofrojë mbështetje edhe UN Women.

²⁵Për të realizuar këto trajnime do ofrojë mbështetje edhe UN Women.

1.2.4. Aplikimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) nga drejtoritë e komunës.	Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave (DEF)	Drejtoritë komunale OJQ ON	2024 - 2026	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	DEF Donatorët ²⁶	- Numri i programeve buxhetore të analizuara nga këndvështrimi gjinor dhe ku aplikohet BPGJ	KBGJ GG
1.2.5. Takime informuese me gra / të reja / vajza dhe burra/të rinj/djem, në të gjithë diversitetin e tyre, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjimet publike në përgjithësi, e veçanërisht në dëgjimet buxhetore.	Të gjitha drejtoritë komunale që organizojnë dëgjime publike	DEF NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	Drejtoritë komunale Donatorët ²⁷	- 30 takime të zhvilluara (10 në vit) - 300 persona të informuar informuara (100 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, aftësive, etj.	KBGJ GG
1.2.6. Përgatitja e formave të unifikuara ²⁸ për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera individuale, si dhe publikimin e informacioneve, për të gjitha aktivitetet që organizon komuna.	DA	NJDNJBGJ Zyra e Informimit (ZI) OJQ	2024	2,050 € (nga të cilat 1,050 € komuna dhe 1,000 € donatori ²⁹)	/	/	DA	- Format e përgatitura - Të dhënat që mblidhen të ndara, bazuar në plotësimin e tyre.	KBGJ GG

²⁶ UN Women dhe DEMOS mund të ofrojnë mbështetje për këtë aktivitet

²⁷ UN Women dhe DEMOS mund të ofrojnë mbështetje për këtë aktivitet

²⁸ Këtu bëhet fjalë për unifikimin e mbledhjes së të dhënave për pjesëmarrësit / pjesëmarrësit në të gjitha aktivitetet që zhvillon komuna, pavarësisht drejtorisë e fushës përkatëse. Pra do përgatitet një tabelë (p.sh. në Excel) me të gjithë specifikimet që duhet të përmbajnë të dhënat (si p.sh. numri i pjesëmarrësve / pjesëmarrësve, seksi, moshë, etnia, aftësia e kufizuar, vendbanimi... etj.) dhe në bazë të saj do unifikohen edhe listat e pjesëmarrjes që duhet të plotësohen në çdo aktivitet. Ngjashmërisht, do përgatitet një fletë me udhëzime për mënyrën se si do të përgatitet informacioni për publikim në faqen e internetit të komunës, të zbatimit të aktiviteteve përkatëse në këtë PLVBGJ.

²⁹ Për zbatimin e këtij aktiviteti do të ofrojnë mbështetje edhe DEMOS dhe UN Women

		ON							
1.2.7. Mbledhja e të dhënave bazë për të gjithë treguesit në nivel objektiv specifik, të përcaktuar për matjen e progresit të këtij PLVBGJ.	Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	NJDNJBGJ OJQ ON	2024	400 € (komuna)	/	/	Drejtoritë komunale	- Tabela me të dhëna të plotësuara të vlerës bazë për secilin tregues të objektivave specifike	KBGJ GG
1.2.8. Shtimi në faqen zyrtare të internetit të Komunës, i një vegëze me informacione dedikuar çështjeve të Barazisë Gjinore dhe përditësimi rregullisht i saj.	Njësia e Komunikimit me Publikun (NJKP)	NJDNJBGJ Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	2024 - 2026	2,475 € (komuna)	2,700 € (komuna)	2,700 € (komuna)	NJKP Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	- Vegëza e shtuar. -Informacioni i përditësuar rregullisht.	KBGJ GG
1.2.9. Publikimi i gjetjeve nga monitorimi i zbatimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore.	NJKP	NJDNJBGJ Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	2024 - 2026	2,300 € (komuna)	2,300 € (komuna)	2,300 € (komuna)	NJKP Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	- Gjetjet e publikuara në mënyrë të përvitshme, bazuar në raportin e plotë të monitorimit të zbatimit të PLVBGJ	KBGJ GG
1.2.10. Fuqizimi i NJDNJBGJ (shtim i dy zyrtareve/zyrtarëve me kohë të plotë dedikuar BGJ)	Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ)	ZK	2025 - 2026	/	13,320 € (hendek financiar) ³⁰	13,320 € (hendek financiar) ³¹	ZBNJ	- Dy zyrtare/zyrtarë me kohë të plotë dedikuar çështjeve të BGJ të shtuar në strukturë	KBGJ GG

³⁰ Komuna duhet ta planifikojë këtë shtim të dy zyrtareve në KAB 2025-2027

³¹ Njëlloj si më sipër

1.2.11. Trajnimi i zyrtareve/zyrtarëve komunalë për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore, gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese.	NJDNJBGJ	ABGJ OJQ ON	2024 - 2026	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendek financiar)	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendek financiar)	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendek financiar)	ZK Donatorët	- 3 trajnime të realizuara (1 në vit) -60 persona të trajnuar (20 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG
1.2.12. Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumentet dhe politikat e komunës.	Të gjitha drejtoritë përgjegjëse	NJKP NJDNJBGJ	2024 - 2026	9,240 € (komuna)	18,480 € (komuna)	18,480 € (komuna)	Drejtoritë komunale	- Dokumentet dhe publikimet e komunës përgatiten me gjuhë të ndjeshme gjinore	KBGJ GG
1.2.13. Sesione informuese mbi raportimin e ndjeshëm gjinor.	ZI	NJDNJBGJ OJQ Mediat lokale ON	2024 - 2026	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendek financiar)	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendek financiar)	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendek financiar)	Drejtoritë komunale	- 3 sesione të zhvilluara (1 në vit) - 30 persona të informuar (10 në vit)	KBGJ GG

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 2. PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE SEKSUALE DHE RIPODHUESE.

Rezultatet e pritshme:

- 2.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë.
2.b. Vendimarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.

Referenca në dokumentet kryesore:

- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 2,4, 5, 6, 11 dhe 12.
- Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 2, objektivi specifik 2.3.
- Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 2, objektivat specifike 2.1 dhe 2.2.
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 12.
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6.
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fusha kritike 3

	- Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 3, target 3.7 dhe 3.8, treguesit 3.7.1 dhe 3.8.1; SDG 5, target 5.6, treguesi 5.6.1 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fushat tematike 2 dhe 3. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 6, 10, 14, 34 dhe 37.								
Objektivi specifik:	2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.								
Treguesi			Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati				
2.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.			Do përcaktohet	Rritur me 6%	Më shumë informacion mbi të drejtat dhe shëndetin, si dhe shëndetin seksual e riprodhues, veçanërisht tek gratë, të rejtat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.				
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ institucionet mbështetëse		2024	2025	2026			
2.1.1. Sesione informuese me gratë, të rejtat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë, mbi të drejtat e tyre dhe kujdesin për shëndetin seksual e riprodhues.	Drejtoria e Shëndetësisë (DSH)	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) DKA OJQ ON	2024 - 2026	1,440 € (komuna)	1,440 € (komuna)	1,440 € (komuna)	DSH Donatorët	- 6 takime të zhvilluara (2 në vit) - 120 persona të informuar (40 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
2.1.2. Aktivitete informuese në kuadër të fushatës “Tetori rozë”.	DSH	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) QKMF	2024 - 2026	1,120 € (nga të cilat 620 € komuna dhe 500 € donatori)	1,120 € (nga të cilat 620 € komuna dhe 500 € donatori)	1,120 € (nga të cilat 620 € komuna dhe 500 € donatori)	DSH Donatorët	- 9 takime të zhvilluara (3 në vit) - Numri i persona të informuar (në	KBGJ GG

		NJDNJBGJ OJQ ON						vit) ndarë sipas moshës, etnisë, etj.	
2.1.3. Vazhdimi i kujdesit për nënat dhe foshnjat përmes vizitave në familje.	DSH	QKMF	2024 - 2026	40,000 € (komuna)	40,000 € (komuna)	40,000 € (komuna)	DSH	- 12000 vizita të zhvilluara (4000 në vit)	KBGJ GG
2.1.4. Aktivitete informuese për kancerin e qafës së mitrës, sidomos me gratë dhe të rejtat në zonat rurale.	DSH	QKMF OJQ ON	2024 - 2026	1,580 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 500 € hendek financiar)	1,580 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 500 € hendek financiar)	1,580 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 500 € hendek financiar)	DSH Donatorët	- 12 sesione të zhvilluara (4 në vit) - 120 gra të informuara (40 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
2.1.5. Sesione informuese me prindërit (nëna dhe baballarë) dhe vajzat për rëndësinë e kryerjes së vaksinës kundër HPV	DSH	QKMF OJQ ON	2024 - 2026	690 € (komuna)	690 € (komuna)	690 € (komuna)	DSH Donatorët	- 6 sesione të zhvilluara (2 në vit) - 150 persona të informuar (50 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
2.1.6. Kryerja e mamografisë falas për gratë dhe të rejtat, përgjatë gjithë vitit	DSH	QKMF	2024 - 2026	1,250 € (komuna)	1,250 € (komuna)	1,250 € (komuna)	DSH	- Numri i mamografive të kryera çdo vit falas (250 në vit)	KBGJ GG

2.1.7. Avokimi për sponsorizimin dhe shpërndarjen e pecetave higjienike falas në shkolla.	DSH DPMS	OJQ ON	2024 - 2026	235 € (komuna)	Do përllorarit	Do përllorarit	DSH Donatorët	- 1 takim me 15 persona për të avokuar për këtë qëllim (2024). - Shpërndarja të mundësohet nga bashkëpunimi me biznese dhe OJQ e ON (2025 dhe 2026)	KBGJ GG
2.1.8. Mbështetja financiare për të sëmurat/sëmurët me sëmundje malinje.	DSH	ZK	2024 - 2026	Përllorarit në bazë të kërkesave dhe mbulohet kosto 400 € për person.	Përllorarit në bazë të kërkesave dhe mbulohet kosto 400 € për person.	Përllorarit në bazë të kërkesave dhe mbulohet kosto 400 € për person.	DSH	- Numri i personave që kanë nevojë për mbështetje çdo vit ³² (400 euro për person)	KBGJ GG
OBJEKTIVI STRATEGJIK:	3. PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE.								
Rezultatet e pritshme:	3.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik, e përmirësuar ndjeshëm. 3.b. Mbështetja e komunës me shërbime sociale cilësore e të ndjeshme gjinore, e rritur.								
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12, 15, 16, 17 dhe 18. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivat specifike 1.1 dhe 1.2. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 3, objektivi specifikë 2, 3, 4, 5 dhe 6. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5, 11, 13 dhe 14. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6.								

³² Komuna do përllorarisë dhe raportoje çdo vit numrin e personave që u është mbuluar kjo pagesë, duke bërë ndarjen e të dhënave sipas seksit, moshës, etnisë, etj.

	<ul style="list-style-type: none"> - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 1 dhe 6 - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, targets 5.1, 5.4 dhe 5.a, treguesit, 5.1.1, 5.4.1 dhe 5.a.1, SDG 8, targets 8.5 dhe 8.6, treguesit 8.5.2 dhe 8.6.1. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 3. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 10, 11, 15, 18, 27, 31, 34 dhe 35. 								
Objektivi specifik:	3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.								
Treguesi		Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati					
3.1.a. Numri i grave / të rejave fermere e në ndërmarrësi, përfituese të granteve dhe subvencioneve të Komunës		Do përcaktohet	Rritur me 10%	Më shumë gra e të reja të angazhuara si fermere e në ndërmarrësi do të kenë qasje në informacione burime dhe do të përfitojnë nga grantet dhe subvencionet e komunës.					
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ institucionet mbështetëse		2024	2025	2026			
3.1.1. Takime informuese për grantet dhe subvencionet që ndan komuna ose ministrinë e linjës, me qëllim shtimin e interesit për aplikim tek gratë dhe të rejat.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (DBZHR) DTZHE	NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	500 € (komuna)	500 € (komuna)	500 € (komuna)	DBZHR DTZHE Donatorët	- 6 takime të zhvilluara (2 në vit) - 6 persona të informuar (2 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
3.1.2. Subvencionimi i fermereve dhe fermerëve (sipas prioriteteve të DBZHR), duke synuar nxitjen e fermereve gra / të reja të merren me këtë veprimtari.	DBZHR	OJQ ON	2024 - 2026	700 € (komuna)	700 € (komuna)	700 € (komuna)	DBZHR Donatorët	- 42 fermere gra të subvencionuara (14 në vit), ndarë sipas zonës, llojit të aktivitetit, etj.	KBGJ GG

3.1.3. Mbështetja e fermerëve gra me pajisje/mekanizëm bujqësor.	DBZHR	OJQ ON	2024 - 2026	600 € (komuna)	600 € (komuna)	600 € (komuna)	DBZHR Donatorët	- 6 fermerë gra të mbështetura me pajisje/mekanizëm bujqësor (2 në vit)	KBGJ GG
3.1.4. Aftësimi i grave dhe vajzave fermere në fushën e digjitalizimit me qëllim të lehtësimit të promovimit dhe shitjes së produkteve bujqësore përmes platformave online. ³³	DTI DBZHR	OJQ ON	2024 - 2026	300 € (komuna)	300 € (komuna)	300 € (komuna)	DBZHR Donatorët	- 3 punëtori të zhvilluara (1 në vit) - Numri i grave të aftësuara (në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
3.1.5. Subvencionimi me mjete monetare, i bizneseve në pronësi të grave/të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre.	DTZHE	OJQ ON	2024 - 2026	€	€	€	DTZHE Donatorët	- Numri i bizneseve të grave të subvencionuara në vit	KBGJ GG
3.1.6. Prezantimi i produkteve lokale të përgatitura nga gratë / të rejtat dhe burrat / të rinjtë në të gjithë diversitetin e tyre, në panairë lokale, duke respektuar parimet e barazisë gjinore.	DTZHE DBZHR	OJQ ON	2024 - 2026	€	€	€	DTZHE DBZHR Donatorët	- x panairë lokale të zhvilluara (x në vit) - Numri i produkteve lokale të grave, të prezantuara çdo vit	KBGJ GG
Testit iu kanë nënshtror **1926 maturantë dhe atë 1690 maturantë të komunitetit shqiptarë, 128 maturantë të komunitetit boshnjak dhe 108 maturantë të komunitetit turk.** Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër Qendra të Testimit dhe **63 administruesit** e Provimit të Maturës Shtetërore nga shkollat e komunës sonë kanë administruar Testin e Maturës Shtetërore në komunat e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.

Në të gjitha Qendrat e Testimit procesi ka shkuar në nivel të mirë, përjashtimisht në disa qendra testimi ka filluar me vonesë, për shkak të vonesës së komisioneve dhe testeve nga MASHTI.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN
REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE Afati
Qershor 2024

Rezultati i Maturës Afati_qershor 2024		Nxënësit që kanë hy në test		Nxënës që kaluan testin			Përqindja kalueshmërisë (mbi 40% e pragut)		Rezultati në përqindje e shkollës
N r.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej		
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	134	211	345	131	203	334	96.81	74.83
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	87	197	284	71	131	202	71.13	45.13
3	SHMM "Luciano Motroni"	91	289	380	82	250	332	87.37	54.24
4	SHME "Ymer Prizreni"	101	92	193	69	37	106	54.92	40.85
5	SHMM "Lorenc Antoni"	15	15	30	10	12	22	73.33	47.60

6	Qendra Kompetencës e	17	23	40	13	12	25	62.50	41.28
7	SHMT "11 Marsi"	223	117	340	155	71	226	66.47	54.37
8	Medreseja "Alauddin"	12	34	46	11	25	36	78.26	49.57
9	"Loyola" Gymnazium	49	59	108	49	59	108	100.00	73.27
10	College "Mehmet Akif"	18	28	46	16	23	39	84.78	68.82
11	Maarif School International	16	20	36	13	18	31	86.11	52.83
12	Q.B. "Nënë Tereza"	2	1	3	1	0	1	33.33	37.33
	Gjithsej	765	1086	1851	621	841	1462	78.98	53.34
					81.18	77.44	78.98		
					%meshkuj	%femra			

ORGANIZIMI DHE MBAJTJA E MATURËS SHETETËRORE AFATI GUSHTIT 2024

Në bazë të Ligjit mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018, UA 04/2016 dhe UA 05/2016 Detyrat dhe përgjegjësit e administrueseve dhe komisioneve të qendrave të testimit, Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me nr. 01B-039 të datës 17.04.2024, njoftimit të DVSM në MASHTI për mënyrën e paraqitjes së provimit të maturës përmes platformës e-Kosova, DKA në Prizren ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative për mbajtjen e Maturës Shtetërore 2024, që mbahet më 31 gusht 2024 (afati dytë).

Sipas udhëzimeve të DVSM në MASHTI, prej DKA është kërkuar të caktohen koordinatorët e shkollave për Maturën Shtetërore, ku pastaj nxënësit individualisht pasi janë regjistruar në platformën e-Kosova, kanë paraqitur provimin e maturës, dhe DVSM ka shpërndarë listën e nxënësve të të gjitha shkollave nëpër qendrat e ndryshme të testimit. Përmes platformës e-Kosova nxënësit paraqesin provimin e maturës, ku nga raportet e

shkollave kemi pranuar edhe 430 maturantë nga të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Prizrenit, të cilët do ti nënshtrohen provimit të maturës shtetërore më 31 gusht 2024, ndërsa nga sistemi e-Kosova kanë paraqitur provimin 365 nxënës.

Nga listat e nxënësve që kanë paraqit provimin e maturës, një numër i vogël i nxënësve nuk kan hy në test.

Nga DVSM në MASHTI janë caktuar tri qendra të testimit, ku janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbarëvajtje më të mirë të provimit të maturës shtetërore për afatin e gushtit.

Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër qendra të testimit dhe 19 administruesit e provimit të maturës shtetërore nga shkollat e komunës sonë që administrojnë testin e maturës shtetërore në Komunitet e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.

Janë bërë kërkesë Policisë së Kosovës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë për mbështetje në ditën e provimit të maturës shtetërore. Një nxënëse Fatjona Hoxha (me kod MS-2421065) është larguar nga Qendta e Testimit për shkak që është nxënëse duke përdorur telefonin.

Në të gjitha Qendrat e Testimit procesi ka shkuar në nivel të mirë, si në aspektin e sigurisë dhe të procedurave tjera sipas UA të MASHTI-t dhe ligjit të maturës shtetërore, ku përveç komisioneve dhe administruesve, testin e kanë monitorue edhe monitorues student nga UP.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE gusht 2024

Rezultati i Maturës Afati_gushtit 2024		Nxënësit që kanë hy në test			Nxënës që kaluan testin			Përqindja e kalueshmërisë (mbi 40% e pragut)	Rezultati në përqindje e shkollës
Nr .	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej		
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	7	11	18	6	10	16	88.89	47.53
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	18	49	67	10	29	39	58.21	42.16
3	SHMM "Luciano Motroni"	9	40	49	7	30	37	75.51	47.08

4	SHME "Ymer Prizreni"	30	27	57	16	18	34	59.65	40.50
5	SHMM "Lorenc Antoni"	3	3	6	2	2	4	66.67	41.33
6	Qendra e Kompetencës	3	6	9	2	4	6	66.67	46.56
7	SHMT "11 Marsi"	58	30	88	36	19	55	62.50	41.89
8	Medreseja "Alauddin"	5	10	15	4	3	7	46.67	40.87
9	"Loyola" Gimnazium	0	0	0	0	0	0	#DIV/0!	
10	College "Mehmet Akif"	2	5	7	2	4	6	85.71	50.00
11	Maarif School International	4	1	5	3	1	4	80.00	45.40
12	Q.B. "Nënë Tereza"	1	1	2	1	0	1	50.00	44.50
	Gjithsej	140	183	323	89	120	209	64.71	44.35

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

REZULTATI FINAL I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE 2024 PËR DY AFATET

Rezultati i Maturës - Dy Afate 2024		Nxënësit që kanë hy në test			Nxënës që kaluan testin			Përqindja e kalueshmërisë	Rezultati në përqindje e shkollës
N r.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej		
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	134	211	345	135	211	346	100.29	50.26
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	87	197	284	81	160	241	84.86	42.16
3	SHMM "Luciano Motroni"	91	283	374	89	274	363	97.06	47.08
4	SHME "Ymer Prizreni"	101	92	193	85	55	140	72.54	40.50
5	SHMM "Lorenc Antoni"	15	15	30	12	14	26	86.67	41.33
6	Qendra e Kompetencës	17	23	40	15	16	31	77.50	46.56
7	SHMT "11 Marsi"	222	115	337	190	88	278	82.49	41.89
8	Medreseja "Alauddin"	12	34	46	15	28	43	93.48	40.87
9	"Loyola" Ginnazium	49	59	108	49	59	108	100.00	73.27
10	College "Mehmet Akif"	18	28	46	18	27	45	97.83	50.00

1	Maarif School								
1	International	16	20	36	16	19	35	97.22	45.40
1	Q.B. "Nënë								
2	Tereza"	2	1	3	2	0	2	66.67	44.35
	Gjithsej	764	1078	1842	707	951	1658	90.01	46.97
					92.54	88.22	90.01		
					Meshkuj	Femra			
					%	%			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit (KPZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Prizrenit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Pagesa e plotë për furnizim me lëndë djegëse.
- A2 Mos përfshirja e elementeve përkatëse në kushtet e kontratës me përfituesit.
- A3 Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit.
- A4 Mos përfshirja e vendimeve në e-prokurim për pagesat për inflacion.
- A5 Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare.
- A6 Mungesa e projektit ekzekutiv.
- B1 Vonesa në pagesën e faturave.
- B2 Vonesa në realizimin e projekteve kapitale.
- B3 Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PVF-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e pasurive, të hyrave, llogarive të arkëtushme, subvencioneve, ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Bazuar në të dhënat e Thesarit, shuma totale e pagesave të realizuara në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore është 810,436€ nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si rezultat i mos zbatimi të kontratës kolektive.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesa e plotë për furnizim me lëndë djegëse

Gjetja Rregullorja për shpenzimet e parave publike Nr.01/2013, neni 23 përcakton se; pranimi i mallit/shërbimit bëhet nga zyrtari/ komisioni i autorizuar. Përveç kësaj, kushtet e kontratës përcaktojnë se pagesat do të bëhen në bazë të furnizimeve të cilat ofrohen nga operatori ekonomik dhe aprovohen nga organi mbikëqyrës.

Më datë 23.02.2022 është lidhur kontrate me OE në shumë prej 56,550€, për projektin “Furnizimi me dru për ngrohje për rastet sociale”. Më datën 06.04.2023, komisioni në bazë të faturës së pranuar, ka konstatuar se furnizimi me dru është pranuar si në sasi ashtu edhe në cilësi sipas kushteve të kontratës. Sipas dokumentacionit të ofruar vërehet se sasia prej 725m³ është paguar, ndërsa furnizimi dhe pranimi i furnizimeve ishte 720m³ apo 5m³ më pak nga sasia e paguar/kontraktuar. Pas dëshmimeve të pranuar shihet se kjo sasi me lëndë djegëse është pranuar më vonë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme si dhe mungesa e përgjegjësisë nga komisioni përkatës.

Ndikimi Ekzekutimi i pagesës për faturën e pranuar pa verifikuar pranimin e plotë të furnizimit është në kundërshtim me rregullat financiare. Në rastet të tilla rrezikohet arritja e vlerës për para dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontroll mbi komisionet/organet mbikëqyrëse për pranim të furnizimeve me lëndë djegëse. Po ashtu, menaxheri i kontratës duhet të jetë më përgjegjës që furnizimet e tilla të bëhen në kohën e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos përfshirja e elementeve përkatëse në kushtet e kontratës me përfituesit

Gjetja Sipas thirrjes publike të datës 26.06.2023, me nr. protokollit 10-320, është hapur aplikimi për participim me bashkëfinancim për subvencionimin e fermerëve të komunës me mekanizma bujqësore dhe moto kultivator. Po ashtu, në bazë të kontratës në pikën 1 të saj, është paraparë edhe numri serik për mekanizmat bujqësor për secilën kontratë.

Më datën 19.06.2023, është lidhur kontratë publike në mes komunës dhe operatorit ekonomik për furnizimin e moto-kultivatorëve dhe mekanizmave bujqësore për fermerët e komunës së Prizrenit. Çmimi i kontratës kornizë ishte 357,400€ duke participuar komuna me 85% dhe fermerët e komunës me 15%. Me rastin e testimit të dy pagesave (183,000€ dhe 100,000€), kemi vërejtur se komuna ka bërë pranimin teknik të moto-kultivatorëve më datën 12.09.2023 duke konstatuar se janë pranuar sipas specifikave të kërkuara. Në bazë të rishikimit të 11 kontratave të lidhura me përfituesit në kuadër të drejtave dhe obligimeve tek kontratat me fermeret nuk janë plotësuar kontratat me informata relevante siç janë vendosja e numrave serik për mekanizmat bujqësor.

Mos përfshirja e të gjitha kushteve të kontratës, siç është numri serik ka ndodhur nga mos zbatimi i kërkesave të përcaktuara me kushtet e kontratës.

Ndikimi

Mos përfshirja në kushtet e marrëveshjes edhe elementin për numër serik të të gjitha mekanizmave bujqësore mund të ketë si rrezik tjetërsimin eventual të tyre.

Rekomandimi A2

Kryetari të sigurojë se çdo marrëveshje me përfituesit/fermerët me rastin e dhënies së subvencioneve të çfarëdo mekanizmi bujqësor do të përfshijë elementet përkatës, duke kërkuar vendosjen e numrave serik të të gjitha rasteve të tilla.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja

Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin publik, neni 70.24 pika (f) përcakton se; menaxherët e kontratës “Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Nga testimet e bëra, ka rezultuar se në nënte (9) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si:

- “Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive, shtrimi i fushave me tartan” në vlerë prej 174,174€;
- Renovimi i Qendrës Sportive "Sezair Surroi" në Prizren ” në shumë prej 518,035€;
- “Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive në Prizren” në vlerë prej 262,000€;
- “Ndërtimi i shtëpisë së pleqve” në shumë prej 94,250€;
- “Asfaltimi i rrugës Trepetic-Petrovë” në shumë prej 198,933€;
- “Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor Ardhmëria në Fshatin Landovicë” në vlerë prej 522,546€;
- “Ndërtimi i rrugëve lokale në Lubizhdë të Hasit” në shumë prej 327,118€;
- “Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor (aneksit të vjetër) Naim Frasheri Vlashnje” në vlerë prej 64,083€; dhe
- “Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Randobravë” në vlerë prej 249,954€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e anashkalimit të përdorimit të procedurës së kërkuar nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit e lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin e kontratave.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos përfshirja e vendimeve në e-prokurim për pagesat për inflacion

Gjetja Ligji nr. 08/l-183 për mbështetjen e punëve publike neni 7.2 përcakton se brenda tre (3) dite kalendrike pas nxjerrës së vendimit për aprovim ose refuzim të kërkesës për kompensim për inflacion, Autoritetet Kontraktuese i vendosin të gjitha vendimet në platformën elektronike të prokurimit publik. Çdo kërkesë për pagesë për kompensim për inflacion pa e respektuar këtë paragraf konsiderohet si e pavlefshme. Po ashtu pika 7.3 përcakton se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) monitoron nëse të gjitha vendimet për kompensim për inflacion janë të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik.

Sipas të dhënave të Thesarit në kuadër të kodit ekonomik "34200" kompensim për inflacion, komuna ka paguar shuma totale prej 507,959€ për 25 projekte të ndryshme kapitale. Me rastin e testimit të dy mostrave në shumë prej 110,135€, kemi vërejtur se komuna ka bërë aprovimin për pagesë si kompensim të inflacionit deri sa këto vendime nuk janë vendosur në platformën elektronike të prokurimit publike, siç është përcaktuar me rregullativën në fuqi.

Në një rast tjetër, kemi vërejtur se një operator në bazë të kërkesës është marrë vendimi për kompensim të inflacionit në vlerë 30,000€. Pavarësisht, kësaj operatori nuk ka përmbushur kontratën në tërësi, ku vlera e punëve të pakryera ishte 36,515€.

Ne nuk kemi gjetur se komuna ka pranuar nga KRPP ndonjë sqarim me shkrim për mos funksionimin e e-prokurimit, përkundër që zyra e prokurimit ka njoftuar KRPP-në. Ndërsa në rastin tjetër, sipas menaxherit të kontratës për mos realizimin e kontratës në tërësi (për vlerën e lartcekur) ka ndodhur si rezultat i mos gatishmërisë, përkatësisht refuzimit së operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës në tërësi.

Ndikimi Mos respektimi i rregullave ligjore për vendosjen e të gjitha vendimeve në e-prokurim ka rezultuar nga mos përgjegjshmëria e zyrtarëve kompetente. Refuzimi për realizimin e kontratës në tërësi nga pune kryesi mund të ndikoj që komunës t'i shkaktoj probleme financiare me vlerë më të lartë.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës në rastet e tilla do të marrin masa korigjuese të menjëhershme për të zbatuar detyrimin ligjor të raportimit të vendimeve për kompensim për inflacion në platformën elektronike të prokurimit publik. Po ashtu të kërkoj veprime apo mekanizma shtesë për realizimin e projektit nga operatori ekonomik apo të ndërmerr hapa tjerë ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare

Gjetja Rregulla Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike, neni 22 përcakton se; hapat që fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, pranohet fatura dhe në fund procedohet për pagese nga Thesari.

Gjatë testimeve, kemi identifikuar se:

- Në (19) raste, në vlerë të pagesave 1,692,329€ zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimit të faturës; dhe
- Në (31) raste, në vlerë të pagesave 2,271,085€, urdhër blerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës, jo siç kërkohet me rregulla financiare.

Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar rregullat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës, si dhe nga mos planifikim i duhur i rrjedhës së parasë.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi, si dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A6 - Mungesa e projektit ekzekutiv**

Gjetja Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (UOPP), neni 20, pika 10 i kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa, pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatorë duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Projekti për "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt" në vlerë prej 3,470,000€, nuk kishte një projekt ekzekutiv të hartuar nga komuna. Megjithatë, ishte nisur procesi i prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë".

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos parashikimi me kohë të këtij projekt për investim.

Ndikimi Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutiv, rrisin rrezikun e

realizimit të punëve pa kritere standarde të ndërtimit, vonesa në realizimin e tyre dhe të mos arrihet cilësia e duhur.

Rekomandimi A6 Kryetari të sigurojë forcimin e kontroleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, faturat mund të ekzekutohen direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrat të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Në (6) gjashtë raste, faturat në vlerë totale prej 601,437€, të paraqitura në pasqyra financiare, prezantojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 15 ditë deri në rreth 4 muaj.

Me testimin e nëntë (9) pagesave nga kategoria e investimeve kapitale dhe gjashtë (6) pagesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi identifikuar se janë ekzekutuar pagesa në bazë të vendimeve përmbarimore/gjykatave. Sipas vlerës së testuar të këtyre mostrave kemi vërejtur se në emër të pagave për shujta/paga jubilarë janë paguar 89,448€, (nga investimet kapitale) përkatësisht 74,191€ (nga mallra dhe shërbime).

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos pagesave me kohë të detyrimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë, ku një pjese e tyre ishin për shujta për implementimin e kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

Ndikimi Si pasojë e vonesave të pagesave, komuna mund të përballlet me kosto shtesë të interesave e gjobave/shpenzime gjyqësore për vonesat të kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Me kontratën publike të nënshkruar mes komunës dhe kontraktuesit, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar.

Në tre (3) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:

- Kontrata "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive dhe shtruarja me tartan" në vlerë 174,174€, e nënshkruar më datë 03.02.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 180 ditë;
- Kontrata "Ndërtimi i rrugës Trepetice - Petrove" në vlerë 198,933€, e nënshkruar më datë 23.05.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 120 ditë; dhe
- Kontrata "Ndërtimi i rrugëve lokale Lubizhde të Hasit" në vlerë 327,118€, e nënshkruar më datë 08.03.2021, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 360 ditë. Deri sa ishim nën auditim (prill 2024), asnjëra nga këto projekte nuk ishin të përfunduar.

Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasojë e planifikimit jo të duhur të projektit, si dhe të disa problemeve në shpronësimin e pronave.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në menaxhimin e kontratave duke zbatuar një mbikëqyrje të rregullt dhe efektive. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme

Gjetja

Ligjit nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 36, paragrafi 1 përcakton se "Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin Financiar në Kosovë në përputhje me rregullat".

Në 13 raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale duke mos pasur mjete mjaftueshme të zotuar. Rastet kanë të bëjë me projektet:

- Projekti "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt" me vlerë të kontratës prej 3,470,000€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 50,000€;
- Projekti "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur" me vlerë të kontratës prej 2,497,919€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 50,000€;
- Projekti "Rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Lubizhdë të Hasit të Prizrenit" me vlerë të kontratës prej 444,887€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 14,307€;
- Projekti "Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë" me vlerë të kontratës prej 248,980€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 17,801€;
- Projekti "Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë të Qytetit" me vlerë të kontratës prej 76,671€, deri sa zotimi i mjeteve nuk ishte

- bashkangjitur deklaratës së nevojave të disponueshmërisë;
- Projekti "Rehabilitimi dhe rivitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, restaurimi shesheve dhe objekteve" me vlerë të kontratës sipas çmimit për njësi 3,360 (vlera e parashikuar 3,000,000) deri sa zotimi i mjeteve ishte 5,914€.
 - LOT 2 'Furnizim me pelet për ngrohje për shkollat e Komunës së Prizrenit 2023/2024 me vlerë totale indikative të kontratës prej 354,042€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 5,000€;
 - 'Furnizim me zhavor për rrugët e paasfaltuara në Komunën e Prizrenit" me vlerë të kontratës prej 1,399,255€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 24,312€;
 - 'Furnizim me lëndë djegëse dru ahu për ngrohje për familjet e dëshmorëve, familjet e invalidëve të luftës dhe familjet skamnore - rastet sociale të Komunës së Prizrenit' me vlerë totale indikative të kontratës prej 184,161€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 24,000€;
 - 'Transporti i mësimdhënësve udhëtar në Komunën e Prizrenit' me vlerë totale indikative të kontratës prej 266,335€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 10,000€;
 - Revista teatrore" me vlerë të parashikuar të kontratës prej 60,000€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 19,425€;
 - 'Hartimi i projekteve sipas nevojave të drejtorisë për Turizëm dhe zhvillim ekonomik' me vlerë të kontratës totale indikative prej 59,950€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 1,000€; dhe
 - 'Furnizim me material higjienik për nevojat e KPSH (projekt 2 vjeçar)' me vlerë totale indikative të kontratës prej 139,935€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 15,000€.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur zotim të mjeteve.

Ndikimi

Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike: (mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale).

Çështja B4 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregulla Financiare rr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, neni 18, pika 3 specifikon se; shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 241,824€ në kategori jo adekuate :

- Nga kategoria investimet kapitale janë paguar për paga dhe mëditje/shujta në shume prej 89,448€; dhe
- Nga kategoria për mallra dhe shërbime janë paguar 74,191€, për furnizim me mjete ndihmëse për OJQ-të dhe klubet sportive si dhe 78,185€ janë paguar për furnizim me material për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Prizren, që për nga natyra shpenzimi i takon subvencione dhe transfere.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe keq klasifikimi ka ndodhur si rezultat i mos zbatimit të kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ri-destinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PVF-të e vitit 2023 është 502,556,542€, pasurive jokapitale është 3,314,325€, si dhe stoqet 439,693€.

Çështja A7 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim

Gjetja Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€, kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara në regjistrat kontabël investime në vijim në vlerë prej 57,444,588€. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2023, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar ose që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduara, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Kjo sjell mangësi dhe vështirësi në vlerësimin e saktë të pasurive të komunës, duke e bërë të vështirë menaxhimin efektiv të tyre.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos regjistrimi dhe mos harmonizimi në kohën e duhur të regjistrit të pasurive jo financiare

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, paragrafi 3 përcakton që; "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e pasurisë." Më tutje neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PVF-ve.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se:

- Në shtatë (7) raste/pagesa të realizuara në vitin 2023, në vlerë totale prej 513,637€ nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe PVF, por këto pasuri janë regjistruar në kohën e procesit të auditimit (prill 2024);

- Në vitin 2023, komuna ka regjistruar pasuritë jo kapitale në sistemin e-pasuria, por këtij regjistri i mungon informata lidhur me kodin e nënkategorisë për të identifikuar regjistrimet e vitit të audituar; dhe
- Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PVF-ve, por më datën 23.02.2024.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë së zyrtarëve për realizimin e detyrave të përcaktuara me kohë dhe sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi

Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale dhe jo kapitale me informatat të duhura, si dhe mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë brenda afatit të paraparë ligjor rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë që posedon komuna. Gjithashtu shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive, si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të siguroj regjistrimin e plotë të pasurive kapitale në SIMFK në kohën e duhur dhe pasuritë jo kapitale të regjistrohen në e-pasuri me informatat e duhura sipas nën kodeve ekonomike të kërkuara. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PVF, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arketueshme të prezantuara në PVF e vitit 2023 në total janë 22,978,746€. Saldo e të arketueshmeve kryesisht përbehet nga tatimi në pronë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, taksat për biznese, qiraja nga shfrytëzimi i pronave komunale, etj.

Çështja B5 - Rritje e saldos së llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26.1 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove. Po ashtu, neni 27.1 1. specifikon se; nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 22,978,746€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (53%), taksës nga mbeturinat (22%), taksës për bizneset (11%), qirasë për shfrytëzimin e pronës publike (4%) dhe taksës për leje ndërtimi (10%). Në 57 raste të hyrat nuk ishin inkasuar me kohë, kjo ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin paraprak për 4,042,130€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme ligjore në arkëtimin e të hyrave.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave ndikon në nivelin më të ulët të buxhetit për shkak të fondeve të pa mbledhura dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale. Kjo po ashtu ndikon në vjetërsimin e këtyre llogarive duke pamundësuar arkëtimin.

Rekomandimi B5 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	60,491,944	69,387,339	62,409,458	46,266,941	50,185,605
Grante Qeveritare - Buxheti	49,088,386	52,703,176	50,062,613	36,663,440	41,768,695
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	359,900	311,911
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	3,000,000	3,000,000	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	4,632,318	4,366,480	3,934,810	2,405,653
Të hyrat vetanake	8,403,558	8,403,558	7,885,742	5,118,768	5,382,984
Donacionet vendore	0	543,880	72,273	41,530	315,934
Donacionet e jashtme	0	104,407	22,349	148,492	428

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 8,895,395€, kjo rritje është rezultat i kursimeve nga Granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë për 3,614,790€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 4,632,318€, dhe përfitimi i fondeve nga donatorët e brendshme 543,880€ dhe të jashtëm për 104,407€.

Në vitin 2023 Komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final ose 62,409,458€, me realizim më të mirë se vitin e kaluar (2022 - 84%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	60,491,944	69,387,339	62,409,458	46,266,941	50,185,605
Pagat dhe mëditjet	22,108,383	25,767,591	25,709,009	21,098,714	24,546,533
Mallrat dhe shërbimet	12,000,408	12,282,490	11,829,897	10,135,739	8,170,451
Komunalitë	1,220,785	1,644,219	1,570,749	818,129	741,445
Subvencionet dhe transferet	3,500,000	3,618,201	3,537,966	2,562,388	2,562,240
Investimet Kapitale	21,432,368	25,844,839	19,761,836	11,651,971	14,164,936
Rezervat	230,000	230,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 3,659,208€, nga granti shtesë nga Qeveria si rezultat i aplikimi të Ligjit të ri të pagave dhe pagesave nga vendimet gjyqësore;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 282,082€, apo 96% e buxhetit ishte shpenzuar ndërsa komunalit janë rritur 423,434 krahasuar me buxhetin fillestar;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 118,201€, përderisa realizimi ishte në shkallën prej 98% e buxhetit final;
- Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,412,471€, apo 76% e buxhetit ishte shpenzuar. Po ashtu, edhe dinamika e realizimit për 19 nga 214 projekte të parapara në vlerë prej 3,660,000 nuk kanë pasur shpenzime fare për vitin vijues. Është me rëndësi të theksohet se dinamikës për investimeve kapitale i ka kontribuar dhe pagesat prej 2,087,859€ në emër të vendimeve gjyqësore; dhe

Si rezultat i situatës pandemie me COVID-19, Komuna e Prizrenit kishte shpenzuar 31,088€, prej të cilave janë paguar për paga dhe mëditje në sektorin e shëndetësisë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e planifikuara për vitin 2023 ishin 8,403,558€, ndërsa janë realizuar 9,579,478€, duke tejkaluar planin për 14%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2023 Komuna e Prizrenit ka përfituar të hyra nga gjokat në trafik dhe gjykatave në vlerë 1,113,117€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	8,403,558	8,403,558	9,579,478	7,538,665	7,952,471
Të hyrat tatimore	3,497,307	3,497,307	3,580,180	2,572,438	3,168,586
Të hyrat jo tatimore	4,906,251	4,906,251	5,999,299	4,944,441	4,774,606
Të hyrat tjera	0	0		21,785	9,279

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2022 për Komunën e Prizrenit ka rezultuar me 14 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2022 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Prizrenit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende deri sa një në proces të zbatimit dhe një nuk është i aplikueshëm, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit shqyrtojnë aplikacionet në përputhje me kriteret e përcaktuara me thirrjen publike, dhe se përdorin formularët zyrtar të procesit të subvencionimit të OJQ-ve siç përcaktohet me rregullore. Po ashtu, monitorues të realizimit të projekteve të subvencionuara të mos jenë anëtarët e komisionit të vlerësimit të kërkesave. Gjithashtu të sigurohet se, monitoruesit e projekteve të mbikëqyrin realizimin e projekteve të subvencionuara dhe se përfituesit dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar pas përfundimit të projekteve.	Janë ndërmarre veprime të nevojshme.	I zbatuar

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të punësuarit me kontratë për kohë të caktuar angazhohen vetëm për afatin e caktuar me kontratë. Në rastet kur vlerësohet nevoja për punonjës të rregulltë, të zhvillohet procedura e rekrutimit përmes konkursit publik.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë. Siguria e ekzekutimit të kontratës dhe garancioni i punimeve të bëhen në vlerën dhe afatin e përcaktuar me kushtet e veçanta të kontratës. Në rastet kur projektet tejkalojnë planin dinamik të realizimit, sigurimi i ekzekutimit të kontratës duhet të vazhdohet dhe të mbulojë periudhën kohore deri në realizim.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se është arritur së paku 20% e verifikimit të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Specifikimet teknike të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore, duke mos përdorur emrin e markës tregtare apo modelit që favorizon apo diskriminon ndonjë OE. Gjithashtu, të sigurohet se sigurimi i ekzekutimit të kontratës bëhet në vlerën dhe afatin e përcaktuar me njoftimin për kontratë.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se para nënshkrimit të kontratave publike mjetet financiare zotohen në SIMFK. Në rastet kur procedurat e prokurimit për arsye objektive nuk finalizohen në vitin fiskal kur është filluar procesi i kontraktimit, atëherë ri-zotimi i mjeteve në SIMFK të bëhet në vitin vazhdues.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore / përmbarimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.	Nuk është i aplikueshëm.	Nuk është i aplikueshëm më

8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
9.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Kryetari të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasuria për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Janë ndërmarrë veprime të pjesërishme.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë dhe i drejtë.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes se veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjes e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar në paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
14.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të sigurojë një koordinim të duhur të informacionit dhe përmirësim të komunikimit në mes departamenteve, në mënyrë që të sigurohen evidenca të sakta dhe të plota të detyrimeve kontingjente për prezantim në pasqyrat vjetore financiare.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leterkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit

Data: 10.06.24, Prizren.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

ZYRA E KRYETARIT

DATË:	15.07.2024
PËR:	Vlora Mehmeti- Spanca, Auditore e Përgjithshme
CC:	Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit në ZKA Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit të Auditimit
NGA:	Agron Hoxha, Udhëheqës i AB
PËRMES:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
LENDË:	PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2023

Të nderuar,

Në pajtim me nenin 14, pika 1 deri në pikën 7 të Rregullores së Punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të veprimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të aprovuar me datë 21.06.2019, gjeni të bashkangjitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga raporti final i Auditimit për Komunën e Prizrenit, për vitin financiar të përfunduar me 31.12.2023, të përgatitur nga anëtarët e grupit punues në bashkëpunim me NjAB. Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit. Komuna e Prizrenit ka të themeluar Grupin Punues dhe ka të emëruar Koordinatorin e procesit dhe se për progresin e zbatimit të rekomandimeve do të bëhet rishikimi sipas afateve të caktuara në planin e veprimit, duke përgatitur Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve, i cili raport do të dorëzohet në dy periudha: **30 shtator 2024 dhe 15 mars 2025**, sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit nga ZKA.

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2023

Nr	Komponenta e auditimit(kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Çështja A1 - Pagesa e plotë për furnizim me lëndë djegëse	Më datë 23.02.2022 është lidhur kontratë me OE në shumë prej 56,550€, për projektin "Furnizimi me dru për ngrohje për rastet sociale". Më datën 06.04.2023, komisioni në bazë të faturës së pranuar, ka konstatuar se furnizimi me dru është pranuar si në sasi ashtu edhe në cilësi sipas kushteve të kontratës. Sipas dokumentacionit të ofruar vërehet se sasia prej 725m3 është paguar, ndërsa furnizimi dhe pranimi i furnizimeve ishte 720m3 apo 5 m3 më pak nga sasia e paguar/kontraktuar. Pas dëshmime të pranuara shihet se kjo sasi me lëndë djegëse është pranuar më vonë.	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontroll mbi komisionet/organet mbikëqyrëse për pranim të furnizimeve me lëndë djegëse. Po ashtu, menaxheri i kontratës duhet të kërkojë nga operatori ekonomik furnizimin e plotë të sasisë apo të bëhet kthimi i mjeteve për sasinë e pa furnizuar.	Rekomandim i zbatuar. Kjo gjetje është e adresuar, ne kemi ofruar deshmi tek ekipi i auditorëve se sasia e paguar dhe e pranuar nga përfituesit është në harmoni me sasinë e kontraktuar me OE.	Udhëheqësja dhe zyrtarët përgjegjës të ZKK.	Rekomandim i zbatuar.
2	Çështja A2 - Mos përfshirja e elementeve përkatëse në kushtet e kontratës me përfituesit	Më datën 19.06.2023, është lidhur kontratë publike mes komunës dhe operatorit ekonomik për furnizimin e moto kultivatorëve dhe mekanizmave bujqësore për fermerët e komunës së Prizrenit. Çmimi i kontratës kornizë ishte 357,400€ duke participuar komuna me 85% dhe fermerët e komunës me 15%. Me rastin e testimi të dy pagesave (183,000€ dhe 100,000€), kemi vërejtur se komuna ka bërë pranimin teknik të moto-kultivatorëve më datën 12.09.2023 duke konstatuar se janë pranuar sipas specifikave të kërkuara. Në bazë të rishikimit të 11 kontratave të lidhura me përfituesit në kuadër të drejtave dhe obligimeve tek kontratat me fermerët nuk janë plotësuar kontratat me informata relevante siç janë vendosja e numrave	Rekomandimi A2 Kryetari të sigurojë se çdo marrëveshje me përfituesit/fermerët me rastin e dhënies së subvencioneve të çfarëdo mekanizmi bujqësor do të përfshijë elementet përkatës, duke kërkuar vendosjen e numrave serik të të gjitha rasteve të tilla.	Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural konstaton se kjo e gjetur ka ndodhur pasi që gjatë bartjes së të dhënave nga lista e përfituesve tek kontrata nuk janë bartur numrat serik (edhe pse në listat e përfituesve ekzistojnë numrat serik të mekanizmave bujqësor), kjo çështje është adresuar dhe në përgatitjen e kontratave për përfituesit në thirrjet për subvencione me mekanizma bujqësor, gjatë këtij vitit do të vendosen të dhënat me numra serik.	Drejtori dhe zyrtarët përgjegjës të drejtorisë.	2 shtator – 31 dhjetor 2024.

		serik për mekanizmat bujqësor.				
3	Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit	<p>Nga testimet e bëra, ka rezultuar se në nënte (9) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (eprokurimi), si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive, shtrimi i fushave me tartan" në vlerë prej 174,174€; • Renovimi i Qendrës Sportive "Sezair Surroi" në Prizren " në shumë prej 518,035€; • "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive në Prizren" në vlerë prej 262,000€; • "Ndërtimi i shtëpisë së pleqve" në shumë prej 94,250€; • "Asfaltimi i rrugës Trepetic-Petrovë" në shumë prej 198,933€; • "Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor Ardhmëria në Fshatin Landovicë" në vlerë prej 522,546€; • "Ndërtimi i rrugëve lokale në Lubizhdë të Hasit" në shumë prej 327,118€; • "Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor (aneksit të vjetër) Naim Frasheri Vlashnje" në vlerë prej 64,083€; dhe • "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Randobravë" në vlerë prej 249,954€. 	<p>Rekomandimi A3</p> <p>Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mospërdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.</p>	<p>Drejtorit Komunale kanë analizuar këtë gjetje dhe së përkundër faktit disa prej Drejtorive shumica e kontratave janë menaxhuar(mbikëqyrur) nga operator të kontraktuar, ne do të sigurohemi që në të ardhmen menaxhimi i kontratave të bëhet edhe përmes platformës E-prokurimi. Shtimi i stafit profesional do të mundësoj të pakësohet edhe numri i menaxhimit të kontratave për menaxherët aktual dhe se mundësia për mirëmbajtjen e sistemit elektronik do të jetë me e madhe.</p>	<p>Menaxherët e kontratave në: Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtorinë e Arsimit.</p>	<p>1 gusht - 31 dhjetor 2024</p>
4	Çështja A4 - Mos përfshirja e vendimeve në e-prokurim për pagesat për inflacion	<p>Sipas të dhënave të Thesarit në kuadër të kodit ekonomik"34200" kompensim për inflacion, komuna ka paguar shumë totale prej 507,959€ për 25 projekte të ndryshme kapitale. Me rastin e testimit të dy mostrave në shumë prej 110,135€, kemi vërejtur se komuna ka bërë aprovimin për pagesë si kompensim të inflacionit derisa këto vendime nuk janë</p>	<p>Rekomandimi A4</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës në rastet e tilla do të marrin masa korrigjuese të menjëhershme për të zbatuar detyrimin ligjor të raportimit të vendimeve për kompensim për inflacion në platformën elektronike të</p>	<p>Rekomandim i mbyllur i zbatuar (nuk është i aplikueshëm). Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur(i pa aplikueshëm) pasi që fushëveprimi i ligjit ishte deri me 30 qershor 2023.</p> <p>Udhëheqësi i prokurimit do të shtojë kontrollin e brendshme që në platformën e E-prokurimit, të ngris të gjitha dokumentet të cilat</p>	<p>Udhëheqësi i zyrës së prokurimit dhe menaxheri i kontratës.</p>	<p>Rekomandim i mbyllur(nuk është i aplikueshëm).</p> <p>Rekomandim i zbatuar për pjesën e dytë të së gjeturës.</p>

		<p>vendosur në platformën elektronike të prokurimit publike, siç është përcaktuar me rregullativën në fuqi. Në një rast tjetër, kemi vërejtur se një operator në bazë të kërkesës është marrë vendim për kompensim të inflacionit në vlerë 30,000€. Pavarësisht kësaj, operatori nuk ka përmbushur kontratën në tërësi, ku vlera e punëve të pakryera ishte 36,515€.</p> <p>Ne nuk kemi gjetur se komuna ka pranuar nga KRPP ndonjë sqarim me shkrim për mosfunksionimin e e-prokurimit, përkundër që zyra e prokurimit ka njoftuar KRPP-në. Ndërsa në rastin tjetër, sipas menaxherit të kontratës për mosrealizimin e kontratës në tërësi (për vlerën e lartcekur) ka ndodhur si rezultat i mos gatishmërisë, përkatësisht refuzimit së operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës në tërësi.</p>	<p>prokurimit publik. Po ashtu të kërkoj veprime apo mekanizma shtesë, për realizimin e projektit nga operatori ekonomik apo të ndërmerr hapa tjerë ligjor.</p>	<p>i parasheh LPP dhe rregulloret e KRPP.</p> <p>Për gjetjen në paragrafin e dytë konstatojmë se operatori ekonomik i ka përfunduar punimet dhe është iniciuar procesi për pranimin teknik të projektit.</p>		
5	<p>Çështja A5 - Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare</p>	<p>Gjatë testimeve, kemi identifikuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në (19) raste, në vlerë të pagesave 1,692,329€, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimit të faturës; dhe Në (31) raste, në vlerë të pagesave 2,271,085€, urdhër blerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës, jo siç kërkohet me rregulla financiare. 	<p>Rekomandimi A5</p> <p>Kryetari të siguroj se duhet të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi, si dhe të kryhet pagesa.</p>	<p>Drejtori për Buxhet dhe Financa do ta përgatit një qarkore-shkresë ku do të përshkruhen me saktësi të gjitha hapat për pagesë të bazuara në rregulloren e thesarit dhe do ti dërgohet të gjithë udhëheqësve të programeve buxhetore, menaxherëve të kontratave, zyrtarëve të prokurimit, me qëllim të zbatimit të hapave për pagesë.</p>	<p>Drejtori për Buxhet dhe Financa, ZKF, menaxherët e kontratave, stafi i zyrës së prokurimit.</p>	<p>1 gusht - 31 dhjetor 2024</p>
6	<p>Çështja A6 - Mungesa e projektit ekzekutiv</p>	<p>Projekti: "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt" në vlerë prej 3,470,000€, nuk kishte një projekt ekzekutiv të hartuar nga komuna. Megjithatë, ishte nisur procesi i prokurimit duke përgatitur vetëm paramanës dhe parallogarinë"</p>	<p>Rekomandimi A6</p> <p>Kryetari të sigurojë forcimin e kontroleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.</p>	<p>Sa i përket këtij rekomandimi, ne kemi monitoruar inicimin e procedurave tenderuese dhe nuk kemi zhvilluar procedura të mëtejme pa pasur projekte ekzekutive ashtu siç kërkohet edhe në LPP.</p> <p>Çështja e ngritur nga ana e juaj ka të bëjë me kontratë kornizë, e cila realizohet sipas kërkesave</p>	<p>Udhëheqësi dhe stafi i zyrës së prokurimit</p>	<p>Përpos rastit në fjalë në të gjitha rastet tjera zbatohen projektet ekzekutive para inicimit të procedurave të prokurimit. Ne konsiderojmë se</p>

				gjatë afatit të caktuar kohor dhe ka të bëjë me punë rehabilituese (mirëmbajtje të rrugëve ekzistuese), andaj për këto lloje të kontratave nuk mund të përgatiten projekte ekzekutive.		ky rekomandim është i zbatuar.
7	Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave	Në (6) gjashtë raste, faturat në vlerë totale prej 601,437€, të paraqitura në pasqyra financiare, prezantojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë me vonesë, nga 15 ditë deri në rreth 4 muaj. Me testimin e nëntë (9) pagesave nga kategoria e investimeve kapitale dhe gjashtë (6) pagesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kemi identifikuar se janë ekzekutuar pagesa në bazë të vendimeve përmbartimore/gjykatave. Sipas vlerës së testuar të këtyre mostrave kemi vërejtur se në emër të pagave për shujta/paga jubilarë janë paguar 89,448€, (nga investimet kapitale) përkatësisht 74,191€ (nga mallra dhe shërbime).	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Do të shtohet monitorimi në disiplinën financiare dhe asnjë drejtori nuk do duhej të inicioj protokollimin/pranimin e faturave, nëse paraprakisht nuk janë zotuar mjetet. Pjesa më e madhe e pagesave përmes vendimeve gjyqësore, janë për pagesa që rrjedhin nga marrëveshjet kolektive për sistemin e arsimit, konsiderojmë që kjo çështje mund të mos zbatohet në tërësi edhe këtë vit dhe në shumë raste kemi të pamundur që të gjitha pagesat të orientohen nga fondi i pagave dhe mëditjeve, në rastet kur kemi mundësi financiare ne do të kërkojmë edhe ridestininim të mjeteve, me qëllim të rritjes së fondit për realizimin e këtyre pagesave, e cila është dhe mbetet barra më e madhe dhe sfiduese për komunën.	Menaxherët e kontratave, zyrtari kryesor financiar, zyrtarët e thesarit	1 gusht - 31 dhjetor 2024
8	Çështja B2 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale	Në tre (3) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim: • Kontrata "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive dhe shtruarja me tartan" në vlerë 174,174€, e nënshkruar më datë 03.02.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 180 ditë; • Kontrata "Ndërtimi i rrugës Trepetice - Petrove" në vlerë 198,933€, e nënshkruar më datë 23.05.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 120 ditë; dhe	Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në menaxhimin e kontratave duke zbatuar një mbikëqyrje të rregullt dhe efektiv. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Do të shtohen kontrolle që realizimi i projekteve të bëhet brenda afateve të parapara në planin dinamik dhe duke respektuar kushtet e specifikuar në kontratë. Zakonisht në mos zbatimin e afateve sipas planit dinamik po ndikojnë shumë faktorë si kushtet atmosferike, problemet pronësore etj.	Menaxherët e kontratave në: Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.	Gjatë periudhës së mbetur të vitit 2024

		<ul style="list-style-type: none"> • Kontrata "Ndërtimi i rrugëve lokale Lubizhdë të Hasit" në vlerë 327,118€, e nënshkruar më datë 08.03.2021, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 360 ditë. Derisa ishim nën auditim (prill 2024), asnjëra nga këto projekte nuk ishin të përfunduara. 				
9	<p>Çështja B3 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme</p>	<p>Në 13 raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale duke mos pasur mjete mjaftueshme të zotuara. Rastet kanë të bëjë me projektet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekti "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt" me vlerë të kontratës prej 3,470,000€, derisa zotimi i mjeteve ishte 50,000€; • Projekti "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur" me vlerë të kontratës prej 2,497,919€, derisa zotimi i mjeteve ishte 50,000€; • Projekti "Rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Lubizhdë të Hasit të Prizrenit" me vlerë të kontratës prej 444,887€, derisa zotimi i mjeteve ishte 14,307€; • Projekti "Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë" me vlerë të kontratës prej 248,980€, derisa zotimi i mjeteve ishte 17,801€; • Projekti "Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë të Qytetit" me vlerë të kontratës prej 76,671€, derisa zotimi i mjeteve nuk ishte bashkangjitur deklaratës së nevojave të disponueshmërisë; • Projekti "Rehabilitimi dhe rivitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, restaurimi shesheve dhe objekteve" me vlerë të kontratës sipas çmimit për njësi 3,360 (vlera e parashikuar 3,000,000) derisa zotimi i mjeteve ishte 5,914€. • LOT 2 'Furnizim me pelet për 	<p>Rekomandimi B3</p> <p>Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.</p>	<p>Inicimi i procedurave të prokurimit bëhen duke u bazuar në deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve(ku ka raste që mjetet të jenë të planifikuara brenda një deri në tri vite), zotimi për projektet e financuara nga Grandi qeveritar do të zotohen sipas planit të shpenzimeve.</p> <p>Për projektet që realizohen nga të hyrat vetanake, zotimi do të bëhet sipas alokimit për këto projekte(ku zotimi për këto projekte nuk do të mund të jetë sipas vlerës së kontratave të nënshkruara).</p>	<p>Udhëheqësit/zyrtarët iniciues nga njesitë kërkuese, ZKF, udhëheqësi i zyrës së prokurimit</p>	<p>1 gusht - 31 dhjetor 2024</p>

		<p>ngrohje për shkollat e Komunës së Prizrenit 2023/2024 me vlerë totale indikative të kontratës prej 354,042€, derisa zotimi i mjeteve ishte 5,000€;</p> <ul style="list-style-type: none"> • ‘Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara në Komunën e Prizrenit’ me vlerë të kontratës prej 1,399,255€, derisa zotimi i mjeteve ishte 24,312€; • ‘Furnizim me lëndë djegëse dru ahu për ngrohje për familjet e dëshmorëve, familjet e invalidëve të luftës dhe familjet skamnore –rastet sociale të Komunës së Prizrenit’ me vlerë totale indikative të kontratës prej 184,161€, derisa zotimi i mjeteve ishte 24,000€; • ‘Transporti i mësimdhënësve udhëtar në Komunën e Prizrenit’ me vlerë totale indikative të kontratës prej 266,335€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 10,000€; • ‘Revista teatrore’ me vlerë të parashikuar të kontratës prej 60,000€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 19,425€; • ‘Hartimi i projekteve sipas nevojave të drejtorisë për Turizëm dhe zhvillim ekonomik’ me vlerë të kontratës totale indikative prej 59,950€, derisa zotimi i mjeteve ishte 1,000€; dhe • ‘Furnizim me material higjienik për nevojat e KPSH (projekt 2 vjeçar)’ me vlerë totale indikative të kontratës prej 139,935€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 15,000€. 				
10	Çështja B4 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 241,824€ në kategori jo adekuate :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga kategoria investimet kapitale janë paguar për paga dhe mëditje/shujta në shumë prej 89,448€; dhe • Nga kategoria për mallra dhe shërbime janë paguar 74,191€, për furnizim me mjete ndihmëse për OJQ-të dhe klubet sportive si dhe 78,185€ 	<p>Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ri-destinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.</p>	<p>Ne në vijim do të forcojmë kontrollin gjatë planifikimit të buxhetit dhe për çdo ndarje buxhetore do të planifikohet, shpenzohet dhe regjistrohet sipas kategorive ekonomike adekuate. Përmbarami i obligimeve që kanë të bëjnë jashtë procesit të zbatimit të kontratës kolektive ne do ta rrisim kontrollin edhe në ato</p>	<p>Zyrtari Kryesor Financiar, Menaxhmenti i DASH, DKRS dhe DPMS.</p>	<p>Sa i përket çështjes së shujtave, zbatimi i plotë i rekomandimit nuk do të mund të ndodhë brenda vitit 2024, por është proces i vazhdueshëm;</p>

		janë paguar për furnizim me material për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Prizren, që për nga natyra shpenzimi i takon subvencioneve dhe transfereve.		<p>raste kur kemi kërkesë zyrtare nga thesari për caktimin e fondit për pagesa do ti orientojmë në fondet sipas natyrës së shpenzimit.</p> <p>Pagesat përbarimore për shujta/inflacion të punonjësve arsimor, të cilat ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të Investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, këto pagesa po ekzekutohen nga thesari (procedura përbarimore) dhe janë marrë mjete nga kategoritë të cilat kanë pasur mjete të lira, kjo çështje duhet të ngritet në nivel të ministrive përkatëse sepse edhe pas kërkesave për rritjen e fondit tek pagat dhe mëditjet që pagat jubilarë, shujta, inflacioni të cilët paguhen me procedura përbarimore të ekzekutohen nga kodi përkatës, në kornizat afatmesme po përcaktohen limitet e planifikim vetëm për paga të rregullta;</p> <p>DKRS-Furnizimi me mjete ndihmëse për OJQ-të dhe klubet sportive, të paguara nga kategoria mallra dhe shërbime, kjo e gjetur është adresuar dhe në vitin 2024 nuk është iniciuar asnjë procedurë për këto furnizime.</p> <p>DPMS- për projekte të tilla sipas rekomandimit tuaj, ne do të bëjmë planifikimin adekuat në kategorinë subvencione dhe transfere.</p>		<p>Çështja e ngritur për keq klasifikim në DKRS është zbatuar, DPMS me planifikimin buxhetor, për vitin 2025.</p>
11	Çështja A7 - Mos mbyllja e investimeve në	Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€, kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara në regjistrat	Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë	Do të formohet Grupi Punues me anëtarë nga secila drejtori dhe në koordinim me zyrtarin e	Zyrtari i pasurisë, anëtarët e	Duke filluar nga 1 gusht deri 31 dhjetor 2024

	vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim	kontabël investime në vijim në vlerë prej 57,444,588€. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2023, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar ose që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.	funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.	pasurisë do ti zhvillojnë procedurat për mbylljen e investimeve në vijim për periudhën 2013-2022, ndërsa për projektet e përfunduara në vitin 2023, zyrtari i pasurisë ka zhvilluar procedurat e mbylljes së regjistrave kontabël-investimet në vijim.	grupit punues.	
12	Çështja C1 - Mos regjistrimi dhe mos harmonizimi në kohën e duhur të regjistrimit të pasurive jo financiare	Gjatë auditimit kemi konstatuar se: <ul style="list-style-type: none"> • Në shtatë (7) raste/pagesa të realizuara në vitin 2023, në vlerë totale prej 513,637€ nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe PVF, por këto pasuri janë regjistruar në kohën procesit të auditimit (prill 2024); • Në vitin 2023, komuna ka regjistruar pasurit jo kapitale në sistemin e-pasuria, por këtij regjistri i mungon informata lidhur me kodin e nënkategorisë për të identifikuar regjistrimet e vitit të audituar; dhe • Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundojë raportin para përgatitjes së PVF-ve, por më datën 23.02.2024. 	Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin e plotë të pasurive kapitale në SIMFK në kohën e duhur dhe pasurit jo kapitale të regjistrohen në e-pasuri me informatat e duhura sipas nën kodeve ekonomike të kërkuara. Po ashtu, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PVF, në mënyrë që vlera e pasurisë të përcaktohen saktë.	Sa i përket rastet/pagesa të identifikuar gjatë procesit auditues këto pasuri janë regjistruar në kohën e procesit të auditimit, si dhe të gjitha pagesat për pasuri kapitale të vitit 2024 janë duke u regjistruar në vazhdimësi; Në vitin 2023 gjitha pasuritë nën 1,000.00€ të pranuar në depo/nën depot e komunës, janë të regjistruara me të gjitha elementet e duhura të kërkuara në sistemin e-pasuria, ndërsa po vazhdohet me regjistrimin e pasurive të pranuar edhe gjatë vitit 2024. Do të ndërmerren hapa konkret që Komisioni i inventarizimit të pasurisë ta përfundojë regjistrimin e inventarizimit, përgatitjen dhe dorëzimin e raportit para përgatitjes së PVF-ve, pra para datës 31.01.2025.	Zyrtari i pasurisë në bashkëpunim me zyrtarët e depove/nën depove në komunë, komisioni i inventarizimit,	Regjistrimi i pasurisë mbi dhe nën 1,000€ është proces i vazhdueshëm sipas dinamikave të pranimin të pasurive. Raporti i inventarizimit planifikohet të përfundojë më së largu me 20.01.2025.

13	Çështja B5 - Rritje e saldosh së llogarive të arkëtueshme	Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 22,978,746€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (53%), taksës nga mbeturinat (22%), taksës për bizneset (11%), qirasë për shfrytëzimin e pronës publike (4%) dhe taksës për leje ndërtimi (10%). Në 57 raste të hyrat nuk ishin inkasuar me kohë, kjo ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin paraprak për 4,042,130€.	<p>Rekomandimi B5 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.</p>	<p>Tatimi në pronë- Nga ana e Departamentit të Tatimit në Pronë është duke u përgatitur manuali për inkasimin e borxheve, deri në fillimin e zbatimit të kësaj procedure ne do ti ndërmarrim këto veprime: Do të fillohet me identifikimin e tatimpaguesve të mëdhenj, të cilët nuk e kanë paguar tatimin në pronë dhe pastaj do ti zhvillojmë procedurat për inkasim të detyrueshëm.</p> <p>Taksa për mbeturina- Në mungesë të stafit të sektorit të mbeturinave, menaxhmenti i DSHP-së, me qëllimin e vetëm për përmirësimin i sistemit të faturimit dhe inkasimit të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, do të aranzhojë/kontraktton një ekip profesional në terren me qëllimin e vetëm përmirësimin e sistemit të inkasimit të hyrave nga mbeturinat.</p> <p>Sa i përket çështjeve për: Taksat për biznese, të hyrave nga qiraja për shfrytëzimin e pronës publike dhe taksës për leje ndërtimi, drejtorët/udhëheqësit e drejtorive përkatëse do ti shqyrtojnë të gjitha opsionet e mundshme ligjore, duke vendosur politika efikase me qëllim të rritjes së efikasitetit të mbledhjes së borxheve të akumuluar ndërr vite.</p>	Menaxheri i ZTP, zyrtarët e të hyrave për taksë nga bizneset, udhëheqësi i sektorit të ambientit, udhëheqësi i sektorit të pronës, drejtori dhe zyrtarët përgjegjës sipas lëndëve në Drejtorinë e Urbanizmit.	Ky rekomandim nuk mund të zbatohet në tërësi brenda vitit 2024, por është proces i vazhdueshëm.
----	--	---	--	---	---	---



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

KANCELARIJA PREDSEDNIKA

DATUM:	15.07.2024.godine.
ZA:	Vlora Mehmeti- Spanca, Generalna revizorka
CC:	Ramadan Gashi, Direktor Revizije u NKR Florim Maliqi, Rukovodilica ekipe Revizije
OD:	Agron Hoxha, Rukovodilac UR
PREKO:	Shaqir Totaj, Predsednik Opštine Prizren
PREDMET:	AKCIONI PLAN ZA SPROVOĐENJE PREPORUKA NACIONALNE KANCELARIJE ZA REVIZIJU ZA FINANSIJSKE IZVEŠTAJE OPŠTINE PRIZREN ZA 2023. GODINU

Poštovani,

U skladu sa članom 14. tačka 1. do 7. Pravilnika o radu za sprovođenje revizije i Akcionih planova Nacionalne Kancelarije Revizije, usvojenog 21.06.2019. godine, u prilogu se nalazi Akcioni plan za sprovođenje preporuka iz Završnog izveštaja revizije za Opštinu Prizren za finansijsku godinu završenu 31.12.2023, koju su pripremili članovi radne grupe u saradnji sa JUR. Uzimajući u obzir Revizorski izveštaj Nacionalne Kancelarije Revizije (NKR), u skladu sa nalazima i zaključcima revizije, opredeljeni smo za adresiranje preporuka datih kroz Akcioni plan. Opština Prizren je formirala Radnu grupu i imenovala Koordinatora procesa i da će se napredak u sprovođenju preporuka razmatrati u skladu sa rokovima utvrđenim akcionim planom, pripremajući Izveštaj o napretku sprovođenja preporuka , koji će se izveštaj podnositi u dva perioda: **30. septembra 2024. godine i 15. marta 2025. godine**, prema uslovima propisanim Pravilnikom o radu za sprovođenje revizije i akcionih planova NKR.

**AKCIONI PLAN ZA SPROVOĐENJE PREPORUKA NACIONALNE KANCELARIJE ZA REVIZIJU ZA FINANSIJSKE IZVEŠTAJE OPŠTINE PRIZREN
ZA 2023. GODINU**

Br	Komponenta revizije (poglavlje)	Nalaz	Preporuke	Praniranje preduzetih postupaka	Odgovorni službenik/ci	Planirani datum sprovođenja preporuke
1	Pitanje A1 - Puno plaćanje za snabdevanje gorivom	Dana 23.02.2022 godine potpisan je ugovor sa EO u iznosu od 56,550€ za projekat „Snabdevanje drvetom za grejanje za društvene prilike“. Komisija je dana 06.04.2023.godine, na osnovu primljenog računa, konstatovala da je isporuka drveta izvršena i po količini i po kvalitetu prema uslovima ugovora. Prema priloženoj dokumentaciji, konstatuje se da je uplaćen iznos od 725 m3, dok je isporuka i prijem zaliha 720 m3 ili 5 m3 manje od plaćenog/ugovorenog iznosa. Nakon dobijenih dokaza, vidi se da je ova količina goriva naknadno primljena.	Preporuka A1 Predsednik mora da obezbedi nadzor i kontrolu komisijama/organima Nadzornik za prijem zaliha goriva. Isto tako, menadžer ugovora mora da zahteva od ekonomskog operatera punu nabavku količine ili da vrati sredstva za neisporučenu količinu.	Preporuka sprovedena. Ovaj nalaz je adresiran, pružili smo dokaze revizorskoj ekipi da je iznos koji je uplaćen i primljen od strane korisnika u skladu sa iznosom ugovorenim sa EO.	Rukovodilac i odgovorni službenici OKZ	Preporuka sprovedena.
2	Pitanje A2 - Neuključivanje relevantnih elemenata u uslove ugovora sa korisnicima	Dana 19.06.2023 godine potpisan je javni ugovor između opštine i ekonomskog operatera za nabavku motokultivatora i poljoprivrednih mehanizama za poljoprivrednike opštine Prizren. Cena okvirnog ugovora iznosila je 357,400€, uz učešće opštine sa 85% i poljoprivrednika opštine sa 15%. U slučaju testiranja dve uplate (183,000 € i 100,000 €), uočili smo da je opština izvršila tehnički prijem motokultivatora dana 12.09.2023. godine, navodeći da su primljeni prema traženim specifikacijama. Na osnovu pregleda 11 ugovora koji se odnose na korisnike u okviru prava i obaveza iz ugovora sa poljoprivrednicima, ugovori nisu kompletirani sa relevantnim informacijama, kao što je postavljanje serijskih brojeva za poljoprivrednu mehanizaciju.	Preporuka A2 Predsednik će obezbediti da svaki sporazum sa korisnicima/poljoprivrednicima u slučaju davanja subvencija bilo kog poljoprivrednog mehanizma uključuje relevantne elemente, koji zahtevaju uspostavljanje serijskih brojeva svih takvih slučajeva.	U Direktorijatu za poljoprivredu i ruralni razvoj navode da je do ovog saznanja došlo zbog toga što prilikom prenosa podataka sa spiska korisnika na ugovor nisu preneti serijski brojevi (iako redni brojevi poljoprivrednih mehanizama postoje u spiskovima korisnika) , ovo pitanje je obrađeno iu pripremi ugovora za korisnike na pozivima za subvencije poljoprivrednim mehanizmima tokom ove godine biće stavljeni podaci sa serijskim brojevima.	Direktor i odgovorni službenici direktorijata	2 septembar – 31 decembar 2024

3	<p>Pitanje A3 - Nedostatke u upravljanju projektima preko elektronske platforme za e-nabavke</p>	<p>Iz sprovedenih testova, ustanovljeno je da u devet (9) slučajeva, upravljanje ugovorima i ocenjivanje učinka izvođača nije održavano i arhivirano preko elektronskog sistema javnih nabavki (e-nabavka), kao što su:</p> <ul style="list-style-type: none"> • „Izgradnja i održavanje objekata sportskih klubova, postavljanje tartan terena“ u iznosu od 174,174€; • Renoviranje sportskog centra „Sezair Suroi“ u Prizrenu“ u vrednosti od 518,035€; • „Izgradnja i održavanje objekata sportskih klubova u Prizrenu“ u iznosu od 262,000€; • „Izgradnja staračkog doma“ u iznosu od 94,250€; • „Asfaltiranje puta Trepetić-Petrove“ u iznosu od 198,933€; • „Izgradnja aneksa školske zgrade Ardhmeria u selu Landovice“ u iznosu od 522,546€; • „Izgradnja lokalnih puteva u Lubižde i Hasu“ u iznosu od 327,118€; • „Kompletna obnova školske zgrade (stari aneks) Naim Frasheri Vlashnje" u iznosu od 64,083€; i • „Izgradnja kanalizacije u selu Randobrave“ u vrednosti od 249,954€ 	<p>Preporuka A3</p> <p>Predsednik treba da razmotri razloge za nekorišćenje sistema e-nabavki i da preduzme dodatne mere kontrole kako bi obezbedio da se upravljanje ugovorima održava i arhivira u elektronskom sistemu javnih nabavki.</p>	<p>Opštinski direktori su analizirali ovaj nalaz i da uprkos činjenici da u nekim direktorijatima većinu ugovora upravlja (nadgleda) ugovoreni operater, mi ćemo se postarati da u budućnosti upravljanje ugovorima bude takođe vršeno preko platforma za e-nabavke. Dodavanje stručnog kadra omogućiće da se smanji broj upravljanja ugovorima za sadašnje rukovodioce i da će mogućnost održavanja elektronskog sistema biti veća.</p>	<p>Menadžeri ugovora u: Direktorijat za kulturu, omladinu i sport, Direktorijat za javne usluge, Direktorijat za rad i socijalno blagostanje i Direktorijat za obrazovanje.</p>	<p>1 avgust - 31 decembar 2024</p>
